



# HEJZA

Ali Aliu, kritik letrar

**ÇDO LETËRSI FRYMËZOHET NGA  
REALITETI PËRRETH**

*Xhevahir Spahiu*

## **TAKIM MË 31 DHJETOR**

Në kufirin mes viteve,  
për ato që ikën,  
për ato që vijnë  
mendimi pezull rri.

Ty që m'u shfaqe në dhjetorin e bardhë,  
nuk di ku të të fus, nuk di!  
Ish pasditja e fundit e një viti në ikje.  
Ora e Vlorës përudhte  
shkëmbime vështrimesh të dridhshme.

Sido që të jenë ngashënjimet e ardhshme,  
këto do të mbeten  
të papërsëritshme.

E unë në kufirin mes viteve,  
prerë nga një pyetje si ky qiell me vetëtimë:  
Ku të të fus,  
në ato që ikën,  
a në ato që vijnë?

-----  
*Viti i Ri 2025,  
për Ju miq të dashur,  
qoftë një vit i mbarë,  
i shëndetshme dhe i lumtur.  
Gëzuar!*

  
**HEJZA**

Nën thjerrë

# BIBLIOTEKA UNIVERSITARE QË NUK DI GJË PËR LIBRIN SHQIP

**Shqiptarët janë pjesë përbërëse dhe jetike e shoqërisë në Maqedoninë e Veriut, dhe kontributi i tyre në kulturë, letërsi dhe dije është i pamohueshëm**



**Nga Avni HALIMI**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment i Ohrit" në Shkup, si një institucion nacional, luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, shkencore dhe letrare të vendit. Me një fond prej rreth 3 milionë titujsh (siç u shpreh kohë më parë u.d. drejtori aktual) dhe një vizitë mujore prej rreth 40 mijë lexuesish, kjo Bibliotekë duhet të jetë simbol i qasjes universale në dije dhe kulturë për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, pavarësisht përkatësisë etnike. Megjithatë, realiteti për shqiptarët në këtë institucion tregon një histori të pabarazisë dhe neglizhencës që nuk mund të tolerohet. Ç'është e vërteta, dekadën e fundit Bibliotekën e kanë drejtuar drejtorë shqiptarë! Asnjëri dhe as tjetri nuk ia dolën që të punësojnë goftë vetëm një shqiptar, kurse pati raste që u punësuan maqedonas që për punësim deklaroheshin "shqiptarë"! Ja pse balancuesi dështoi, sepse ai u keqpërdor dhe në emër të tij u punësuan qindra maqedonas që formalisht deklaroheshin "shqiptarë"! Në fakt, në mesin e mbi 120 të punësuarve, janë nja 3-4 shqiptarë, të cilët u sistemuan si urdhër nga Agjencioni për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, si aksion qeveritar për shpërndarjen e atyre 2-3 mijë administratorëve shqiptarë, të cilët gati dy dekada po rrinin në shtëpi e po merrnin rroga kot! Këta drejtorë shqiptarë, edhe sot po t'i pyesësh nuk do të dinë të përgjigjen se cili ishte fondi i librit shqip në Institutin që e drejtonin!

**Një bibliotekë kombëtare ose një departament shqiptar**

Nëse partnerët e koalicionit qeveritar vendosin që edhe më tej me këtë

institucion të udhëheqin shqiptarët, atëherë drejtorit të ardhshëm duhet t'ia përgatisin terrenin dhe prej tij të kërkojnë program të qartë, politika të qarta mbi shqipen (gjuhën, librin dhe të punësuarit) në këtë Bibliotekë. Sektorët, "laboratorët" e papushtuar nga shqiptarët, më në fund duhet të bien dhe ky Institucion duhet të jetë tërësisht transparent, të dalë nga ato politika të kontrollit e të censurës komuniste, madje edhe nacionaliste dhe, të jetë e hapur për të gjithë! Fakti që askush nuk di për numrin e saktë të titujve shqip në këtë Bibliotekë, apo se si trajtohen dhe ruhen këto libra, është një shenjë e qartë e mungesës së transparencës dhe rëndësisë që i kushtohet trashëgimisë letrare shqiptare. Ky është një problem jo vetëm për lexuesit shqiptarë, por për vetë konceptin e drejtësisë kulturore. Në një institucion që duhet të pasqyrojë diversitetin etnik dhe kulturor të vendit, është e papranueshme që një komunitet i tërë të ndjejë përjashtim dhe diskriminim. Sot Shkupi është me dy universitete shqip si dhe me disa fakultete për shqiptarët! Pra, nëse flasim për një angazhim kombëtar politik, madje edhe për një luftë tashmë të kryer (2001) për një shoqëri të drejtë dhe të barabartë, dhe nëse nuk e kemi një Bibliotekë nacionale shqiptare, atëherë të paktën është e domosdoshme dhe e patjetërsueshme që sa më parë në Bibliotekën ekzistuese të krijohet një departament dedikuar librit shqip dhe shqiptarëve. Ky departament duhet të ketë kompetenca për të administruar fondin e librave shqip, duke siguruar që ata të ruhen dhe trajtohen me dinjitetin dhe kujdesin që meritojnë. Ai duhet gjithashtu të ketë zyra të veçanta për dorëzimin dhe qasjen e librave shqip, si dhe një magazinë ku këto libra të deponohen dhe të mbrohen nga dëmtimet apo humbjet, librat e vjetër të trajtohen nëpër laboratorë përkatës,

të shpëtohen nga myku e lagështia. Ka vite e vite që Biblioteka aktuale nuk bashkëpunon me Bibliotekat universitare të Shqipërisë dhe Kosovës. Në këtë Bibliotekë, nga fondi për ndërrim e blerje të titujve nga bibliotekat ndërkombëtare, ka vite e vite që nuk është kërkuar asnjë libër nga Shqipëria e Kosova! Padyshim, ky departament, përveç librit shqip do ta rriste përfshirjen edhe të punonjësve shqiptarë. Punësimi i specialistëve shqiptarë jo vetëm që do të përmirësonte shërbimin për lexuesit shqiptarë, por do të dërgonte një mesazh të qartë për respektimin e diversitetit dhe barazisë etnike në këtë institucion kombëtar. Këtë shqetësim mbi librin shqip disa mund ta interpretojnë si një kërkesë etnike, madje edhe nacionaliste e separatiste por, në të vërtetë, bëhet fjalë për respektimin e të drejtave kulturore dhe arsimore. Jo vetëm gjuha por, edhe trashëgimia letrare e kësaj gjuhe duhet të ruhet e të rregullohen me dispozita të veçanta ligjore. Shqiptarët janë pjesë përbërëse dhe jetike e shoqërisë në Maqedoninë e Veriut, dhe kontributi i tyre në kulturë, letërsi dhe dije është i pamohueshëm. Një departament i tillë nuk do të ishte vetëm në shërbim të shqiptarëve, por do të pasuronte të gjithë institucionin dhe do të kontribuonte në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

**Llogaridhënia e institucioneve kulturore**

Kultura, si përkufizim i tërësisë së arritjeve të një populli në fushën e prodhimit dhe zhvillimit shoqëror e mendor, përbën esencën e identitetit dhe progresit të tij. Kalimi nga sistemi komunist në atë pluralist u prit me entuziazëm të madh nga shqiptarët, pasi ata kishin arsye të shumta për të ndërjerë jo vetëm lirinë fizike, por edhe atë shpirtërore. Kjo kthesë historike në

jetën politike dhe shoqërore kërkonte të reflektohej gjithashtu në fushën e kulturës, pasi më në fund kishte ardhur momenti që artistët shqiptarë, pa asnjë frikë, të mund të dëgjonin dhe shprehnin lirinë e mendimit dhe zhvillimit shpirtëror. Por, përkundër shpresave për një zhvillim të hovshëm, pas kësaj periudhe u shfaqën shenjat e një kaosi kulturor, dhe një epokë e vlerave të dyshimta nisi të përhapet në art. Politika, natyrisht, nuk mund të qëndronte larg ndikimit në këtë proces dhe e përdori kulturën si mjet manipulimi, duke krijuar mjegullnaja dhe shpërndarë informacione përmes militantëve të paaftë, të cilët shpesh nuk ishin as të pajisur me njohuri elementare kulturore. Ky politizim i kulturës çoi në papërgjegjshmëri institucionale, e cila u shndërrua në një kod veprimi për shumë institucione kulturore.

Një tjetër problem i madh është se, fatkeqësisht, shumë institucione kulturore në Shqipëri dhe Kosovë nuk e kuptojnë asgjë nga përgjegjësia dhe llogaridhënia. Ka shumë institucione për të cilat opinioni publik as që e di se ekzistojnë. Në disa prej këtyre institucioneve, aktiviteti kulturor është i kufizuar ose thjesht shërben për të ofruar një "pushim" për punëtorët e kulturës, pa ndonjë impakt real në zhvillimin e fushës. Nëse nuk ka llogaridhënie, as të drejtpërdrejtë dhe as publike, është e pamundur të pritë zhvillim i qëndrueshëm në kulturë. Nuk është e drejtë që ky pasivitet të shpërblehet me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Pa një vizion të qartë për atë që duhet të arrihet, i cili do të pasqyronte një identitet të shëndoshë dhe të vërtetë kombëtar, do të mbetemi pas. Dhe kjo do të ndodhë derisa nuk do të funksionojë një sistem i përgjegjësive dhe llogaridhënies. Rilindësit tanë janë shembuj të shkëlqyer të angazhimit

për të mirën e kombit. Ata sakrifkuan gjithçka, përfshirë jetën, për një ideal të shenjtë, të cilin sot shumë individë të papërgjegjshëm e kanë përbuzur dhe shkelur. Për kaosin dhe daljen në pah të vlerave të dyshimta, dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Vetëm nëse ndodh kjo, mund të themi se hapi i parë është bërë për të orientuar zhvillimin kulturor në binaret e duhur.

#### Muzetë tona me themele në ajër

Dymbëdhjetë vite më parë, në përvjetorin e 100-të të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, u shpallën të themeluara disa muze, përfshirë edhe Muzeun e UÇK-së në Shkup. Ky muze, i vendosur në shtëpinë e Jashar Bej Shkupit, përbëhej nga një flamur kombëtar dhe disa fotografi e gjësede të dëshmorëve të luftës së vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, ky "muze" nuk dispononte as certifikatën e

pronësisë dhe as ndonjë bazë ligjore për të funksionuar si një institucion kulturor i njohur. Flamuri kombëtar dhe fotot u ekspozuan si një simbol, ndërsa, për disa vite, "fitimtarët" përkuleshin përpara tij, kryesisht gjatë periudhave zgjedhore. Sot, kjo shtëpi vazhdon të jetë e lënë pas dore, duke treguar se ky "muze" e ka humbur qëllimin e tij të vërtetë. Ata që shpallën këtë muze ishin njerëz me një bagazh luftarak, por ndoshta nuk e kuptuan që, për të themeluar një institucion të tillë, duhen më shumë se vetëm veprime simbolike - duhet kuptuar mirë ligji dhe procedurat për themelimin e muzeve dhe institucioneve kulturore, me atë se kush ka të drejtë dhe cilat kushte duhet të plotësohen për ngritjen e iniciativave për themelimin e institucioneve nacionale. Kjo është një problematikë më e gjerë, e cila lidhet me një përpjekje të vazhdueshme për të "ndërtuar" institucione nacionale pa pasur kuptimin e plotë të asaj që do të

thotë të krijosh një muze të ligjshëm dhe funksional. Pa njohur ligjet për themelimin e institucioneve kulturore dhe pa pasur përkrahjen e institucioneve përkatëse shtetërore dhe lokale, ideja për të ngritur një muze që ruan dhe nderon historinë kombëtare mund të shndërrohet në një përpjekje të dështuar dhe të pavlerë. Po ashtu, ky fenomen nuk është i kufizuar vetëm në Shkup. Edhe në Sllupçan, Sopot dhe Haraçinë janë ngritur "muze" të ngjashme, të cilat, përpos simbolikës, mungojnë në bazë ligjore dhe procedurale. Sot çdo shtëpi shqiptare në Maqedoninë e Veriut mund të shpallet "muze i lirisë" porse, ja që do të përballeshim me një kaos të papërballeshëm dhe me një keqinterpretim të vlerave kombëtare. Themelimi (dhe jo krijimi!) i një muzeu kërkon një proces të mirëfilltë institucional, me miratimin e autoriteteve shtetërore (Parlamenti), apo dhe lokale (kuvendet komunale),

dhe me një kornizë ligjore që garanton funksionimin e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare. Pa një ligj të qartë dhe pa një strukturë të rregulluar, çdo përpjekje për të ngritur një muze bëhet një shkelje e respektit për ata që dhanë jetën për lirinë dhe barazinë. Pa një ligj të dedikuar për heronjtë e UÇK-së dhe pa zë financiar nga buxheti shtetëror enkas për institucione të këtitilla kulturore, çdo "muze" do të mbetet një tallje me gjakun e dëshmorëve dhe do të përdoret për përfitime të tjera partiake, larg qëllimit të vërtetë për të nderuar ata që u flijuan për liri. Ky fenomen tregon se mungon një kuptim i plotë i asaj që do të thotë të ndërtohen dhe të menaxhohen institucione kulturore dhe kombëtare. Ka nevojë për një qasje më serioze dhe të strukturuar për të ruajtur dhe nderuar vlerat kombëtare, duke i institucionalizuar ato në mënyrë të ligjshme dhe të qëndrueshme.

## Midis nesh

# 10.000 POETË

**Letërsia nuk është një zeje që mund ta ushtrojë çereku i popullsisë, ose një numër caktuar personash. Sigurisht që nuk është e ndaluar që kushdo që ka frymëzim të shkruajë poezi dhe t'i botojë ato**



#### Erl KODRA

Ka shumë njerëz që kujtojnë se të shkruash vargje, kjo të bën automatikisht poet. Në fakt njerëzit që kanë vargëzuar kanë ekzistuar gjithmonë, që prej kohëve të lashta. Por shumë pak i kanë mbijetuar kohëve për shkaqe nga më të ndryshmet, por sigurisht, ata më të spikaturit për shkak të talentit dhe veprës origjinale. Togfjalëshi "vepër origjinale" ka rëndësi kritike për çdo vepër arti,

që do të thotë se ajo çfarë autori ka krijuar përmban një lloj origjinaliteti që e dallon nga veprat e autorëve të tjerë. Që një vepër të meritojë këtë vlerësim, ajo nuk duhet të jetë një përsëritje e rëndomtë ose amatore, por të përmbajë element unik që e dallojnë nga veprat e tjera, të autorëve të tjerë. Prandaj fakti se dikush ka aftësinë për të vargëzuar, nuk e bën punën e tij një vepër origjinale.

Letërsia nuk është një zeje që mund ta ushtrojë çereku i popullsisë, ose një

numër caktuar personash. Sigurisht që nuk është e ndaluar që kushdo që ka frymëzim të shkruajë poezi dhe t'i botojë ato. Por ky lloj aktiviteti nuk të bën domosdo autor me vepër origjinale. Puna është se shumica e atyre që bëjnë një punë të tillë, as që e kuptojnë se janë ku thërret qameti. Domethënë janë krejtësisht jashtë realitetit. Ata thjeshtë harxhojnë letër duke i shkaktuar një dëm të pariparueshëm artist.

Bollëku poetik ka ardhur në rritje

eksponenciale, gjë që ka krijuar një klimë mbytëse për poezinë e mirë. Të gjithë rendin të botojnë librat e tyre që nuk i blenë askush. Madje edhe kur ndonjë autor boton një libër të mirë, ai mbytet nga kashta poetike e "10,000 poetëve".

Kritika?! Herë tjetër.

(Marrë nga profili i autorit)

Letër nga diaspora

# TË HARRUARIT E PAHARRUAR

**Ndër shumë dilema që na imponohen si shoqëri është edhe kjo: a i kemi harruar disa nga artistët tanë që kontribuuan shumë për kulturën, artin dhe letërsinë shqiptare?**



**Neviana SHEHI/ Itali**

Harresa paraqet humbje të informacionit që është ruajtur në kujtesë dhe kjo natyrisht se ka ngjyrimë të dhimbshme. Si shumë popuj tjerë që u përballën me probleme të natyrave të ndryshme, edhe ne, shqiptarët, u bëmë shoqëri me shumë kontradikta, të cilat duket se më shumë janë pasojë e ngecjes në gjysmë të rrugës të tranzicionit, të cilit, fatkeqësisht, akoma nuk i shihet fundi. Ndër shumë dilema që na imponohen si shoqëri, është edhe kjo: a i kemi harruar disa nga artistët tanë që kontribuuan shumë për kulturën, artin dhe letërsinë shqiptare? Ose, sa i njohin brezat e rinj, bie fjala, Ernest Koliqin, piktorin Zef Kolombi, aktorin Bujar Lako e ndonjë tjetër, të cilët ka kohë që nuk jetojnë midis nesh! Është fakt se disa nga artistët shqiptarë që kanë kontribuar dhe i kanë dhënë shtysë kulturs tonë, nuk u vlerësuar siç duhet gjatë jetës së tyre dhe kjo mund të çojë në harrim-

in e tyre me kalimin e kohës. Kemi shumë shembuj që tregojnë se pas vdekjes së tyre, nuk bëhen përpjekje të mjaftueshme për të mbajtur gjallë kujtimin e tyre përmes institucioneve kulturore, aktiviteteve apo përmendoreve që mund të ndihmonin në ruajtjen e trashëgimisë së tyre. Shqipëria (por edhe hapësira tjetër shqiptare) ka kaluar përmes periudhash të ndryshme politike, që kanë ndikuar rëndë në zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës. Gjatë periudhës komuniste, shumë artistë të njohur u ndëshkuan, u shpërfillën ose u lanë anash për shkak të censurës dhe kontrollit të shtetit mbi artin, kurse pas rënies së regjimit, shoqëria shqiptare, fatkeqësisht, kaloi përmes një periudhë të pasigurt, ku përqendrimi ishte në transformimin e shpejtë dhe në zhvillimin ekonomik, kurse për trashëgiminë kulturore kujdesi ishte minimal. Tashmë e kemi të qartë se përditshmëria jonë është shumë dinamike dhe se jetojmë në një kohë kur media dhe industria e argëtimit po

bëhen gjithnjë e më të orientuara nga fitimi dhe ndikimi i trendëve të ndryshme. Artistët që u shquan ose shquhen për vlera më të thella kulturore janë lënë pas, duke u zëvendësuar nga ata që "morën" hov përmes mediave dhe rrjeteve sociale dhe të cilët shpesh përqendrohen në aspekte të tjera, siç janë fama, por edhe përfitimi material.

Është e kuptueshme se në një shoqëri që kalon nëpër zhvillime të shpejta dhe është e ndikuar nga globalizimi, vlerat kulturore tradicionale mund të shpërfillen në favor të influencave të reja. Pikërisht ky proces mund të çojë kah zhdukja e kujtimit për shumë artistët, kontributi i të cilëve kulturën tonë është më se evident. Fare nuk duhet të habitemi nëse institucionet tona kulturore, me apo pa vetëdije, të preferojnë të krijojnë një histori të re kulturore, e cila tendencë mëton të përfshijë figura dhe ngjarje të caktuara në forcimin e një identiteti të ri kombëtar, gjë që do të ishte shumë e dëmshme, sepse në këtë mënyrë

më nuk do të kishim vazhdimësi (pa ndërprerje) zhvillimi, aq më tepër kur dihet se në këtë mënyrë do të kishim marginalizim të shumë figurave të rëndësishme, pa të cilat kultura, arti dhe sidomos letërsia do të ishte e mangët.

Harresa e artistëve të shquar shqiptarë patjetër se është rezultat i faktorëve të shumtë, që përfshijnë aspekte sociale, politike dhe ekonomike. Për të parandaluar këtë harresë dhe për të vlerësuar më shumë ata që kontribuuan në pasurimin e kulturës shqiptare, është e rëndësishme që institucionet kulturore dhe shoqëria të angazhohen për ruajtjen dhe promovimin e veprave dhe veprimtarisë së këtyre artistëve. Vetëm në këtë mënyrë do t'ia dilnim që mos t'i harrojmë ata që vërtet janë të paharruar. Gabriel Garsia Marquez ka thënë: Ajo që ka rëndësi në jetë, nuk është ajo që të ka ndodhur, por ajo që ti e kujton dhe si e kujton atë.

Me shkas

# FESTË DHE REFLEKTIM

(Në 30 vjetorin e themelimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës)

**Nora HALIMI**

*“Edhe statujat vdesin, po nuk i vështrove;  
kam parë shpesh të tilla,  
për tokë, me sytë gjysmë të mbyllur;  
ato presin të shohin dikë të ndalet, t’i vështrojë.  
Atëherë statujat ngrihen sërish në këmbë.”*

Këto vargje të poetit të madh Ricos na bëjnë të kujtojmë sesa e rëndësishme është kujtesa, sidomos në ditë të shënuara e në përvjetorë të rëndësishëm, siç është 30 vjetori i themelimit të Universitetit të Tetovës dhe rrjedhimisht edhe Fakultetit të Arteve. Përvjetorë të këtillë nuk janë thjesht vite jubilarë dhe ditë feste për lirinë e fituar për të studiuar në gjuhën amë, janë ditë kur duhen kujtuar, vlerësuar dhe nderuar autorët e saj të vërtetë, themeluesit e tij, dëshmorët e kauzës së arsimit shqip dhe të gjithë ata që në një formë a tjetër kontribuuan për themelimin e Universitetit.

Duke i kujtuar dhe nderuar, “ata ngrihen sërish në këmbë” dhe qëndrojnë të gjallë në kujtesën tonë kolektive. Sakrifika e tyre sublime na ka lënë lakuriq para përgjegjësiwe personale dhe kolektive për t’u rritur dhe për të formësuar të ardhmen tonë. Rritja e shëndetshme vjen vetëm duke u kujdesur për rrënjët, duke respektuar historinë dhe kujtesën, sepse është ajo që i reziston kohës dhe fuqive të saj të shkatërrimit.

Arti përgjatë shekujve ka pasur gjithmonë lidhje komplekse me historinë dhe kujtesën. Artistët nuk mund ta shkëpusin veten nga determinimet historike dhe nga konteksti kohor ku kanë vendosur qenien e tyre. Falë dhuntisë së tyre krijuese, arrijnë që intimitja të bëhet shenjë dhe shprehje e fatit kolektiv dhe anasjelltas, shoqërorja, ngjarjet e rëndësishme historike të përthyhen si identitet dhe koordinatë personale.

Megjithatë, historia, sakrifika dhe pengesat e ndryshme në rrugën e rritës tonë 30 vjeçare nuk janë të vetëmjaftueshme dhe përcaktues të suksesit. Është sistemi i vlerave që është kultivuar dhe prodhuar përgjatë këtij 30 vjeçari.

Koha në këto raste jo vetëm ka rolin e

vet, por është gjykatës ekzakt i asaj çfarë është prodhuar në një kapitull të caktuar të historisë. Arti dhe artisti duhet të jetë dëshmitar i pakorruptueshëm i epokës së tij, duhet të ketë guximin të thotë të vërtetën dhe të ngrihet kundër çdo lloj sistemi që nëpërkëmb vlerat e njëmendta estetike, emancipuese, edukuese dhe që është kundër prirjes ekzistenciale njerëzore që është kërkimi. Fakulteti i Arteve, ndër vite, është cilësuar si një qendër e rëndësishme e krijimtarisë dhe kulturës. Përvjetori jubilar mund të shërbejë për të nxjerrë në pah kontributet e tij në edukimin e brezave të rinj dhe për të theksuar ndikimin që ka pasur në jetën kulturore të vendit, por përtej ceremonive dhe aktiviteteve festive, të cilat rrezikojnë të bien në kurthin e formalitetit. Ky vit jubilar duhet trajtuar edhe si një moment i bërjes së bilancit, mbylljes së një kapitulli dhe hapjes së një kapitulli tjetër, të cilit duhet t’i paraprijë “logaridhënia” dhe “logaribërja”.

Duke jetuar në një kohë amullie të përgjithshme, në një kohë kur raporti me të vërtetën është shumë i varfër, është sfidë në vetvete perceptimi i situatës reale, analiza dhe artikullimi i saj dhe është shumë më e lehtë të qenit spektator në një shfaqje të kuruar nga të tjerët. Faza e analizës dhe artikullimit kërkon dije dhe kthjelltësi mendimi dhe mbi gjithçka kurajo qytetare dhe intelektuale për të thënë të vërtetën, për t’i diagnostifikuar gabimet, për të vlerësuar punën e mirë dhe për të ndarë qartë vlerat nga jovlerat.

Në një kohë kur kufiri mes tyre jo vetëm që nuk ekziston më, por të krijohet përshtypje se kultura dhe krijimtaria mediokre ka mbisunduar vlerat, kur relativizimi dhe rëndomësi i jo vlerave është ulur këmbëkryq në jetën tonë shoqërore dhe mediokriteti është kthyer në standard, kur kemi lejuar që arti dhe kultura të bëhen pjesë e matematikave politike, kur padrejtësitë dhe të gjitha ndërvarësitë tjera të ngulfasin, ta heqin entuziazmin për të punuar, të shkurajojnë e të lodhin, kur i kemi humbur referencat e mirëfillta dhe jemi të prirë ta pranojmë formën pa obligime ndaj përmbajtjes, një pjesë e peshës së këtij dështimi dhe zhgënjimi bie rëndshëm edhe mbi punën e institucioneve të artit dhe kulturës.

Çfarë mundet dhe çfarë duhet të bëjë Fakulteti i Arteve dhe institucionet tjera përkatëse për të dalë nga kjo gjendje, cilat janë sfidat me të cilat duhet të përballen?! George Bernard Show, një figurë e rëndësishme për mënyrën se si e përdori teatrin për të sfiduar dhe ndryshuar shoqërinë mes tjerash, ka thënë: “I vetmi njeri që sillet në mënyrë të arsyeshme ishte rrobaqepësi im: ma merrte përsëri masën sa herë që më shihte, ndërsa të gjithë të tjerët vazhduan me matjet e vjetra dhe prisnin që ato të më përshtateshin.”

Fakulteti i Arteve bashkë me të gjitha institucionet tjera relevante të artit duhet të sillen në mënyrë të arsyeshme duke bërë matje të sakta të situatës aktuale dhe të përpiqen të qepin rroba që do t’i përshtaten nevojave të kohës. Në raste të këtilla, arti dhe artisti duhet të kthehet në rezistencë kundër anomalive që mbizotërojnë realitetin tonë artistik dhe kulturor. Arti i vërtetë pa filtra të konvencioneve shoqërore duhet të na shkund për të na çliruar. Më e pakta, duhet të krijojë hapësirë për debat të hapur kritik, duhet të provokojë dhe stimulojë mendimin dhe veprimin e lirë kreativ publik, të bazuar në dije dhe punë sistematike.

Kur flitet për institucione, duhet thënë qartë se veprimi kolektiv është shumë i vështirë, sidomos kur bëhet fjalë për komunitete të vogla ku dashje pa dashje e gjejmë veten brenda vorbullës së hatërmbetjes, bërjeqejfit pa pasur mundësinë e kultivimit të një distance etike, të shëndetshme me njëri tjetrin, distancë e cila do të na kishte ndihmuar të çlirohemi nga kjo peshë e dëmshme për shoqërinë në raport me të vërtetën dhe do të kishte stimuluar ndjenjën e përgjegjësisë individuale dhe kolektive në ndërtimin e institucioneve funksionale dhe progresive.

Subjektiviteti në vlerësimin e produktit artistik sot është një sfidë serioze, sepse është vështirë të përcaktohen kriteret e qarta për vlerësim ose për matjen e suksesit, veçanërisht kur mësimdhënësit dhe studentët angazhohen me veprimtari krijuese në kontekst arsimor në nivele të ndryshme komoditeti ose përvoja. Një gjë tjetër që vështirëson funksionimin institucional, është mospasja e autonomisë së plotë në vendimmarrje për shkak të ndërvarësive

të ndryshme nga instanca më të larta të sistemit arsimor. Buxhetet e kufizuara dhe mungesa e burimeve financiare ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin dhe zhvillimin e institucioneve të artit, duke vënë në rrezik përbushjen e plotë të misionit të tyre, qoftë akademik apo krijues dhe duke e kufizuar kështu shtrirjen dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Arti duhet parë si një mjet transformues në arsim, duke eksploruar mënyrat se si mund t’i rridefinojë qëllimet arsimore, duke nxitur jo vetëm suksesin akademik, por edhe zhvillimin e plotë të studentëve si individë të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar me botën në mënyra domethënëse. Ky rridefinim nënkupton nxitjen e mendimit kritik, integrimin e mësimin ndërdisiplinor, kultivimin e empatisë, inteligjencës emocionale dhe të kuptuarit e diversitetit kulturor që çon drejt një mendësie më gjithpërfshirëse, nxitjen e bashkëpunimit dhe angazhimit në komunitet, gjë që do t’i kishte ndihmuar studentët jo vetëm në përpjekjet e tyre artistike, por edhe në kontekste më të gjëra arsimore dhe shoqërore.

Arti duhet të krijojë mundësi për një edukim që nuk ka vetëm karakter didaktik, por që shtrihet përtej auditiveve, duke lidhur përmbajtjen akademike me sfidat dhe kontekstet reale të shoqërisë. Jo çdo student që studion dhe angazhohet me veprimtari krijuese mund të bëhet artist dhe jo çdo mësimdhënës i angazhuar në edukimin artistik të gjeneratave të reja jo detyrimisht është artist, prandaj duhen inkurajuar të dy palët që përpos përpjekjeve të vazhdueshme për të krijuar, së paku të jenë pjesëmarrës të ndërgjegjshëm dhe aktivë në ndërtimin e një shoqërie dhe bote më të mirë, pa dëmtuar integritetin artistik të përfaqësuesve të saj shpirtërorë.

Një tragjedi e pashmëshme për vendin dhe të ardhmen e tij, do të ishte epilogu i një shoqërie që fle kur duhet të ulërijë. Shkatërrimi kulturor ka implikime më të thella sesa thjesht një shije e keqe që i ofrohet një brezi të caktuar në raport me ndjeshmërinë dhe vlerat e vërteta artistike. Momentet e këtilla të reflektimit duhet të na ndihmojnë për të kuptuar më shumë se sa të sotmen, udhën e të nesërme dhe vizionin tonë për të ardhmen.



Me Ali Aliun, kritik letrar

# ÇDO LETËRSI FRYMËZOHET NGA REALITETI PËRRETH

**Ku qëndron letërsia jonë> Krahasuar me letërsinë e mëdha, me tradita shumë shekullore, një letërsi relativisht e re, plus në kushte të vështira zhvillimi lirie dhe hapësire, do të thosha që tashti e hapur nga të gjitha ndikimet për fat, e kërkon veten, kërkon dhe synon individualitet.**



## Shkëlzen HALIMI

Ali Aliu padyshim se është një nga figurat më të shquara të kritikës dhe letërsisë shqiptare. U lind më 1934 në Kranjë të Prespës (Republika e Maqedonisë së Veriut). Shkollën tetëvjeçare e filloi në vendlindje dhe e kreu në Manastir më 1951, ndërsa Shkollën Normale në Shkup më 1955. Studimet universitare (albanologji) i mbaroi në Beograd në vitin 1960. Pas studimeve zuri punë si gazetar në redaksinë "Flaka e villaznimit" në Shkup. Prej vitit 1969 deri në vitin 1972 punoi redaktor në Edicionin e Botimeve "Rilindja" në Prishtinë. Doktoroi në Universitetin e Prishtinës më 1973 duke mbrojtur tezën "Jeta dhe vepra e Petro Markos". Që nga viti 1972 deri në pensionim ishte ligjërues, docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, përkatësisht në Fakultetin Filologjik të Prishtinës, për lëndën Teori e letërsisë. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë së Veriut.

Ali Aliu, siç thamë është studiues i letërsisë bashkëkohore shqiptare, fushë nga e cila ka botuar shumë vepra. Është autor i disa dhjetave veprave me shkrime kritike, por edhe i shumë teksteve shkollore.

**HEJZA:** Profesor, po e nisim këtë intervistë duke ju kthyer në periudhën kur ju ishit student në Beograd, në mungesë të kushteve për shkollim të lartë në Kosovë apo në viset e tjera etnike! Pa dyshim, në këtë kohë do të krijohet një grupim i rëndësishëm intelektual shqiptar të cilët do të bëhen shtyllat e letërsisë shqiptare në Kosovën dhe viset etnike pas luftës së dytë botërore, si dhe përcues të mendimit kritik në shoqërinë tonë asokohe tejet tradicionaliste. Cilat ishin disa nga figurat më të rëndësishme letrare e kulturore që do t'i veçonit nga ajo kohë?

**ALI ALIU:** Po. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe deri nga gjysma e viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar, të rinjtë shqiptarë nga Kosova dhe hapësirat tjera në ish Jugosllavi, studimet universitare, në më të shumtën e rasteve, i bënin në Beograd, si dhe në qendra të tjera të shtetit, si Zagrebi, Ljubljana, Shkupi etj. Brezi im që

i filloi studimet nga gjysma e dytë e viteve '50 e deri në fillim të '60, në kryeqytetin e ish Jugosllavisë, shënonte numrin më të madh të studentëve shqiptarë. Para këtij brezi, në Beograd kishin kryer studimet disa breza. Para nesh ajo e Enver Gjergjekut, Ramiz Kelmendit, Murat Isakut, Hilmi Aganit, Fehmi Aganit etj. Gjenerata për të cilën flas, nga fundi i studimeve në gjirin e vet numëronte rreth 800 studentë të shpërndarë në universitete dhe fakultete të ndryshme të kryeqytetit. Shpesh bënim shëtitje, ekskursione të përbashkëta në rrethinat e Beogradit dhe përpjekje për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta. Në këtë kontekst, nga fundi i '50, një grupi i brezit tim (Agim Gjakova, Latif Berisha, Zekirija Cana, Gazmend Zajmi, Ymer Jaka, Bekim Fehmiu etj. vendosëm që të themelojmë shoqatën e parë shqiptare të studentëve në ish-Jugosllavi. E pagëzuam "Përpjekje". Fituam lokale në qendrën studentore si dhe në aparat radio, dhe në gjirin e këtij klubi vinte një numër konstant i studentëve. Pas një kohe vendosëm të themelojmë edhe një revistë. Përgatitëm dokumentet dhe ecëm procedurave administrative për ta regjistruar. Që të fitojmë edhe

ndihmën financiare, një grup tre vetash: Agim Gjakova, Zekirija Cana dhe unë kërkuaam takim me sekretarin e përgjithshëm të rinisë Jugosllave, që aso kohe ishte kroati Miko Tripalo. Na pranoi miqësisht, e pa afërsisht edhe koston financiare të fletushkës të përmuajshme, duke thënë se nuk përbën kurrfarë problemi. Mirë deri këtu. Por, besimi dhe shpresa se do t'i arrinin synimet, objektivin tonë, një mbrëmje çdo gjë u përmbys – na i mbyllën me çelësa të ri lokalit, një ditë pas filloi ftesa dhe pyetjet nëpër sekretariatet e policisë. Ky ishte faktikisht fundi i kësaj përpjekjeje të brezit tim, që nga Maqedonia ishin dibranët Nehat Bellçishta, Mahmut Hysa, Remzi Nesimi, Musa Arifi, Ditar Qamili, unë etj.

**HEJZA:** Cilët janë kujtimet më të spikatura nga ajo periudhë studentore? A ka ndonjë moment apo ngjarje që do t'i shpalosnin sot e të cilat mendoni se shënuan kthesa në rrugën tuaj profesionale?

**ALI ALIU:** Gjatë studimeve katër vjeçare në Beograd, unë frekuentoja rregullisht manifestimet, takimet, kruzhoqet letrarë që bëheshin në kuadër të Fakultetit Filozofik, edhe në nivel të universitetit, por edhe



të kryeqytetit. Sidomos bisedat dhe ligjëratat të shkrimtarëve të njohur nga Evropa dhe më gjerë që ftoheshin nga qendra e institucione të kryeqytetit. Delegacione e grupe, sidomos krijuesish evropianë, për të cilët Beogradi ishte i hapur. Shfrytëzoja parapagimin vjetor të lirë (simbolik) të teatrove, e sidomos atij të dramës Jugosllave, në skenën e të cilit kishte filluar të debutojë si student Bekimi.

**HEJZA:** Në retrospektivë, si e shihni rolin tuaj dhe të bashkëkohësve të asaj periudhe në krijimin e një tradite të mirëfilltë kritike dhe letrare në viset etnike jashtë shtetit amë?

**ALI ALIU:** Po flasim për një periudhë kur në mjediset e hapësirës shqiptare në ish Jugosllavi ende nuk kishte veprimtari dhe punë të organizuar në mes të shkrimtarëve. Letërsia shqipe sikur niste nga fillimi. Në Kosovë ajo lidhet me themelimin e revistës letrare "Jeta e Re", nën udhëheqjen e Esad Mekulit, që u bë vatra e parë e jetës krijuese letrare dhe kulturore.

**HEJZA:** Ju keni qenë dëshmitar dhe pjesëmarrës i zhvillimit të dy brezave krijues: njëri i frymëzuar nga rilindësit dhe tradita popullore, dhe tjetri që traso i rrugën e artit modern. Tani, nëse moderne quhet

gjithë ajo që shkëputet prej traditës, ndërsa tradicionale ngelë gjithë ajo që i reziston modernizimit, atëherë ku e shihni kufirin në mes të krijimtarisë tradicionale dhe krijimtarisë moderne në letërsinë shqipe?

**ALI ALIU:** Edhe në ato shkolla të pakta të mesme a gjimnaze, kryesisht në Kosovë, e në viset e tjera shumë të vonshme, ku mund të figuronte në program lënda "Histori e Letërsisë Shqipe", në kuptimin pra të traditës rilindëse, nuk ekzistonin kushtet as kadrovike e as vullnet politik për një interpretim normal të kësaj tradite. Dua të them se edhe po të ishte, edhe të provohej të interpretohej, ajo nënkuptonte kryesisht një biografi të reduktuar të rilindësve më të njohur dhe rastësisht tek-tuk edhe ndonjë libër që mund të ndodhej tek individë ose edhe ndonjë bibliotekë gjimnazi, rastësisht të ruajtur dhe të trashëguar nga ato dy-tre vite arsimit shqiptar dhe në gjuhën shqipe gjatë kohës së Italisë. Kaq për pranimin e trashëgimisë letrare të shkruar në shqip, duke mos e përfshirë këtu letërsinë gojore që ishte e vetnja mbështetje për individët e parë pas luftës të cilët filluan të krijojnë letërsi. Megjithatë, çuditërisht shpejt, pas brezit të Esad Mekulit, Hivzi Sulejmanit, Sitki Imamit, Zekiria Rexhaj, Tajar

Hatipit etj. filluan të konsolidohen brezat. Pas tyre vijnë më të ngjeshur, më në kompaktësi letrare brezi i Enver Gjergjekut, Ramiz Kelmendit, Murat Isakut, Rexhep Hoxhës, që do të pasohet nga brezi të themi i tretë, kushtimisht, i Azem Shkrelit, Ali Podrimjes, Fahredin Gungës, Rrahman Dedajt (gjithnjë në poezi), vepra e të cilëve që në fund të gjashtëdhjetave dhe në fillim të shtatëdhjetave u vërvit në majat e vlerave poetike të hapësirës për të cilën flasim. Kontaktet e letërsisë shqipe të këtij krahu, siç e thoshim në ish Jugosllavi, dhe atij të shtetit shqiptar, gati se nuk ekzistonin. Një urë komunikimi mes Prishtinës dhe Tiranës në rrafshin e arsimit, kulturës, arteve, letërsisë, sidomos do të fillonin dhe do të përfundonin vetëm brenda një dhjetëvjetëshi, siç e quanim dhjetëvjetëshi i artë i viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar.

**HEJZA:** Çfarë elementesh moderne gjejmë në letërsinë tonë tradicionale? Si është përfshirë tradita në letërsinë bashkëkohore shqiptare?

**ALI ALIU:** Do të dëshiroja, në këtë bashkëbisedim, që për lexuesit tuaj ta thjeshtoja pak terminologjinë teorike letrare; ju me të drejtë pyetni për reflekset e para moderne të letërsisë tonë. Qëkurse ekziston

letërsia, ata që e kanë krijuar, që e krijojnë dhe do të vazhdojnë, janë individët, talenti, dhuntia e tyre për të rrëfyer kohën e vet, në fakt për të rrëfyer veten në kohën e vet, në epokën e vet. Edhe shkrimtarët janë individë që lindin njësoj si gjithë të tjerët, tek të cilët çdo epokë, çdo kthesë e madhe, ngritje a rënie, ndikojnë në perceptimin e botës së vet, krijojnë ndjesitë, vizion për jetën, ekzistencën, shkencën, lindjen, vdekjen, filozofinë, kohën hapësirën dhe të gjitha këto ndikojnë në artin përmes fjalës, për dallim nga artet e tjera të ngjyrës, tingullit etj. dhe pikërisht kjo mënyrë rrëfimi, që mbështetet edhe në shkolla, që sjell risi në gjuhë, në figuracion, është risia, novatorizmi që mandej evidentohet nga studiuesit si një metodë e re, pra edhe moderne, post moderne, në këtë kuptim lindin edhe shkollat. E tashti ku qëndron letërsia jonë në këto shtresime. Krahasuar me letërsitë e mëdha, me tradita shumë shekullore, një letërsi relativisht e re, plus në kushte të vështira zhvillimi lirie dhe hapësire, do të thosha që tashti e hapur nga të gjitha ndikimet për fat, e kërkon veten, kërkon dhe synon individualitet.

**HEJZA:** Cili është mendimi juaj për gjendjen aktuale të letërsisë shqipe? A mendoni se po ecën drejt një moderniteti të mirëfilltë, apo ende



përballet me pengesa?

**ALI ALIU:** Në një mozaik të tillë aktual, letërsia shqipe aktualisht zhvillohet në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, por edhe në Luginën e Preshevës, e në Mal të Zi dhe në diasporë. Edhe përpos prirjeve, duke pasur si mjet shprehës gjuhën e përbashkët, kam përshtypje që secila qendër letrare preferon zë autonom. Mungojnë mekanizma të njëjtë vlerësimi. Ka dallime perceptimi të veçantë te lexuesit. Ka fare pak bashkëpunim mes institucioneve që prodhojnë librin, që e nxjerrin në treg, që e reklamojnë, që e vlerësojnë. Më të talentuarit dhe ata që arrijnë të veçohen nga kallaballëku, kanë lexuesit e vet, pavarësinë e vet dhe sikur nuk kanë nevojë për një unifikim të statuseve dhe distancave. Meqë revista juaj funksionon në hapësirën e letërsisë shqipe në Maqedoninë e Veriut, edhe ky kapitull i letërsisë shqipe ndjek këto trende: si e papërfillur nga qendrat, ajo ka filluar dhe po ndjek prirjen e vetëmenaxhimit, ka filluar t'i mjaftojë hapësira që ka dhe brenda saj të krijojë statuset e cilësimit, hierarkinë e vlerave, që vijnë edhe si rezultat i manifestimeve, i çmimeve përmes formimit të jurive letrare, t'u mjaftojë afirmimi dhe vetëbesimi brenda kësaj hapësire, por gjithnjë me një vesh e me një sy për të përcjellë ç'ndodh qendrave. Një prirje të tillë e kam vënë re në Tetovë sidomos, qytet që është qendër e dy universiteteve në gjuhën shqipe, qytet që ka një traditë letrare të themi njëqindvjeçare, që zhvillon një aktivitet botues serioz dhe me nivel.

**HEJZA:** Në Shqipëri, për gjysmë dekadë u kultivua letërsia e diktuar prej regjimit diktatorial! Në viset etnike, sidomos në Kosovë, u rezistua fuqishëm kundër politikave shovene që synonin për të krijuar një letërsi politike antikombëtare. Krijimtaria artistike gjeti shteg te metafora? "Disidentë plotë", andej e këndej kufirit, por letërsi disidente fare? Historia jonë më e re ka shënuar mijëra ngjarje nga më të trishtat dhe nga më të papërfjetuarat nga askush në këtë kontinent! Pra, ndonëse kemi po aq shumë tema të freskëta, ne lajtmotivet edhe më tej i kërkojmë në lashtësi, në mitologji e në folklor. Pse?

**ALI ALIU:** Po, në gjysmën e dytë të shekullit XX, letërsia në Shqipëri u vu nën ideologji të pagëzuar si doktrinë e realizimit socialist. Ndërsa krahu tjetër e kësaj letërsie, ajo e shqiptarëve në hapësirën ish Jugosllave, zhvillohej nën një survejim tjetërsj ideologjik. Edhe pse Jugosllavia, që politikisht qëndronte në mes të lindjes dhe perëndimit, kryesisht e çliruar nga dogma, ishte mjaft e hapur ndaj ndikimeve, rrjedhave dhe trendëve evropiane, por edhe botërore. Mund të thuhet që qendrat kryesore letrare në të, si: Beogradi, Zagrebi, Lubjana ishin krejtësisht të lira për komunikim me botën, pra edhe letërsia dhe artet e tjera në këto qendra ishin në mos plotësisht të

lira, kryesisht të lira. Përjashtim bënte vetëm letërsia që zhvillohej në gjuhën shqipe, sidomos ajo në Kosovë, por edhe në Maqedoni dhe viset tjera; dhe kryesisht të izoluar, letërsia në shtetin shqiptar me letërsinë jashtë kufirit - me përjashtim të një periudhe të shkurtër, siç e thamë më sipër, brenda dhjetëvjetëshit të viteve '70 - nuk to të kenë kontakte. Por, kur jam këtu, dua të theksoj edhe një fenomen, ose një paragjykim, që lidhet me dhuntinë krijuese dhe vlerat, qo do të thotë, talente lindin njësoj si në perandori diktatoriale, si në hapësira demokratike. Rrethanat, zhvillimi dhe krijimtaria e tyre pengohet ose lihet e lirë. Natyrisht që letërsia në shtetin shqiptar u pengua të vazhdonte ritmindhehovinë e letërsisë, sidomos të viteve '20 dhe '30 të shekullit XX. Por brenda atij harku kohor në gjirin e asaj letërsie lindën talente të mëdhenj, të shquar. Të përmendim emrat: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, por edhe dhjetëra të tjera si: Zija Çela, Fatos Kongoli, që gjetën shtigje për të dalë përtej dogmës, në një pjesë të krijimtarisë së tyre. Dhe shkrimtarët, krijuesit, gjithnjë vlerësohen nga maja më e lartë në të cilën mjafton të jetë ulur bindshëm edhe vetëm me një kryevepër. Letërsia në Kosovë, është e vërtetë, bënte përpjekje që t'i rezistojë politikës serbe, sidomos kundër gjuhës shqipe dhe kundër vlerave shpirtërore që kultivonin ndjenjën e identitetit kombëtar, lashtësinë, rrënjët e gjuhës dhe traditës, gjithë përmes një sistemi cesurash të rrepta; dhe e keni vërejtur mirë ju në pyetjen për një shtegdalje nga kjo censurë, siç ndodhi me poezinë e brezit të tretë në Kosovë, ajo e Shkreli, Podrimjes etj. Edhe kur u duk nga jashtë Kosovës ndonjëherë se letërsisë shqipe të Kosovës sikur i mungon rezistenca ndaj pushtuesit, ajo në fakt, poezia, kishte gjetur rrugën e komunikimit me lexuesin, i cili ishte me të vërtetë i etshëm për porosinë që sillte letërsia dhe kryesisht poezia, përmes gjuhës ezopike. Dy palët krijuan një komunikim në heshtje dhe kjo kishte në sfond, ma merr mendja, një fuqi të madhe krijuese: vetë shpërthimi i poezisë shqipe në Kosovë (gjithnjë kam parasysh numrin e madh të studentëve nga gjithë hapësira shqiptare e ish Jugosllavisë, që shkollohej në Universitetin e Prishtinës, që botonin dhe realizoheshin si krijues përmes Rilindjes si shtëpi botuese, Rilindjes si gazetë, Prishtinës si qendër kulturore...) dhe nga ana tjetër vetëdija e rinisë shkollore sidomos, për të qenë pjesëtar aktiv i krejt këtij hovi shpirtëror. Mbase, sikur të dy palët kishin të akumuluar brenda vizionin, gatishmërinë për të kompensuar sa është e mundur kohën e humbur, përmes ritmit për t'i mbërritur të tjerët. Them mbase kjo shpjegon se si studentët tanë, nga vitet '70 kishin arritur të jenë të barabartë gjatë studimeve pasuniversitare në Beograd, e Zagreb, e Lubjanë, e Shkup, por edhe pedagogët jetonin me këtë ritëm, sa më shpejt për të arritur dhe për të qenë të barabartë me ata të këtyre qendrave. Pra sikur

ishte një rizgjim, apo të themi një rilindje. Ndërsa për disidentizmin që e përmendni ju, natyrisht që nuk ishte fenomen dallues, siç ishte në disa vende të tjera të lindjes. Bile edhe letërsia e ashtuquajtur e krijuar brenda burgjeve në Shqipëri dhe që pas rënies të diktaturës pritej se do të sjellë diçka të paparë në këtë drejtim, siç e dimë nuk ndodhi. Dëshiroj t'i kthehem me këtë rast edhe krijimtarisë letrare në Shqipëri dhe në Kosovë, përkatësisht si dhe sa kanë arritur dhe po arrijnë këta dy krahe të frymëzohen, të parët nga regjimi socialist i diktaturës, të dytët nga ai i okupuesit, sidomos tema e luftës së fundit, të cilën po e përmendni edhe ju. Edhe në Shqipëri tanimë janë me dhjeta vepra, kryesisht në prozë, që i janë kthyer periudhës së diktaturës komuniste. Sa dhe cila nga ato përjetohet në përmasa që shkaktoi kjo ideologji. Ndoshta duhet pritur ajo e përmasave reale. Për luftën në Kosovë kam përshtypje se ekzistojnë disa vepra që janë në letërsinë artistike të sjelljes së kësaj lufte përmes fjalës artistike. Ka më shumë, por me këtë rast po përmend më të arriturat, siç është romani i Mehmet Krajës "Liria ime", roman i Ag Apollonit "Fije shkrepse, fije shprese", por edhe romani i Migjen Kelmendit "Darka ndër bomba" që u hodh në treg pikërisht gjatë këtij muaji.

**HEJZA:** Letërsia botërore shpesh përqendrohet në universalizmin e përvojave njerëzore. Si mendoni se letërsia shqiptare mund të mbështetet te përvoja lokale për të arritur një ndikim ndërkombëtar?

**ALI ALIU:** Universalja dhe lokalja në letërsi janë raporte të njohura në krijimtarinë artistike. Thënë shkurtimisht, vlera e vërtetë e artit lindur në hapësirë lokale, e ka pasaportën brenda për të qenë edhe vlerë universale. Është fenomen i vetvetishëm, i natyrshëm. Nuk vjen si programim, se atëherë raportet janë mekanike, jo të natyrshme dhe që në fakt cedimi lidhet me modestinë e vlerës konkrete. Si qëndron letërsia jonë në këtë drejtim? Besoj që është mirë që ka laramani, sidomos të shkollave letrare në botë, që ka laramani zërash, që mbështetet në një doktrinë ose në një tjetër, dhe kur autorët e tillë arrijnë t'i bëjnë të vetat, t'i bluajnë në studion e vet letrare, dëshmojnë fuqinë e talentit të vet. Personalisht ju besoj pandehmave se çdo letërsi e një gjuhe, e një hapësire, frymëzohet dhe krijon perceptim, por edhe vizion dhe filozofi, nga realiteti përreth. Kështu që përmes ngjyrimit shpirtëror dhe mendor të atij ambienti, pra ajo që e rrëfen bëhet bindëse dhe e besueshme universalisht në kohë dhe në hapësirë, e ka gjetur komunikimin e përhershëm në kohë.

**HEJZA:** Kritika letrare ndër ne është një prej punëve intelektuale më pak e vlerësuar! Kritika letrare ndër ne trajtohet si produkt vullnetar i një "lexuesi profesional", i cili dëshiron t'i shprehë përshtypjet e mira nga leximi i një veprë! Si e përshkruani rolin e kritikës letrare në pasurimin

e një letërsie kombëtare? A mendoni se kritika shqiptare ka arritur të plotësojë këtë rol? Ju jeni një nga figurat kyçe të kritikës letrare shqiptare. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballet një kritik në ruajtjen e integritetit dhe objektivitetit të tij?

**ALI ALIU:** Ju, përmes disa pyetjeve, shtroni problemin e kritikës letrare në përgjithësi dhe kritikës letrare tek ne. Mbase është një problem që kërkon më shumë vëmendje. Përmendet shpesh refreni që mungon kritika letrare, që nga një perspektivë është konstatim i vërtetë. Nga një perspektivë tjetër, mbase edhe mund të debatohet. Është e vërtetë se kritika letrare nuk është fare e pranishme në mediat audovizive, të shkruara, elektronike. Sa i mungon kjo letërsisë, çfarë mund të jenë pasojat kur mungon, dhe çfarë mund të jenë të mirat kur është e pranishme? Te ne mungon sepse ashtu e dikton tregu botën mediatike, e cila në faqet e veta, në pasqyrat e veta, sjell lëndën që e kërkon lexuesi. Nga ana tjetër, nuk mungon kritika studimore, monografike. Nuk mungojnë as botimet e tilla, prania e botimeve të tilla në programet e shtëpive botuese, të institucioneve, siç janë institutet, akademitë, të cilat kryesisht botojnë këtë formë të kritikës letrare. Dallimi mes kësaj forme dhe kritikës së ditës ndërsa, është dallim i madh. Kritika e ditës, në radhë të parë, bën evidentimin e botimeve, e që kjo nuk ekziston. Edhe kur lexuesi është e prirë drejt librit, e ka të vështirë ta gjejë botuesin, ta gjejë librarinë, pra që është nevoja e parë më praktike. E dyta, kritika e ditës bën një diferencim, sado të lehtë, të shpejtë, duke klasifikuar vlerat e para, të dyta, mbase edhe mungesën e tyre, në raste të caktuara. Në mungesë të kësaj kritike merr përsipër t'i bëjë reklamë dhe ta afirmojë librin e vet vetë autorit, përmes promovimeve, që shpesh bëhen të zhurmshme, me prani kallaballëku; dhe të pranishmit nëse do të thonë gjë, do të thonë vetëm fjalë të mira. Dhe në këtë kallaballëk, natyrisht më të paktit janë të talentuarit, që njëkohësisht e kanë më të vështirë të çajnë, të dallohen. Pasojat e rënda të mungesës të një kritike të mirëfilltë të ditës, unë i shoh edhe në dhënien e çmimeve për një vepër letrare të një zhanri të caktuar, brenda një viti apo më shumë viteve botuese, të një regjioni a të një krahine, ku ndodhin deformime gati më drastike dhe shpesh më të shëmtuara. Qoftë kur ato organizohen gjatë festave të librit, panaireve, juria zgjidhet sipas asaj që botuesi, bie fjala, e ka caktuar autorin e librit që t'i japë çmim. Anëtarët e jurive të tilla e kanë dhënë, e kanë falur, e kanë shitur votën, dhe as nuk duan t'ia dinë se libri fitues është disa shkallë nën, bie fjala, pesë të zgjedhurve apo dhjetë të zgjedhurve tjerë. Besoj që ky është dëm i madh. Është fenomen që duhet të nxisë vetë krijuesit e talentuar, krijuesit me ndikim, me zë, që tani në hapësirën shqiptare letrare janë aq të shumtë dhe me përgatitje, që t'i pritët hovi këtij fenomeni.

*Nga Arkivi*

# STRATEGJI NACIONALLE PËR NJË IDENTITET KULTUROR TË CENTRALIZUAR

**Qëllimi i propagandës së regjimit enverist në sferën kulturore, ishte të forconte identitetin kombëtar shqiptar dhe të lidhte shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera me Shqipërinë, duke promovuar një imazh të unitetit kombëtar nën udhëheqjen e regjimit socialist**



**Nga Avni HALIMI**

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, historia e Kosovës dhe e shqiptarëve në përgjithësi u dominua nga një narrativë e ngushtë ideologjike e përcaktuar nga regjimi komunist i Jugosllavisë dhe i Shqipërisë. Në këtë narrativë, figura të ndritura dhe lëvizje nacionaliste që kishin kontribuar për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve, si luftëtarët e Ballit Kombëtar, anëtarët e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (NDSH), dhe udhëheqës të rezistencës, si Shaban Polluzha, Hoxhë Idriz Gjilani, Xhemë Gostivari, Sulë Hotla, Adem Demaçi etj., u marginalizuan dhe u fshinë nga historiografia zyrtare. Përse ndodhi kjo dhe cilat janë pasojat e kësaj mungese në diskursin historik të Shqipërisë socialiste?

**Narrativa komuniste dhe shpërfillja e nacionalizmit shqiptar**

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë dhe në të gjithë Jugosllavinë, historia u shkrua nga fituesit - komunistët. Narrativa zyrtare ishte e përqendruar rreth "bashkim-vëllazërimit" dhe mbi rolin e Partisë Komuniste në çlirimin e popujve të Ballkanit dhe më gjerë. Në këtë kontekst, çdo lëvizje apo individ që nuk i përkiste frontit komunist u shpall si kolaboracionist ose si armik

i popullit, pavarësisht motiveve dhe kontributit të tyre real. Luftëtarët e Ballit Kombëtar dhe NDSH-ja ishin ndër të parët që u përjashtuan nga kjo narrativë. Edhe pse shumë prej tyre kishin luftuar për mbrojtjen e territoreve shqiptare dhe për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera etnike, ata u shpallën tradhtarë për shkak të përplasjes me komunistët dhe mospranimit të ideologjisë socialiste. Në vend që të përkujtoheshin për qëndresën e tyre ndaj pushtimeve të huaja dhe përpjekjet për autonomi, ata u stigmatizuan si reaksionarë dhe mbështetës të pushtuesve. Përjashtimi i këtyre figurave dhe lëvizjeve nga historiografia zyrtare ka pasur pasojat e thella për kujtesën historike dhe identitetin kombëtar të shqiptarëve të ngelur jashtë shtetit amë. Stigmatizimi i nacionalistëve ka lënë pas një boshllëk të madh në të kuptuarit e historisë së rezistencës shqiptare kundër pushtimit dhe represionit. Kjo narrativë e njëanshme e shkruar nga fituesit ka ndikuar në krijimin e një perceptimi të shtrembëruar të historisë, ku nacionalistët janë parë si tradhtarë, ndërkohë që shumë prej tyre luftuan për mbrojtjen e popullit dhe të të drejtave kombëtare. Strategjia nacionale e madhërimit të vlerave të socializmit si dhe të atyre që kontribuan për këto

vlera vërehet edhe në "PLANET I "Nantë maleve", Ali Jakupi, Mehmed TEMATIKE TË ORGANEVE E Shpendi, Hasan Muglica, Isa Boetini, SHTYPIT, RADIOTELEVISIONIT Bajram Curri, Jakup Ferri, Shaban DHE SHTËPIVE BOTUESE LIDHUR Binaku etj. ME PROPAGANDËN NË KOSOVË", Në këtë kontekst regjimi komunist në sidomos në propagandën e paparë në shtypin ushtarak! Në gazetën "Luftëtari", në revistën "Për mbrojtjen e Atdheut", në revistën "Në shërbim të popullit", si dhe në revistën "10 Korriku", janë paraparë qindra shkrime të publikuara dhe ato që do të shkruhen nga autorë konkret të cilët do të trajtojnë tema që kanë të bëjnë me angazhimin e "kosovarëve" në luftën nacionalçlirimtare (!). Gati në të gjitha temat e kësaj natyre lufta e shqiptarëve të Kosovës kundër fashizmit dhe ngelja e tyre pas Luftës së Dytë Botërore nën okupimin serbo-jugosllav trajtohet si "luftë nacionalçlirimtare e kosovarëve"! Për ironi janë të propozuar edhe tema të llojit "Lufta dhe përpjekja e popullit të Kosovës në shekuj për ruajtjen e bashkësisë shqiptare", ose "Qëndrimi i popullit të Kosovës në ditën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste"! Rrjedhimisht, lartësohen figurat partizane si Hajdar Dushi, Emin Duraku, Zenel Hajdini, Xhevdet Doda, Fejzi Rusta, Qerim Delia, Tahir Mala, Zeqir Hajdini, Ramë Vidrica, Ibrahim Ymeri, Gkelosh Rama. Teposhtë historisë, dalin te figurat kombëtare si Haxhi Zeka, Ymer Prizreni, Idriz Seferi, Isuf Murja

kërcënim për stabilitetin e brendshëm të shtetit komunist, duke u frikësuar se një përpjekje për të riaktivizuar ëndrrën e bashkimit të viseve mund të çonte në tensione dhe përplasje me Jugosllavinë dhe shtetet e tjera të ndryshme të bllokut lindor, që nuk e mbështetnin këtë ide.

#### Lidhshmëria e gjakut urë e ideologjisë marksiste-leniniste

Edhe në sferën e kulturës ndiqej po i njëjti qëndrim socialist! Në shtypin letrar nuk kishte vend as për ngjarjet por as për figurat krijuese që nuk ishin në paqe me sistemin dhe ideologjinë komuniste. Të gjithë ata krijues që kishin kaluar nëpër Goli Otok e nëpër burgje serbe, të gjithë ata krijues bohëmë e që shquheshin me një disidencë, apo edhe me forma dhe drejtime bashkëkohore letrare, të tillët kurrë nuk zunë vend në shtypin letrar e nëpër shtëpi botuese të Shqipërisë enverist.

Në periudhën komuniste, kultura dhe arti ishin ngushtësisht të lidhura me ideologjinë marksiste-leniniste. Regjimi enverist kërkonte që të gjitha shprehjet kulturore dhe artistike të ishin në harmoni me parimet e socializmit dhe të pasqyronin vlerat e Luftës Antifashiste, ndihmën që komunistët ofronin për popullin dhe, mbi të gjitha, të përkraheshin vetëm figurat dhe krijuesit që ishin të lidhur me pushtetin si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi. Në këtë kuadër, regjimi e konsideronte krijimin artistik jo vetëm si një mjet për edukimin dhe formimin e popullit, por edhe si një mjet të rëndësishëm për forcimin e kontrollit mbi shoqërinë.

Sipas "Planeve tematike" për propagandë në Kosovë dhe viset e tjera etnike parashihej që në Gazetën "Drita", në Revistën "Ylli", në Revistën "Nëntori", dhe në Revistën "Shqiptarja e Re", të botoheshin ngjarje kulturore, krijime të autorëve të përzgjedhur si dhe recensione e reportazhe letrare që përmbanin vetëm vlera ideologjike, që ishin në përputhje me normat shabllonike të soc-realizmit. Parashihej të botoheshin ekskluzivisht cikle poezish, tregime "të krijesve kosovar", të shqiptarëve nga Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët trajtojnë temën e patriotizmit shekullor kosovar, të dashurisë për truallin socialist dhe krenarinë kosovare, të virtyteve të burrërisë, të trimërisë e të besës tradicionale shqiptare, temën e plagëve të migracionit ekonomik (por jo edhe atë politik!!!), të luftës kundër zakoneve prapanike e paragjytimeve fetare, temën e dashurisë së pastër etj.

Një nga synimet e regjimit ishte të krijonte dhe forconte një identitet kombëtar të centralizuar dhe homogjen, ku virtytet tradicionale shqiptare, si burrëria, trimëria, besnikëria dhe dashuria për atdheun, ishin të paraqitura si vlera të përbashkëta që lidhin të gjithë shqiptarët. Trajtimi i temave të patriotizmit, burrërisë, besës dhe dashurisë për truallin socialist ishte një mënyrë për të forcuar ndjenjën e përkatësisë kombëtare, duke i bërë shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera të identifikohen më shumë me Shqipërinë dhe me regjimin enverist. Kjo ishte një përpjekje për të ndihmuar në krijimin e një kohezioni të brendshëm mes shqiptarëve, duke u përqendruar në elementët e përbashkët të traditës dhe kulturës që mund të lidhin bashkë popuj të shpërndarë, përfshirë ata që jetonin nën shtetet përreth Shqipërisë. Kjo

lidhshmëri e gjakut i duhej regjimit enverist, sepse, kësajsoj, ideologjia marksiste-leniniste do të shtrihej te të gjithë shqiptarët, pa përjashtim, sepse "kështu thotë Enver Hoxha"!

Nga ana tjetër, për regjimin enverist ishte e rëndësishme që çdo shprehje kulturore dhe letrare që mund të ndikonte tek shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera të ishte e lidhur me ideologjinë marksiste-leniniste, përkundër se ky sistem kishte të bëjë me krijimin e një shoqërie të re, pa përjashtuar mbështetje për vlerat tradicionale. Regjimi përpqej të krijonte një balancë mes ruajtjes së vlerave kombëtare dhe integritetit të këtyre vlerave në kuadër të një sistemi që duhej të ishte socialist. Për këtë arsye, vlerat e burrërisë, trimërisë dhe besës mund të shfaqeshin si aspekte të rëndësishme të natyrës kombëtare shqiptare, ndërsa ato mund të merren edhe si shprehje të përkrahjes për ideologjinë komuniste, që pretendonte se është pasqyra më e mirë e zhvillimit të popullit shqiptar në rrugën drejt "shpëtimit" dhe "çlirimit". Propozohet që mbi këto vlera të shqiptarëve të botohen kryesisht "Tekste popullore kosovare (pra, jo autoriale!) me tematikën e patriotizmit, të momenteve historike të rëndësishme, të përpjekjeve të luftëtarëve të shquar kosovar për çështjen e Kosovës dhe të Shqipërisë, të bukurisë së Kosovës, rituale dasmore, baritore etj". Në rrafshin e studimit dhe të krijimtarisë sugjerohet të botohen "studime për veprat letrare kosovare që paraqesin interes", "Recensione dhe shënime kritike për veprat poetike dhe për prozë të autorëve kosovarë që janë botuar" në Kosovë. Sugjeroheshin vepra e krijime të botuara për faktin se ato tashmë kanë kaluar nëpër filtrin e censurës dhe të redakturës sipas preferencave të soc-realizmit dhe ideologjisë komuniste.

Në këtë dokument nënvizohet se "Autorë më të preferuar ndo të jenë prozatorë të njohur për trajtimin e temave të tilla dhe të afirmuar për vlera artistike si R. Dedaj, E. Gjergjeku, A. Vinca, D. Mehmeti, E. Mekuli, A. Shkreli, M. Krasniqi, H. Vokshi, F. Ramadani, M. Kërveshi, M. Gjoshja, A. Podrimja, F. Gunga, H. Sulejmani, M. Isaku, N. Rrahmani, R. Kelmendi etj. Kurse, në asnjë faqe të këtij dokumenti nuk sugjerohet të publikohet ndonjë krijim i Adem Demaçit, i Teki Dëtvishit, i Sabri Hamitit, i Beqir Musliut, i Musa Ramadanit, i Ymer Shkreliut, i Mirko Gashit, i Mehmedali Hoxhës, i Rexhep Hoxhës, Jusuf Gërvallës, Qerim Arifi, Flora Brovina, Edi Shukriu, Fehime Selimi etj.

#### Vlerat kombëtare si "vlerë kundër" regjimit

Ata që kishin kaluar Goli Otokun apo edhe që kishin qenë të burgosur dhe që ishin pjesë e disidencës intelektuale dhe kulturore, pa dyshim që përbënin një kërcënim për regjimin. Këta krijues, që zakonisht ishin të lidhur me ideale kombëtare dhe humaniste, ishin të papranueshëm për një regjimi që synonte centralizimin dhe uniformitetin ideologjik. Në një shtet ku çdo devijim nga linja e partisë mund të shikohej si një kërcënim për stabilitetin e regjimit, margjinalizimi i disidentëve, "bohëmëve", "hermetikëve" ishte një mjet për të mbrojtur dhe forcuar status quo-në. Ata që e kundërshtonin pushtetin, duke përfshirë edhe artistët dhe krijuesit që ishin më të lidhur me një kulturë të lirë dhe

të pasur, përjashtoheshin nga çdo mundësi shfaqjeje publike, që të mos krijonin një "vlerë të kundërt" ndaj propagandës të cilën regjimi dëshironte të impononte.

Për regjimin komunist, kultura duhej të ishte një instrument për të promovuar ideologjinë dhe qëndrimet e tij, dhe krijuesit që nuk e pasqyronin këtë synim ishin të margjinalizuar. Në një sistem ku censura ishte e fortë dhe çdo lloj shprehje që mund të reflektonte kritika ndaj regjimit ishte i papranueshëm, kishte një tension të vazhdueshëm midis krijimit të një arti të vërtetë dhe atij që përputhej me nevojat ideologjike të shtetit. Krijuesit që ishin në paqe me sistemin, pra ata që nuk ishin disidentë, ose që ishin të gatshëm të mbështesnin idetë e regjimit dhe t'i përqafojnë ato pa shumë kundërshtime, përfituan mundësitë për të shfaqur dhe zhvilluar krijimtarinë e tyre. Ky ishte një mjet për të ruajtur një kontroll të vazhdueshëm mbi artin dhe kulturën, duke krijuar një rrjet mbështetës të artistëve që ishin të integruar plotësisht në sistem.

Bazuar në temat që përfshihen në këtë "Plan tematik" për propagandën shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera etnike, vijmë te një tjetër aspekt që flet se regjimi enverist ka pasur një qëllim të caktuar për të kanalizuar dhe kontrolluar patriotizmin shqiptar në një drejtim të përshtatshëm. Regjimi i përdorte shkrimet letrare dhe artin për të ushqyer ndjenjat e kontrolluara nacionaliste të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera, duke synuar eliminimin, gjithashtu, të çdo formë të lëvizjes që mund të ishte radikale apo që mund të shkonte përtej kufijve dhe për ta rrezikuar sistemin socialist të Shqipërisë. Pra, ndonëse ai promovoi patriotizmin dhe dashurinë për komb, regjimi gjithashtu e kontrollonte këtë lëvizje, duke e mbajtur nën një dorë të fortë dhe duke orientuar atë drejt një versioni të "nacionalizmit socialist", që ishte në harmoni me doktrinën marksiste-leniniste të shtetit.

Ky është qëllimi edhe kur vendoset që mos të publikohet e të flitet fare për migrimin politik të shqiptarëve që kishte marrë hov pas vitit 1968! Regjimi i Enver Hoxhës kishte një qëndrim të ashpër ndaj çdo forme të disidencës dhe të opozitës politike, dhe ai mund të kishte frikë se çdo referencë ndaj emigracionit politik mund të përforconte perceptimin se regjimi ishte represiv dhe i padrejtë, veçanërisht në lidhje me shqiptarët që kishin ikur nga Shqipëria dhe që kryesisht ishin të lidhur me ide të ndryshme politike.

#### Imazhi i unitetit kombëtar me profil të regjimit socialist

Natyrisht, regjimi enverist ishte angazhuar fuqishëm për një propagandë konkrete dhe të papengueshme! Nëse propaganda përmes botimeve dhe shtypit kishte vështirësi për të arritur deri te "konsumatori kosovar", propaganda përmes radios dhe televizionit do të ishte më efikas. Ndonëse programet ishin shumë të kufizuara Shteti Shqiptar do të përkujdeset që përreth kufijve të vë sa më shumë antena dhe përsëritës, për t'i përforcuar valët si brenda shtetit ashtu edhe jashtë! Deri në vitet '80, më se dyzet e pesë për qind e vendit nuk kishte mundësinë të përcjell asgjë në televizion. Kësisoj, në strategjinë kombëtare të përfshirë në këtë dokument "Mbi masat e marra për zgjerimin e rrezes së shikimit të televizionit dhe dëgjimit të radios",

thuhej se, pas ndërtimit të stacionit TV të Dajtit, i cili mbulonte rreth 45 për qind të popullsisë, janë ngritur 67 qendra përsëritëse TV të përkohshme të pajisura me 71 përsëritës aktiv dhe shtatë rezervë të prodhimeve vendore. Këta përsëritës mbulonin 25 për qind të popullsisë. Në vendosjen e qendrave përsëritëse prioritet u ishte dhënë zonave kufitare. Me anë të qendrave përsëritëse të Hasit, Pashtrikut, Soferçanit dhe Tushemishtit mbulohej Gjakova, Prizreni, Dibra, Struga-Ohri dhe tridhjetë fshatra rreth këtyre qyteteve, kurse qendra përsëritëse e Klishtarit, Dropullit të Epërm dhe e Milesë mbulonte rreth dhjetë fshatra përtej kufirit. Ulqini, Tivari dhe disa zona rreth Podgoricës mbulohehin direkt nga Dajti dhe një pjesë e fshatrave të brigjeve të Prespës mbulohehin nga qendra përsëritëse e ngritur në malin Ivan të Korçës. Parashihej që më vitin 1980 të ngritet një qendër përsëritëse edhe në Qafë Prush dhe të mbulohet Peja dhe zona e gërë rreth saj.

Përkujdes i veçantë i kushtohej edhe radio valëve. Strategjia nacionale e "Planeve tematike" për propagandë në Kosovë e në viset e tjera etnike duhej të realizohej e tëra dhe pa pengesa. Ndaj dhe, në gjysmë e parë të vitit 1979 ishin ndërmarrë sërë aktivitetesh për ta përmirësuar dëgjimin e Radio-Tiranës në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në Greqinë Veriore. Për këtë qëllim kishin fillar ndërtimet e pesë stavioneve me valë të mesme me fui 20-50 KW që do të vendosen në Shkodër, Kukës, Korçë, Gjirokastër e Sarandë.

Angazhimi i regjimit të Enver Hoxhës për propagandën ideologjike në Kosovë dhe në viset e tjera etnike shqiptare ka qenë një pjesë e strategjisë së gjerë të regjimit për të forcuar dhe mbajtur ndikimin e Shqipërisë mbi shqiptarët jashtë kufijve të saj dhe për të avancuar interesat e tij kombëtare dhe politike.

Një nga strategjitë kyçe të regjimit ka qenë ndërtimi i një identiteti kombëtar të centralizuar, ku kombi shqiptar ishte i njëjtë kudo që jetonin shqiptarët, dhe ku çdo individ, pavarësisht se ku jetonte, do të ndihej i lidhur me njëri-tjetrin dhe me Shqipërinë socialiste. Kjo propagandë përpqej të forconte ndjenjat e përkatësisë dhe besnikërisë ndaj regjimit enverist, duke përdorur virtytet tradicionale shqiptare (patriotizmi, burrëria, trimëria, besnikëria) si mjet për të krijuar një ndjenjë solidariteti dhe të përbashkët. Kështu, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera duhej me patjetër ta shihnin regjimin si një mbrojtës të interesave të tyre kombëtare.

Për regjimin e Enver Hoxhës, një pjesë e rëndësishme e propagandës ishte të lidhte idealet e kombëtarizmit shqiptar me ideologjinë marksiste-leniniste. Nga ana tjetër, qëllimi i propagandës së regjimit enverist në sferën kulturore, ishte të forcente identitetin kombëtar shqiptar dhe të lidhte shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera me Shqipërinë, duke promovuar një imazh të unitetit kombëtar nën udhëheqjen e regjimit socialist. Kjo propagandë synonte të përforconte besnikërinë ndaj ideologjisë komuniste, të ruante kontrollin mbi mendimin dhe kulturën, dhe të krijonte një mbështetje për ambiciet politike të regjimit. Përmes artit dhe letërsisë, regjimi promovonte virtytet tradicionale shqiptare, ndërsa mbante një kontroll të rreptë mbi çdo formë disidencë.

(fund)

Qasje

# ARSHI PIPA DHE HISTORIA E LETËRSISË SHQIPE PËRBALL NJËRI-TJETRIT


**Historia e Letërsisë Shqipe duhet të rishkruhet, duke u rikuptimësuar dhe rikonceptuar mbi bazat e një metodologjie shkencore që i shkon përshtat zhvillimit të brendshëm procesual të letërsisë shqiptare**

Agron TUFA

Dëshira dhe nevoja imediate për të pasur një Histori të Letërsisë Shqipe, të mbështetur në kriteret shkencore, larg përjashtimit, larg frymës sektante të përfaqësimit, larg mllëfit ideologjik dhe deklasimit të disa prej shkrimtarëve, periudhave dhe qarqeve letrare, pra, dëshira për një Histori të këtillë të Letërsisë Shqipe – është ndjerë gjatë si nevojë dhe si garanci në njohjen e vërtetë të vlerave kombëtare, si për qëllime njohjeje e studimi, ashtu dhe për aspektet didaktike të mësimdhënies. Mungesa e një tekste garantues e të ç'ideologjizuar ka prodhuar përgjatë këtyre 20 vjetëve pas rënies së komunizmit diskurse të pashmangshme në lidhje me të, kryesisht, të karakterit formal, parimor. Në momente nervozizmi janë shfaqur edhe kundërshtarët e hartimit të një tekste të ri të. Të shqetësuarit nga hartimi i një Historie të rishikuar të Letërsisë Shqipe e përmbledhin kundërshtimin e tyre në tezën: "Historia e Letërsisë Shqipe nuk ka pse të shkruhet; ajo është shkruar njëherë. E shumta, Historia e Letërsisë mund të plotësohet me disa shtesa, pa i ndryshuar asgjë" (Dritëro Agolli, Panorama, 18 shtator 2008). Ky shqetësim arsyetohet me mosbesimin, që një ndërmarrje e tillë të jetë e ndershme, duke bërë alibi për, gjoja, prapavijë politike. Jashtë diskutit koniuktural mediatik, unë i përmbahem domosdoshmërisë që Historia e Letërsisë Shqipe duhet të rishkruhet, duke u rikuptimësuar dhe rikonceptuar mbi bazat e një metodologjie shkencore që i shkon përshtat zhvillimit të brendshëm procesual të letërsisë shqiptare.

Megjithatë, studiuesit dhe shkencëtarët e letërsisë sonë, para se të kalojnë në diskutimin teorik të çështjes dhe prekja konkrete e realiteteve letrare, duhet të qartësojnë kaosin dhe konfuzionin që paraqet peisazhi i letërsisë shqipe, në kushtet e fragmentarizmit dhe komunikimit brendaletar. Dy janë momentet më të rëndësishme të "sqarimit" të këtij peisazhi: 1. Të shpërfillen demarshet agresive të produktit letrar masiv/masovik, - të asaj literature të lehtë, triviale, eskapite, pa u turbulluar nga suksesi i tregut, duke ia nënshtuar bujën e stërfryrë të kësaj letërsie – diferencimit të qartë të zhanrit, psi shpesh, librat e këtillë i imponohen publikut të gjerë me karizmën publike që kanë autorët e tyre, si personazhe qendrore të politikës apo shout televiziv. 2. Para se të përcaktohen kriteret dhe strategji të qasjeve për hartimin e Historisë së Letërsisë, duhet mundësuar, me sinqeritet e ndershmëri profesionale, botimi integral i veprës së autorëve të mohuar, të përjashtuar, të ndaluar, të njohur pjesërisht, pak ose aspak për lexuesin.

Precedentët e mosnjohjes së autorëve të rëndësishëm janë të shumtë. Në shumicën e rasteve ata njihen si emra, pa ua lexuar veprat. Këta autorë kanë qenë, që në krye të herës dhe vazhdojnë



të qëndrojnë jashtë komunikimit dhe në jo pak raste atyre u është instaluar imazhi i keq i "ngatërrestarëve", "mizantropëve", "rebelëve" dhe plot imazhe të tjera negative, të cilat nuk kanë aspak lidhje me veprën e tyre dhe domethënien letrare që përfaqësojnë.

## Përjashtimi jo i ndërsjellët i Pipës

Rasti më ilustrues i këtij përjashtimi është vepra dhe emri i shkrimtarit Arshi Pipa. Poet, studiues, kritik letrar dhe filozof, përkthyes dhe kulturolog me erudicion sintetik. Përballë Historisë së Letërsisë shqipe (përballë Historive ekzistuese të deritashme të Letërsisë shqipe) dhe historianëve të saj, Arshi Pipa gjendet dyfish i përjashtuar, me dy statuse: njëherë si studiues dhe kontribuues në formësimin e një mendimi dhe premise për shkencën e Historisë së Letërsisë, dhe njëherë tjetër - i përjashtuar si autor i kësaj letërsie. Si kontribuues i shkencës së Historisë së Letërsisë shqipe, Pipa ndjehet edhe tash që po flasim i përjashtuar, për shkakun e njohur, se kjo shkencë ende nuk e ka përfillur të kontributin më serioz e shkencor që paraqesin veprat e tij, si ato të natyrës së kritikës së tekstit me autorë e vepra të veçanta që nga fundi i viteve '30, ashtu dhe me trilogjinë e tij të famshme "Albanica": "Letërsia

shqiptare: perspektivat e saj sociale". Asnjë nga veprat shkencore të Pipës nuk u përfill si dje, për shkaqe të njohura të shkencës zyrtare komuniste, si sot, për shkaqe të panjohura, ose të mefshtësisë intelektuale e institucionale në botën tonë shkencore-filologjike. Ndërkaq, duhet thënë se ky përjashtim nuk ka qenë i ndërsjellët. Pipa nuk ka qenë asnjëherë indiferent për zhvillimet procesuale të letërsisë shqiptare dhe shkencave letrare, veçanërisht ndaj Historisë së Letërsisë. Përndryshe interesimi dhe, më së mbrami, punimet e tij konkrete në këtë lëmë, tregojnë për një vëmendje dhe pritje të përhershme, me të cilën i ndiqte ai zhvillimet letrare-filologjike. Arshi Pipa nuk e pa të arsyeshme të shkruante një Histori të Letërsisë, megjithëse aftësitë nuk i mungonin. Contemporary Albanian Literature (1991) nuk është mirëfilli një Histori Letërsie. Nuk mund të mendohet se nuk qe i vetëdijshëm për mungesën dhe mangësitë. Në parathënien e Albanian Literature: Social Perspectives, ai shprehet: "Asnjë nuk është e kënaqshme. Më e mira prej tyre, Historia e Letërsisë Shqipe (1959-1960) botim dyvëllimësh me autorë kolektivë, është informative, por e njëanshme dhe me boshllëqe". Prezantimi i Letërsisë Shqipe në botimet akademike dhe enciklopeditë dëshmojnë për një konfigurim të qartë të

vështrimit të Letërsisë Shqipe në thellësi dhe gjerësi. Ndërsa vepra Trilogjia Albanica dëshmon për metodikën bazë të këtij studimi. E botuar më 1978 ajo na vjen vonë në lexuesve shqiptarë, aq më tepër që ajo është ende e papërkthyer.

## Trilogjia "Albanica" e Pipës si premisë e një Historie të Letërsisë

Duke studiuar me hollësi dhe duke u ndalur tek vargu folklorik shqiptar, bazë për njohjen e një sistemi prozodik shqiptar, Arshi Pipa, në pjesën e parë të trilogjisë, nuk kalon në sipërfaqe dallimet fonologjike, si edhe përcakton përparësitë e secilit dialekt në lidhje me sistemin shkrimor poetik shqiptar. Autori e cilëson poezinë shqiptare si një "trupëzim i papajtuësëm poetikash që zhvillohen të ndaras sipas krahinave",... të cilat, "për shkak të dallimeve thelbësore fonologjike midis dy dialekteve" nuk mund t'i rrafshojë në gjuhë standarde. Në këtë vështrim punimi nuk paraqitet si studim i vargut folklorik shqiptar në lidhje me strukturën dhe gjininë, por një studim bazë nga e cila fillon vetëdija mbi shkrimin poetik shqiptar, sidomos i vënë ballë për ballë traditave shkrimore të tilla simotra me të cilat çdo shkruar duhet të përballet. Libri tjetër tashmë në formë monografie Hieronimus De Rada, na jep këtë shkruar me vetëdijen shkrimore shqiptare, i cila, siç shprehet Pipa, zë fill, ashtu si edhe kultura e lashte greke, jo në truallin kontinental bazë, por në kolonitë greke të Azisë së Vogël, pikërisht në ngulmimet shqiptare në jug të Italisë. Libri, i organizuar sipas një strukture të tillë, ku përfshihet Origjina e poezisë, Gjuha dhe prozodia, Ideologjia dhe stili, të tërheq vëmendjen për të njëjtën kërkesë studimore mbi shkrimin dhe strukturat mendimit, sidomos në kapitujt e dytë dhe të tretë. Për Arshi Pipën, dhe kjo është një nga pikat në të cilën duhet ndalur, gjuha është në radhë të parë shprehëse e strukturave bazë të mendimit, psikologjisë së shprehjes së tij etnike, ajo ka temperamentin e folësve, folësit dhe më vonë shkruarit (artist) i cili duhet të jetë i vetëdijshëm në radhë të parë për këtë bashkëlidhje të pashqitshme. Prej këndeje edhe mënyra e vështrimit poetik të veprës së De Radës kurorëzohet me strukturat poetike të shprehjes së këtij mendimi. Ky libër është një pjesë e eseve mbi Letërsinë dhe folklorin shqiptar, disa prej tyre të botuara krejtësisht ose pjesërisht. Ndërkohë kur ekzistojnë disa vepra mbi Historinë e Letërsisë Shqipe, një vepër mbi faktorët e saj sociologjikë ende mungon. Një vepër e tillë është më e nevojshme pasi Letërsia Shqiptare është gjerësisht rrjedhojë e folklorit, një shkencë shoqërore. Por, nëse duke analizuar natyrën e shkrimit të kultivuar shqiptar, ai ndalet mes të tjerash në etosin dhe etnosin në traditën letrare arbëreshe të cilën bashkë me De Radën që shënon lindjen e letërsisë artistike shqiptare; Bariu dhe fshatari në letërsinë shqipe, për të vazhduar me Fshatari në

letërsinë bashkëkohore. Veç të tjerash, në fund, ai vëren jo vetëm lidhjen e Letërsisë Shqiptare me ideologjinë dhe ideologjitë, lidhjen organike të saj me folklorin arsye mbijetese dhe qëndrese, pastaj trashëgimisë të kësaj mendësie të krijuar në shekuj, por edhe natyrën naive të kësaj letërsie, e cila nuk i përgjigjet natyrës së shkrimit që sipas Kantit synon kënaqësinë e pa interes, por është primitive, jo reflektive, dhe e menjëhershme, në krahasim me një letërsi ku mbizotëron introspeksioni dhe ndërlikimi. Fakti se pjesa më e madhe e shkrimtarëve shqiptarë e shkruajnë veprën e tyre më të mirë në rini, De Rada, Fishta, Santori, Koliqi, Poradeci, Camaj, Kadare, e dëshmon këtë fakt. Letërsia shqipe, shkarkohet, pas një periudhe të shkurtër dinamike dhe pothuajse shpërthyes, e paaftë me mbërritë ekuilibrit e pjekurisë, bie pre ose e vetëkënaqësisë autoriale, ideologjisë ose letërsive të tjera simotra të cilat e shtypin vetëdijen me sistemin e tyre të mirë-organizuar. Në fund themi se Trilogjia Albanica është shkruar jo vetëm si vëmendje kritike ndaj Letërsisë Shqipe, por si ndjekje serioze dhe e përkushtuar ndaj zhvillimeve në këtë drejtim të studimit në truallin mëmë, hedh një bazë metodike të studimit dhe hartimit të një Historie të Letërsisë Shqiptare duke nënvizuar se Letërsia si një profesion që karakterizon një tip të veçantë, të shkolluarin, nuk ka ekzistuar kurrë në Shqipëri dhe etnocentrizmi nënvizon edhe ato shkrime që duket se janë larg së qeni politike. Konkluzionet e fundit të Pipës mbi Letërsinë Shqipe ngjajnë me pohimet kritike ndaj letërsisë angleze të Eliotit në fillim të shekullit të kaluar, në Tradita dhe talenti individual, ku ky i fundit, kritikon shpirtin anglez i cili është larg introspeksionit dhe aftësisë a vetëdijes kritike për çdo gjë që kalon në trurin e anglezit, ndryshe nga shpirti krijues francez që dëshmon një

metodikë të një mendësie të tillë. Elioti jo vetëm me kritikën solli një revolucion në shkrimin anglez; ngjashëm me të dhe me të njëjtën ambicie A. Pipa synon një gjë të tillë në studimet shqiptare. To my native country, ky është kushtimi që ndodhet në faqen e parë të librit të parë të Trilogjisë Albanica, kushtim i cili mund të përkthehet: Vendit tem, dhe në dashuninë së botës së sanë të Buzukut, duke dëshmuar fillesat e një kritike sistematike moderne bashkëkohore.

#### Përrjashtimi i Pipës si poet nga Letërsia Shqipe

Por, Arshi Pipa, i cili, përveç modeleve origjinale që ka lënë në kritikën dhe shkencat letrare-filologjike, në përkthimin artistik, në politologji dhe mendimin filozofik, mbetet, megjithatë, një poet shumë i rëndësishëm shqiptar i shekullit XX. Kam përshtypjen se ato pak shënime për poezinë e Pipës, janë shkruar thjesht për nevojë ekzotike dhe se askush nuk ka lexuar një varg. R. Elsie e ka karakterizuar poezinë e Pipës (nëse e ka lexuar vërtet) si një "përmbledhje në frymën romantike dhe nostalgjike të Xhakomo Leopardit". Duke iu kundërvënë me gjasë gjykimeve të Elsie-së dhe Namik Resulit, Rexhep Ismajli bëhet akoma më konfuz, mandej përfundon ta paraqesë poezinë e Pipës sipas vetë shënimeve të Pipës. Mandej, studiuesi i nderuar Ismajli del në një përfundim të çuditshëm kur thotë: "Tani që vepra e Pipës u mbyll, mbase ka qenë e mundshme të shqiptohen dhe vlerësime më përgjithësuese, të gjendet vendi i tij i veçantë në poezinë shqipe të kohës, të shqiptohet gjykimi për dijen që vërtet e shquan në fusha të tjera, ashtu dhe në gjuhën e poezisë, në mjeshhtërinë e vargut, në ide, por edhe për talentin e tij mesatar poetik". Tingëllon i padrejtë ky vlerësim kur jepet në parathënie e përmbledhjes së poezive, aq më tepër

kur këto poezi janë prezantimi i parë i poetit me lexuesin, që i ka munguar prej një gjysmë shekulli. Ky përcaktim do t'i largonte lexuesit, të cilët i besojnë studiuesit të njohur, duke menduar se, meqë paskemi të bëjmë me një talent mesatar, më mirë të mos e humbim kohën kot me të tillë! Prej se është botuar në Romë me 1959 "Libri i Burgut", kritika letrare shqiptare e vjetër dhe e re, si brenda Shqipërisë, ashtu dhe në diasporë, ka qenë krejtësisht e lirë të procedojë me veprën e poetit, duke e lënë menjandë barrën e "gjetjes së vendit të tij në poezinë shqipe të kohës. Pyetja e natyrshe duhej të formulohej kështu: "Pse nuk e bëri kritika jonë këtë? Kush e pengoi, fjala vjen, dje, në Kosovë dhe kush e pengon, fjala vjen sot, në Shqipëri e botën letrare shqiptare?" Unë mendoj, se domethënëse në këto kushte do të kishte qenë publikimi i veprës së Pipës, veçmas korpusi i tij poetik, përfshirja e tij në programet e detyrueshme shkollore, universitare, hapja e krijimtarisë së tij në auditore që do të lejonte mundësinë e dialogimit me të e, mandej, reflektimi. Për fat të keq kjo nuk u bë dhe ende botimet e A. Pipës, poezitë, kanë mbetur dy episode të vetmuara e të harruara bibliografike "Feniks" 2004 dhe "Dukagjini" 1998. Mund të gjeshe në libraritë tonë sa të duash skorje socrealiste, por jo veprat e Pipës. Prandaj, në kushtet e mosnjohjes dhe mosdashjes për ta njohur, do të kishte qenë më logjike dhe më pranueshme të shpreheshim: pra se të guxohet t'i gjendet Arshi Pipës një vend në poezinë shqipe, ne, ose akoma më mirë - kritika shqiptare të përmendje njëherë nga kllapia dhe koma dhe, pasi të vijë në vete, të verifikojë njëherë nëse ka vend ajo vetë. Dikur Martin Camaj shkruante se "Shqipëria do të jetë vërtet e lirë, vetëm atëherë kur shqiptarët do të kenë mundësi të lexojnë, të studiojnë dhe të lexojnë veprat e shkrimtarëve

të tillë të mëdhenj si Arshi Pipa". Gjithkushi mund ta receptojë dhe të ndërtojë meditim e vet si të dojë mbi këtë test të Camajt për një shkrimtar shqiptar. Por për mua fjalët e Camajt janë një kut matës i perceptimeve që ndërton shoqëria ndaj shkrimtarit të vet dhe, së këndejmi, vihet në provë një e vërtetë më e madhe: a i duhen shoqërisë shkrimtarët dhe çfarë roli luan shkrimtari në psiken dhe konstruktin moral e shpirtëror të shoqërisë, së cilës i drejtohet.

Natyrisht alternativa e Camajt nuk provua pozitivisht. Të paktën në lidhje me Arshi Pipën shoqëria shqiptare dështoi brenda përcaktimit të Camajt, ngase shqiptarët nuk dëshmuuan se janë të lirë, sepse as nuk e lexuan, as nuk e studiuuan dhe as nuk e vlerësuan veprën e shkrimtarit të tyre. Meditimi, tash për tash, nuk ka të bëjë aq shumë me Pipën, se sa me anën teorike të çështjes. Çfarë ndodh me shoqërinë dhe shkrimtarin dhe a ka një marrëdhënie apo indiferencë të ndërsjellët mes tyre? Dhe nëse po, cilat janë të mirat dhe cilat janë të këqijat e këtyre raporteve? Nëse poeti ka ndonjë detyrim para shoqërisë, atëherë detyrimi i vetëm është: të shkruajë mirë! Duke qenë se ai i përket pakicës përballë shoqërisë, ai nuk ka alternativë tjetër. Por nëse nuk e shlyen këtë borxh, poeti kridhet në harrim. Shumica pra, shoqëria, përveç leximit të poezive, mund të ketë dhe punë të tjera, sado mirë qofshin shkruar ato. Por duke mos i lexuar poezitë, krijimtarinë e shkrimtarit të saj të mirë, shoqëria katandiset deri në nivele të mjeria ligjërimi, sa të bjerë lehtë pre e demagogëve dhe tiranëve. Dhe pikërisht një shoqëri e tillë është ekuivalente me harrimin, prej të cilit, sigurisht, përfiton tirani. Mos ndodhi ndryshe me përvojën tonë të pasluftës së Dytë?


## Në shiritin e kohës

# FQINJI YNË PETRO MARKO

**Jeta fluturon shpejt, kujtimet zbehen, por Petro Marko ka për të mbetur i pavdekshëm për lexuesin për veprën që la dhe i paharruar për të gjithë ata që e kanë njohur personalisht, për portretin njerëzor, qoftë edhe për portretin e tij në atë skicën e thjeshtë bardhë e zi, profilin me një kaçurrel në ballë e një cigare në gojë e tymin e saj që dridhet në ajër.**

#### Albana LIFSCHIN

Banonim në pallatin 64, një pallat i verdhë në formë L-je, pranë maternitetit të vjetër të Tiranës, në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" atëherë, sot "Zogu i Parë". Nuk di si ia kanë ndryshuar ngjyrat tani, por atë kohë mbahet si nga pallatet më të mirë. Familja e Petro Markos banonte në shkallën e dytë, kati i dytë djathtas, pikërisht mbi hyrjen e pallatit dhe përballë kishte familjen Fishta, familje dëshmori. I biri, Jamarbri ishte djalë me një fantazi të zhvilluar, dhe pak më i madh se ne në moshë. Arianitës, apo Tekës, siç e thërriste Safua, i pëlqente piktura dhe çokolatat. Më vonë kur familja u bë me halle shumë, ajo mbajti mbi supë gjithë barrën e saj. Ai pallat kishte 5 hyrje dhe mjaft fëmijë që ta mbanin zgjuar pallatin gjithë ditën, me përjashtim të orës 3-5 pasdite, gjatë verës, ku nuk duhej të pipëtinte asgjë. Në atdhe akoma mbahet ky orar pushimi, ne këndej e kemi harruar fare. Petro Marko, ai burrë i pashëm -si portret i përjetësuar në skicën e famshme të së shoqes, Safos, në profil, me kaçurrelin në ballë e cigaren në buzë, për ne fëmijët ishte autori i "Shpellës së piratëve". Tek ai shikonim Rusman El Namsurin dhe Mejremë El Mejrem al Katar...E ftuan në shkollë, kur doli novela, të na fliste për ta. Shkolla jonë fillore "Lidhja e Prizrenit" qe vetëm një rrugë më tutje, fill pas murit të Dervish Hatixhesë...Eh,



këtu më zgjohen kujtime të tjera, por nuk do të ndalem tek ato, për të mos u larguar nga tema. E vërteta është që në atë moshë që ishim ne, shkrimtari nuk na dukej i MADH. Petro Marko ishte si të gjithë prindërit tanë, bënte edhe ai pazar me ato rrjetat plastike, nëse u kujtohen, që nuk di pse u këputeshin fi jet e të binin domatet rrugës. Dyqanet ishin aty rrotull. Kur nuk kishte rrjeta në dorë, mbante duart prapa, e cigaren në buzë. Shëtiste. Njëherë mbajti këmbët e ktheu kokën pas. Sapo kishte kaluar një grua e bukur. Ne gocat e klasës së katërt fillore, vumë dorën tek buzët e kukurisëm pak dhe pastaj vazhduam lojën. Luanim sa shqepeshin, tërë ditën e ditës. Për ne fëmijët shejtanë të pallatit 64, oborri qe dhurata më e madhe që mund të na bëhej. Mënyra se

si qe ndërtuar ai, si bërryl që bashkonte rrugën e Fortuzit me bulevardin, kishte krijuar nga brenda një oborr të madh trekëndësh që na mbante tërë ditën aty. Madje, ftonte edhe fëmijë të tjerë nga pallatet përreth. Aty luanim me top, luftash, shtetesh, pincash dhe kumance. Kjo e fundit ishte lojë e preferuar për ne, por jo për banorët që ankoheshin, sepse ne përdornim hyrjet e shkallëve të pallatit si "pozicione" e bënim zhurmë. Zakonisht shkalla e parë dhe e dyta ishin më të mirat se aty fqinjët ishin "më të urtë". Shkalla e dytë, me xhamet e thyera, ku banonte familja Marko, na jepte dorë me shumë. As shkrimtari as e shoqja, nuk u ankuan asnjëherë nga ne, ndërkohë që nga shkallet e tjera na përzinin. Një pasdite shiu, tek ishim mbledhur aty duke treguar barcale-

ta, shkrimtari mbajti këmbët e më zuri bishtalecin. Bashkë me të qe edhe e shoqja, Safoja.

-Ja për këtë vajzë të kam thënë t'i bësh një portret...

-Ah, mbesën e nënë Davës!, tha ajo duke vënë buzën në gaz.

Me gjyshen time ata kishin muhabet. Petro vinte për vizitë dhe i dëgjoja që flisnin për tema interesante, për zakone të krahinave e tradita historike. Madje, aty më zuri veshi për herë të parë që thuhej se "himariotët mendohej të jenë nipër të mirditoreve". Flisnin për origjinën e emrave katolikë të bregdetit. Tregonin edhe një gojëdhënë të cilën nuk e harrova tërë jetën. Qe për Kurveleshin. Unë kisha parë në shtëpinë e gjyshes librat e Petros Markos "Hasta la vista" dhe "Qyteti i fundit". Nga nëna kisha dëgjuar që Petro kishte qenë luftëtar në Spanjë. Një djalë i ri nga bregdeti shqiptar kishte shkuar të luftonte për Spanjën!

Tek ne vinte shpesh për vizitë edhe Dr. Konçita, mjekja e talentuar spanjolle, mikeshë e mamasë, e ndonjëherë vetiu lidhej biseda për Petro Markon, që kishte luftuar në Spanjë. Atje kishte qenë edhe Heminguej, por luftëtari shqiptar i Spanjës pat rënë në burg. (Thonë që e lironi romani i tij "Hasta la Vista", meqë edhe kryeministri i vendit kishte luftuar në Spanjë).

## Botime

# POEZIA SI NGUSHËLLIM SHPIRTËROR, MJET KOMUNIKIMI DHE KUNDËRVËNIE E REALITETIT

(Parathënie e vëllimit poetik "Dielli udhëton nëpër re shiu" të Xhevdet Bajrajt, botoi Shtëpia botuese DRINI, Ferizaj, 2024)

**Anton Nikë BERISHA**

**Poezia si mënyrë komunikimi dhe mbijetimi shpirtëror**

Gjithë poezia e Xhevdet Bajrajt, duke filluar nga libri i parë ("Nënë prej guri" 1988) deri tek ai i lënë në dorëshkrim dhe botuar pas vdekjes ("Angelus novus" 2023), si dhe poezitë e zgjedhura nga 13 libra që i kam përfshirë në këtë vëllim – "Dielli udhëton nëpër re shiu", përligjin dukurinë e rëndësishme: për autorin poezia ishte një mjet – mënyrë e ngushëllimit shpirtëror e mendtor, e komunikimit dhe e mbijetimit. Bajraj ka qenë i lidhur ngushtë me poezinë edhe atëherë kur s'ka hedhur në letër vargje e s'ka hartuar ndonjë poezi të plotë. Në një mënyrë ose në një tjetër, poezia për të ishte frymëmarrje, po dhe dëshmi e pasurisë shpirtërore, e një bote sa të ndieshme, po aq dhe tunduese. Pra, poezia si krijimtari shpirtërore, si komunikim, po dhe mënyrë e shqiptimit të dukurive ishte ngushtë e lidhur me jetën që e bëri dhe e përjetoi në Kosovë, po dhe në Meksiko, ku e kaloi pjesën e fundit të jetës: *Duke prerë nyjën e Gordit me tehun e një vargu / Para se të më mbesë në fyt e të më mbyl / Poezia që ma dikton jeta* (Blues i harruar). Megjithatë, duhet theksuar se përkundër të dhënës që poezia e tij frymëzohet dhe shpreh rrjedhën konkrete të jetës, prapë se prapë, ajo gërshetohet me përfytyrimin dhe ëndrrën. Ndodh kështu nga se poeti përmes poezisë jo vetëm shpreh pakënaqësinë dhe shqetësimet, mospajtimin dhe kundërvënien ndaj asaj që ndodh në vendin e tij dhe me njerëzit e gjakut e të gjuhës, po realitetin e përfutur përmes tekstit poetik ia kundërvë realitetit të përditshëm, konkret, që është tundues dhe tragjik, qoftë kur e shqipton jetën në kohën e luftës (shih poezinë "Pranvera 1999" e të ngjashme) dhe pas mbarimit të saj, ku liria është e "[...] rrethuar me tela gjemborë", shenjzëzim i vijimësisë së mugëtirës, i vetëdijes së fjetur të njerëzve që morën në dorë drejtimin e fatit të gjallimit në Kosovë.

Realitetit të rëndë në Kosovë (*kur Kishte koha ethe, kishte koka frymë* (Azem Shkrel) poeti Bajraj i kundërvihet edhe përmes shpirtëzimit të gjërave, të pamjeve, të pikturave (të natyrës së vdekur), të cilat bëhen pjesë e frymëmarrjes; ndërliken me shqetësimet dhe pësimet e njerëzve dhe bëjnë realitetin e tekstit poetik të përfutur përmes gjuhës.

**Dy mënyrat e përfutimit të tekstit poetik**

Vetë tekstet e poezive të Xhevdet Bajrajt e përligjin në mënyrë të pamëdyshtë parimin krijues poetik të tij. Mirëpo, janë disa vargje – pjesë të poezive që e qartësojnë mirëfilli këtë koncept, që degëzohet në dy rrafsh kryesore: në qasjen dhe shqiptimin shumëor të njëmendësisë (realitetit) dhe të kërkimit të së bukurës, pa të cilën poezia nuk do të ishte ajo që është. Për autorin tonë poezia është, para së gjithash, ngushëllim i shpirtit, po dhe mjet komunikimi, mospajtimi dhe kundërvënien e realitetit konkret, përkatësisht e shqiptimit të tij përmes gjuhës. Pra, në disa poezi



del qëllimi përkatës i tekstit të hartuar nga ai: Poezisë sime / i dashur lexues / përpiqem t'i jap vlerë njerëzore (Lexues i dashur) dhe se ishte besnik / ndaj kërkimit të tmerrshëm të realitetit (Në bregun e oqeanit). Bajraj e zbulon poezinë brenda vetvetes dhe ajo bëhet shoqërujesja e rëndësishme jetësore e tij, në hare dhe në vuajtje, prandaj poeti thotë që "kutinë e zezë" ta kërkojnë te vargjet e tij, *kutinë e zezë të jetës sime / midis vargjeve të mia* (Arktivoli).

Pra, poezia ishte njëjtësuar me poetin. Këtë na e thotë ai vetë në mënyrë të qartë: kështu / e zbulova poezinë/ apo ajo më zbuloi mua (Sytë e saj). Pikërisht përmes poezisë Bajraj e kërkoi, e zbuloi dhe e shqiptoi të bukurën: *Jam mplakur duke e kërkuar / të bukurën për t'i dhënë emër / zaten / kjo është puna ime* (Duke e kërkuar të bukurën). Kur lexohet me vëmendje gjithë poezia e Bajrajt, dalin në dritë dy mënyra kryesore që i zbatoi në ndërtimin e teksteve:

A) Tekstet që nuk ndjekin një vijimësi mendimi dhe ndërtimi si tërësi shprehëse poetike e kuptimore, si njësi e pandarë (unike), po zbatohet shkëputja, degëzimi, përfutimi i një realiteti të hapur, shumëor, si dhe i përdorimit të mënyrave të të shprehurit dhe të ballafaqimit ose të kundërvënies. Ajo që i cilëson tekstet e poezive të kësaj natyre është figurshmëria, herë – herë befasuese dhe paradoksale.

B) Tekstet që kanë një shtjellim më të rëndomtë, që kanë tërësinë përkatëse dhe vënë komunikim më të drejtpërdrejtë; vijimësia e asaj që shqiptohet është më e natyrshme dhe më përfillëse; rrëfimi, gjuha dhe kuptimësia janë të zakonshme, pra është e kufizuar figurshmëria dhe shumësia kuptimore e tekstit.

**Realiteti poetik rrjedhë dhe tundimeve shpirtërore**

Poezia e Xhevdet Bajrajt është e lidhur ngushtë me atdheun dhe me njeriun e tij, po dukuria shtrihet edhe tek njeriu në përgjithësi, kudo qoftë ai dhe cilitdo kombi t'i përkasë. Bajraj nuk ishte një vrojtues i thjeshtë e gjakftohtë i asaj që ndodhte në atdhe dhe me njerëzit e tij

gjatë e pas luftës së fundit në Kosovë, po gjithçka e përjetoi në mënyrë të thellë e tronditëse. Ndoshta këtë e kushtëzoi edhe fakti se ai për shumë vite jetoi jashtë vendit, në Meksikë.

Pikërisht jeta e rëndë në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999, po dhe koha pas saj, ku ngjarjet, siç thuhet në një varg, nuk mund të tregohen nga dhembja, kanë kushtëzuar që, përmes poezisë, Bajraj të shprehë pakënaqësinë, kundërshtimin, kundërvënies ose ta ironizojë atë gjendje, meqenëse ai, si individ, nuk mund të bënte asgjë që ajo të ndryshonte. Ndonjëherë pakënaqësia dhe trazimi marrin përmasa të mëdha. Pjesë të poezive po dhe poezi të tëra dëshmojnë shqiptimin e të parëndomtës, të pamundshmes, të panjohurës dhe të fshehtës. E fshehura dhe e panjohura janë shumëfish të rëndësishme për vështrime letrare poetike, qoftë për zbulimin dhe për njohjen e tyre për bukurinë që fshehin dhe mundësinë e ndikimit te njeriu (Siç thuhet në romanin "Princi i vogël" të Antoan Dë Sent Egzyperti-t (Antoine de Saint - Exupéry), qoftë e bukurisë së brendshme të njeriut ose e bukurisë në natyrë: "ajo që përbën bukurinë e tyre është e padukshme!"); ato të thellojnë në mundësinë e gjurmimit e të komunikimit të lartësuar e shumëor, të degëzimit të kuptimeve e pamjeve që përfutohen brenda një teksti. Tekstet e natyrës së këtyllë ta vënë mendjen në veprim, të zhytin (thellojnë) edhe në atë që del nga nënteksti i tekstit, nga ajo që heshtet (sipas gjermanit Wolfgang Iser-it nga vende të zbrazëta – Die Leerstellen eines literarischen Textes).

Po sjell disa vargje që e provojnë këtë mënyrë shqiptimi poetik për shumëçka të rëndësishme në poezinë e poetit: Një gruajë që nga kujtesa vjen; Ëndrrat digjen mbi gurë varresh; çmendjen duhet fisnikëruar thellë nën dhe si zjarrin; njeriu është e vetmja gënjeshtër / që mund të mposhtë të vërtetën; që pakëz ëndërr të shndërrohet në zhgëndërr; etje shkretëtire nga buzët më shpërthyen; loti nuk rrit lule po dhembje mbjell; guri i varrit sy i hapur kohe; me të gjitha ethet e natës nën sqetull; derisa e mbaj natën mbi qepallë; Në sytë e

fëmijës shihet / bukuria e ëndrrës së poetit; Çojmë dashuri me dhembjen; Tani në fushën e zemrës / Kullot flutur e dhembjes; Nën at zëvendësonin zemrat me gurë dielli udhëton mbi re shiu".

Mënyra e tillë e shqiptimit dëshmohet edhe në këto pjesë – pamje që janë ndërtuar nga i njëjti parim dhe kanë të njëjtën natyrë dhe veçanti shprehëse poetike:

*Vetëm edhe pak kohë më duhet të mbërrij tek ti  
më prit të lutem  
sa t'i shkurtoj këmbët me sharrë  
(Më prit të lutem)*

*Pranë këmbëve të saj qëndron një valixhe  
plot me puthje të ëndëruara  
(Statuja e heroit)*

*paramendo veten në shtratin tim  
e dehur nga dashuria  
si lulja pranë lumit  
kur sheh  
diell në ujë diell në qiell*

*e unë gjithkrah  
me buzët në ty  
mbjell vetëtimia  
(Dielli në ujë)*

**Poezia si ngushëllim shpirtëror e mendtor dhe kundërvënien e realitetit**

Për poetin Bajraj poezia është sa një ngushëllim shpirtëror e mendtor, një formë – mënyrë komunikimi dhe mbijetese, një njësim frymëmarrje me përditshmërinë, po aq është, thënë poetikisht, një regëtimë psherë-timash, shkëptimë ethesh dhe shqiptim i ëndrrave plot ankth, i pësimeve dhe i fatit tragjik. Poeti u qaset dhe i bën objekt vështrimi dukuri e gjëra nga më të ndryshmet, edhe ato të imtat (Nëna Tereze thoshte: "Bëj gjërat e vogla me dashuri të madhe"). Duke marrë formën përkatëse përmes tekstit, ato dëshmojnë rëndësinë e tyre dhe e plotësojnë mozaikun e shumëlojshëm dhe të pasur të asaj që Bajraj e krijoi.

Në poezinë e tij, siç u tha, mbipeshon vëzhgimi poetik i rrjedhës së jetës në Kosovë dhe i fatit të njeriut të saj, po dhe të botës shqiptare në përgjithësi. Poetin e trazon gjendja në atdhe, pësimet dhe tragjikat e shumta që e goditën popullin e Kosovës në fund të shekullit të kaluar, dukuri të mbarsura me ankthe e tundime të pazakonshme. Për Bajrajn Kosova është frymëmarrje jete, është "Nusja ime / Jeta ime / Kosovë" (Cila rrugë shpie për te ti), po dhe dhimbja dhe vuajtja më e madhe: *Po t'i lë ëndrrat e mia mbi tavolinën e bukës / Që të mund t'i gjeshe më lehtë / Atdhe* (Ëndrrat e mia mbi tavolinën) nga se njerëzit e tij pësuan dhunime e tmerre nga më të ndryshmet nga pushtuesi, sa edhe *Nën at zëvendësonin zemrat me gurë* (Pranvera 1999).

Fitimi i pavarësisë së Kosovës ishte për poetin një shpresë për dritë dhe për një jetë më të qetë e të mirëfilltë, mundësi për pasurim shpirtëror dhe ngritje të besimit e të vetëdijes, po mjerisht nuk ndodh ashtu: *Kosova fle e sëmurë nga harresa*; Ëndrrat digjen mbi gurë varresh (zari u hodh Cezar) dhe, siç shprehet në poezinë "Ujqërit ilirë": ulur mbi varret e të rënëve për liri

i hëngrën ditët tona si të ishin fara të pjekura kungulli Edhe pas luftës njerëzit në Kosovë u ballafaquan me vështirësi të mëdha, prandaj për të mbijetuar mësyjnë shtetet e ndryshme të Evropës, pra Kosova u zbraz nga njerëzit e saj, sidomos nga të rinjtë, të cilët e bëjnë të sotmen dhe të nesërmen e saj;

*Në oborret e shtëpive të braktisura në Kosovë zgjohen sythët nga gjumi çelin lule*

*dhe vdesin*

*nga malli për njerëz*

Një gjendje e këtillë kushtëzoi që poeti t'i kthehet botës së ëndrrës dhe të përfytyrimit. Veproi në këtë mënyrë për dy arsye. E para, përfytyrimi dhe bota e ëndrrës i jep mundësinë që të përftojë një botë poetike të lirë e të pakushtëzuar; t'i japë shkrim imagjinatës po ashtu dhe të shprehurit, për t'u njësuar me të bukurën, pa të cilën s'ka art. Në këtë mënyrë e krijoi botën që e parapëlqeu dhe iu desh poetit për t'i përmbushur

synimet dhe konceptin e tij krijues në mënyrë sa më të mirëfilltë; në botën e ëndrrës dukuritë e kohëve të ndryshme për afrohen e njësohen; të shprehurit poetik mund të përdoret në format nga më të ndryshmet. E dyta: Për t'iu kundërvënë dhe, siç u tha, për ta kundërshtuar realitetin konkret jetësor në Kosovë, të rëndë dhe të ankthshëm, për ta shmangur shtegtimin me "[...]jethet e natës nën sjetull", për të mos e parë Kosovën "fushë pa emër", siç e duan "pushtuesit e varreve" për arsye

se, sipas poetit, Së pari nuk ishte fjala / së pari ishte uria (Buka e atdheut). Në mbyllje të kësaj parathënie po përmend faktin se s'kam kursyer as mund, as kohë, as dije që në këtë zgjedhje t'i përfshij krijesat më të ngritura poetike të përfuara nga Xhevdet Bajraj.

*Prishtinë, fund shtatori 2023*

*P.S.*

*Për shkaqe teknike poshtëshënimet janë mënjanuar*

*Kujtimi për Nolin*

# NË MOSHËN 81 VJEÇARE MËSONTE PËR PROVIME

**Fan Noli ishte i orientuar politikisht dhe i interesuar për nacionalizmin shqiptar dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Por nuk flisnin ndonjëherë për sportin, edhe pse burri më thoshte se peshkop Noli kishte qenë notar i shkëlqyer dhe shumë i fuqishëm**



**Sara PANARITI**

Ishte i zoti t'ia dilte po aq mirë në botën amerikane, sa edhe në botën shqiptare. Ai ishte paksa vetmitar. Nuk kishte familje. Në jetën personale nuk interesohet për gjërat materiale

"Nuk e njihja peshkop Nolin derisa u martova. Nuk e kisha takuar kurrë më parë. Burri im ishte mik shumë i mirë i tij dhe ata kishin lidhje të ngushta. Zyra e "Vatrës" ndodhej në Huntington Avenue në Boston dhe apartamenti i peshkopit ishte pranë saj në Blagden Street, kështu që ai e vizitonte shpesh Fan Nolin. Apartamenti i tij ishte shumë i hallakatur dhe i mobiluar thjeshtë, shumë pak mobile, por shumë libra". Kështu rrëfen njëra nga bashkëkohëset e Nolit, Sara Panariti, gruaja e botuesit të gazetës më të vjetër shqiptare në Botë, "Dielli", Qerim Panariti.

-Peshkop Noli na vizitonte dy herë në vit. Ai e kishte të vështirë të ngjiste shkallët, sepse çalonte pak dhe e kishte akoma më të vështirë të zbriste. Fakti

që ai dhe burri im ishin aq miq, ishte shumë i çuditshëm sepse burri im ishte mysliman, megjithatë, ai ishte shumë i afërt dhe i devotshëm ndaj peshkopit. Ai e çmonte aq shumë peshkopin sa, edhe pse ishte mysliman, shkonte shpesh në kishë. Peshkop Noli kishte sens të shkëlqyer humorit. Duke e ngacmuar burrin tim i thoshte: Pse nuk bëhesh prift? Do të ishte prift i mirë dhe gruaja jote ka karakter të këndshëm, kështu që do të bëhej priftëreshë e mirë". Ata kishin shumë gjëra të përbashkëta. Qëllimi i tyre mbizotërues ishte përkushtimi ndaj çështjes shqiptare, nacionalizmit shqiptar dhe kulturës shqiptare. Që të dy ishin të interesuar për shtimin e koleksionit të literaturës shqiptare, sepse kur erdhën shqiptarët në fillim në Amerikë, nuk kishte asgjë. Peshkop Noli përktheu shumë libra, mes të tjerash Shekspirin dhe "Rubairat" e Omar Khajamit. Ai shkroi "Historinë e Skënderbeut" në shqip dhe në anglisht dhe përktheu shumë poezi origjinale; shkroi edhe shumë pjesë liturgjike. Përmes përpjekjeve të burrit tim dhe

të shoqërisë "Vatra" u organizua një banket dhe të ardhurat iu dhanë peshkopit, që t i përdorte për botimin e librit "Bethoveni dhe Revolucioni Francez". Libri për Skënderbeun u botua nga "Vatra", kur burri im ishte botues i "Diellit".

Në artikujt që ka shkruar burri im, theksonte se Noli vajti në Harvard, sepse vendosi të krijonte një bazë të mirë në anglisht me qëllim, që të kryente atë punë që donte të bënte. Fan Noli mund t'ia dilte në të dy botët. Shumë herë anëtarë të klerit të huaj ose gazeta të huaja mund të funksionojnë vetëm në gjuhën e tyre, por peshkop Noli dhe burri im mund t'ja dilnin po aq mirë në botën amerikane, sa edhe në botën shqiptare.


Fan Noli kishte aftësi dramatike dhe ndoshta mund të ishte bërë aktor shumë i mirë. Grupi teatral ku kishte marrë pjesë u shpërnda, pasi mbeti në mes të katër rrugëve në Egjipt, pa para. Ai duhet të ketë pasur aftësi dramatike, ndryshe nuk do të mund të mbante të mbërthyer për një kohë aq të gjatë ata

që e dëgjonin. Ishte shumë tërheqës, kur fliste ai, ti e dëgjoje. Disa herë kam ndjekur shërbesat e kishës vetëm për të dëgjuar zërin e tij, sepse duke mos qenë shqiptare, nuk e kuptoja gjuhën. Ai shprehej bukur. Ai ishte në formën e tij më të mirë, kur fliste para auditorit. Bënte që çdo gjë të dukej e gjallë. Kishte një zë të mrekullueshëm, të fortë dhe kumbues (tingëllues). Kur flisnin me njëri-tjetrin, im shoq, Qerimi dhe Noli, bisedat e tyre kalonin nga filozofia te letërsia, nga arti te historia, por subjekti për të cilin flisnin më shumë ishin Shqipëria dhe problemet shqiptare. Fan Noli ishte i orientuar politikisht dhe i interesuar për nacionalizmin shqiptar dhe krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Por nuk flisnin ndonjëherë për sportin, edhe pse burri më thoshte se peshkop Noli kishte qenë notar i shkëlqyer dhe shumë i fuqishëm. Megjithatë, ai nuk kishte shumë kohë për gjëra si kjo, sepse vazhdimisht lexonte, studioonte dhe krijonte diçka. Kjo ishte e mrekullueshme!

Botime të veçanta

# HIJA E LISIT 2, NJË PËRMbledhje E JASHTËZAKONSHME TREGIMESH BASHKËKOHORE!

**Në treqind e ca faqet e kësaj përmbledhje, gjen tregime thellësisht realiste, tregime të realizmit magjik dhe deri te ato surealet apo plot me fantazi të shfrenueme; gjen satira, tregime sarkastike apo pjesë me humor të zi; gjen përshkrime mjeshtrë, dialogë lakonikë, rrëfime të thukëta dhe deri te psikoanaliza dhe shtjellime filozofike**



## Ernest MARKU

Ka një perceptim të gabuem se letërsia shqipe e këtij shekulli nuk vlen, romanet e shkruem në këto kohë mezi shtyhen, janë skematikë, u mungon befasia dhe joshja letrare; shkohet deri atje sa thonë që proza në përgjithësi vuen nga mediokriteti, ma keq se poezia pandemike e rrjeteve sociale. Nuk ka përgënjeshttrim ma të mirë për këto teza, se sa tregimet e përfshime në kët përmbledhje. Ne si kolegjiun redaksional, nuk morëm përsipër me ba kritikën letrare, por nëpërmjet përzgjedhjes tonë, kena dashtë me promovu qasjet ma interesante letrare të autorve shqiptarë, përsa i përket tregimit të shkurtër; kena dashtë me tërëhjekë vëmendjen drejt letërsisë së mirë, asaj të vërtetës, pjesë integrale e letërsisë europiane dhe asaj botnore (nuk fola për letërsi ballkanike pasi, për mendimin tim, nëse ekziston vërtetë një ndarje e tillë, letërsia shqipe asht letërsi europiane sui generis dhe jo nëpërmjet kësaj përkatësie gjeografike).

“Takimi” i Agron TUFËS asht një takim me veten, takim me të shkuemen, takim me ndërgegjen që vuen. Aty gjenë elementë të realizmit magjik, të psikoanalizës, t’sarkazmës dhe mbi të gjitha gjen një gjuhë të pasun, një stil t’veçantë dhe një substancë që ta mban gjallë kureshtjen, edhe përtej fjalëve t’fundit të tregimit. Ky tekst ka disa rrafshe leximi ku shpesh, ma i randsishëm asht nënteksti, sesa ato rreshhta të kursuer që t’rreshqasin në pjesën analitike të trunit.

Depersonalizimi dhe dehumanizimi i individit, si sfida kryesore e shekullit ku jetojmë, asht lajtmotivi i “Zhgjëndërrimi”-t të Alban DANOS. Personazhi kryesor, pa pritë e pa kujtu, zgjohet nga realiteti mbytës dhe kërkon dëshpërimisht me rigjetë veten, rrugë e cila e çon drejt shkatërrimit, pasi bota reale i përgjigjet edhe ma ashpërsisht. Nëse kjo ishte andërra, atëherë autori na len në zgjandërr letrare, pa na udhëhjekë drejt realitetit të ri.

Te “Anarki në Parajsë”, Aleksandër PËRGJINI ia lëshon krejt frenat fantazisë dhe imagjinatës, tuj i kapërcy letrarisht muret e trashendentit dhe tuj i ofru lexuesit një mendim të thellë filozofik, i cili zhvillohet natyrshëm në një shtrat mitologjik dhe mbështetet në erudicion dhe kulturologji, kryesisht në atë të antikitetit.

Alfred DUKA te “Xhandari i Urës” rrëfen në mënyrë krejt të natyrshme, realitetin sarkastik të një personazhi atipik, brishtësia dhe butaforizmi i të cilit, në përballje të vazhdueshme me botën reale, arrijnë deri në kufijtë e stoicizmit. Dialogjet janë sa të natyshme aq edhe sureale, ambiguitet ky, mbi të cilin autori ka ndërthu fabulën letrare të një malësori, sa besnik dhe të bindun, po aq naiv dhe kryeshkamb.

“Syri i madh” i Alket BUSHIT asht një traktakt filozofik, i letrarizuem mjeshtrësisht prej autorit. E gjitha ndodh në një skenë gjigande, aty ngërthehet historia dhe e ardhmja, pasionet dhe friknat e mëdha, forcat dhe shtysat, magjepsjet dhe joshjet... Gjatë leximit, duhet me e mbajtë frymën gjatë pasi,

ato që përshfaqen aty nuk munden me t’lanë indiferent; përkundrazi, kërkojnë me t’mbajtë gjithnji inkadeshent. Ajo që i vjen në ndihmë lexuesit, asht gjuha e rrjedhshme.

Arian LEKA i heq një “Brisk” përjetimeve të një burri, tuj prekë me dorë e me kujtime, gjithë vrugat dhe plagët e lkurës së ftyrës. Çdo shejë ka një histori dhe çdo histori ka kriju një plagë, nga e cila ka mbetë vetëm një vrugë mbi lëkurë, si lapidar apo dëshmi e një dhimbje më të thellë, apo një brengje që s’di me shujtë. Autori e merr ngadalë qethjen letrare të historisë, tuj e mbushë tekstin me emocion, mendim, psikoanalizë dhe joshje.

“Përvjetori” i Artan Gjyzel HASANIT, asht ndërthu mbi një mashtrim letrar befasues. Nëse egziston një fajtor në atë që na ndodh në jetë, minimumi, edhe ne jena bashkfajtorë. Kjo tezë, të ngërthen si një ndjesi e fortë, vetëm në fund të tregimit; mbasi të ka qorrrollepsë mirë e mirë në rrugica të ngushta pasioni e frike, pa të dhanë një shenjë e pa të lanë me dyshu për trukun.

Bujar BALLIU, asht ndoshta shkrimtari që e ndjej ma së shumti të afërt në stil, kjo për shkak të letërsisë spartane dhe folmit lakonik që ai aplikon. Dialogjet te “Çmimi i baltës” janë të drejtpërdrejtë dhe të thukët në të njajtën kohë; te ky tregim respektohet maksimalisht lexuesi, kultura, erudicioni dhe inteligjenca e tij. Karma, përshfaqet befas në fund të tekstit, si një thirrje për me shmangë paragjykimet, tu e vendosë e veten nën lkurën e tjetrit. “Në katin e katërt, dhoma numër një”,

nuk ndodh pothuajse asgja; e keqja ka ndodhë tashmë dhe përsnazhit i duhet me e përballu. Në këtë tregim të rrafshët, Eli KANINA vendos përballë trishtimit dhe mërziisë, njerëzoren dhe të bukurën. Ky tekst të ofron paqe, meditim, jetë, mbështetje, shpresë dhe e gjitha kjo me një gjuhë elegante.

Ernest MARKU, me tregimin e tij “Prishja”, duket sikur do të na evokojë një thirrje të Kadaresë ndaj shtetit shqiptar, për një borxh të palamë prej tij. Bahet fjalë për mënyrën se si i trajtoi ky shtet, nuset që erdhën nga shtetet e kampit socialist për me u martu e me jetu me burra shqiptarë, si dhe për faktin se askush, asnjëherë, nuk kërkoi falje. Natyrisht që autori nuk hjek dorë prej letërsisë spartane, dialogjeve të thukët, stilit lakonik dhe evolimit gjuhsor.

“Ngrehina” e Faruk MYRTAJT të ngjan me pëlhurën e Penelopës që endet ditën e prishet natën, por edhe me administratën shqiptare e cila pothuajse çdo dekadë përjeton vitin zero. Në kufijtë e surealizmit apo realizmit magjik, tu u pshtetë në humorin e hollë apo sarkazmën therse, ky tregim shijohet dhe ta kande me vazhdu edhe ma giatë. Fjolla Muhaxhiri AGUSHOLLI, me tregimin “Flaka e majit” të len pa fjalë, por edhe pa frymë. Ky asht rasti kur vetë jeta asht aq e papërsëritshme sa vetë letërsia. Tmerret e masakrave ndaj popullsie civile në Kosovë, i tejkalojnë edhe kufijtë imagjinatës ma të zhvillueme; kurse autores, i mbetet vetëm me përshkru, me një gjuhë zgjedhun e me një stil të rrafshët. Ajo shkruen në vetë parë dhe e ban edhe



ma dramatike veprën dhe mesazhet që përçon.

“Bora e ngrime e shekullit të shkuem”, asht titulli që Gabriela MUJAJ ka përzgjedhë për tregimin e saj, i cili asht një himn për dashninë. Aty çdo gja duket si e pabesueshme, apo të paktën shumë e rrallë; por në fakt, e rrallë aty asht vetën ndjenja njerëzore që lidh dy zemra, në një kohë apo botë fatkeqe, e cila u kundërvihet me tanë ashpërsinë e saj, por pa mujtë me i thy. Teksti shijohet dhe ta ngroh shpirtin, edhe për shkak të gjuhës që ma kande fort.

Gazmend BËRLAJOLI vjen me krijimin e tij “Natën vonë”, i cili valëzon në kufijtë e surealizmit e realizmit magjik, të josh me psikoanalizë, të zhyt në sociologji, ecën si në teh të brisikut pa ra në dekadencë letrare, asht plot me elementë të postmodernizmit dhe, vetëm sa ta kujton Koliqin me “Ngjarje në Kazemaj”, pasi qasja asht krejt tjetër dhe stili ma modern, ndonëse vesi i shiptarëve mbetet po i njëjti.

Me tregimin e tij “Hasmi”, Gjergj METAJ na ka dhanë një panoramë gati të pabesueshme të shpirtit të malsorit të Veriut të Shqipnisë. Dy personazhet që e mbajnë gjallë subjektin, janë përshkru me nota dashnie dhe me një vërtetsi e thjeshtë emblematike; letërsinë e ban vetë karakteri dhe natyra e tyne, sa e ashpër aq edhe njerzore.

“Fyelli” i Gjergji MIHALLARIT, asht ndoshta tregimi ma tipik i realizmit magjik. E magjishme asht natyra, e magjishme dashnia, e magjishme asht jeta, me të mirat e me të kqijat e saj. Autori kujton e ritregon, kthehet në retrospektivë apo e rimerr temën disa herë, tu e përplasë lexuesin me shkamijtë, lëndinat dhe dallgët e personazhit, që e pranon fatin e njeriut pa u anku.

Hekuran KOKA vjen me një prej tregimeve të tij haluçinante ma të bukura, të cilin e ka titullu “Zotëria me këmishë të bardhë”. Çdo gja aty, nis e mbaron në kokë. Personazhet xanë vendin e njani tjetrit, ngjarjet vendosin vetë me ndodhë ose jo, kurse autori dyzohet në dëshirën dhe frikën e tij për me ndërhy. Filozofi, psikoanalizë, sociologji, imagjinatë pa frena, por mbi të gjitha letërsi befasuese; në dukje e paangazhueme, por pro jetës, të mirës dhe të bukurës.

Shkrimtari Iljaz BOBAJ, “Në aeroportin e huaj” takohet me të shkuemen e tij. E befasishmja xen fill që në nisje, ndonëse vetëm në fund përshfaqet fuqishëm. Personazhi në vetë të parë, paska marrë pjesë në disa përjetime dramatike, për të cilat, vetëm ai nuk paska kenë koshient. Arsye krejt banale, shpesh kanë forcën me na ndryshu jetën. Apo mos jemi ne, ata që zgjedhim?!...

“Vrimat e këmishës së kaltër” të Ilir KADISË, nuk të lanë kohë me shiju ndjenjat dashnore të dy të rijve, pasi jeta ka vendosë me iu tregu anën e saj ma të errët. Bota asht e vogël, aq sa një kmishë të bukur e njeh tanë qyteti; por asht edhe e madhe, sa me u nda në dy pjesë. Ndoshta dashnia asht tekanjoze e nuk duron asnjë mospërsosmëni, ndoshta e shkuemja e helmon të ardhmen, ndoshta... duhet shiju vetëm letërsia, pa mbajtë qëndrim.

Liljana KRISTULLI, me tregimin e saj “Tekat e fatit”, lëviz në kufinin mes dy kohëve, mes Shqipnisë e Greqisë, mes të mirës e të keqes, mes pushtetit dhe persekutimit. Ku nuk e çon fati njerinë, kush e di ç’sjell e ardhmja dhe, pikërisht te kto befasi, autorja gjen shtratin e letërsisë së saj. Edhe gjuha greke i rri mjaft mirë tekstit, që e gjen zgjidhjen te triumfi i dashnisë.

“Gruaja dhe Lumi” asht testamenti letrar i andrrimtares, si subjekt feminist dhe femëror në të njëjtën kohë. Liza BROZI përdor një gjuhë të zhdërvjellët, imagjinatë letrare origjinale dhe ka një stil të thukët tregimi. Personazhi në vetë të tretë, nuk e pranon atë që nuk e don, madje, ky mospranim, nuk ngelet

thjesht një revoltë por shkon deri në krijimin e një realiteti të ri.

Marash MIRASHI, me tregimin e tij “Fantazmat dhe macja e Davidit”, ka ndërto fabulën letrare të dhimbjes për braktisjen e vendlindjeve. Nuk asht vetëm nostalgji, as vetëm dhimbje; asht shpirti i rrënojave që nuk dorzohet. Situata sureale apo momente magjike, fshihen nën lvozhgën e një realiteti të trishtë, që vetëm syri i shkrimtarit i sheh.

“Mërzia” e Mario PALOKËS asht tregimi i mendjes që punon ndamas, në momentet e trishta kur sundon heshtja pas vizitës së Exhelit. Janë momentet e dhimbjes e të kujtimeve, por edhe të hipokrizisë njerëzore. Ajo që e ban të kanshëm leximin e ktij rrëfimi, ma shumë se çdo gja tjetër, asht gjuha e përdorun, plot me nuanca, shprehje e fjalë të shqipes së pastër.

Mark SIMONI me “Mesnatën e të marrëve” krijon një atmosferë me të vërtetë magjike, ku të marrët e qytetit të tij, nisin me vallzu në çmenduninë e tyne. Kanë ardhë të tanë, janë në të njëjtën moshë, edhe pse kanë lindë në kohë të ndryshme. Ndërkohë, qyteti fle, nuk asht ma ai pari; u mbeti të marrve barra, për me e kthy siç kje. Njëpërmjet një gjuhe të rrjedhshme dhe një fantazie gati gati gjeometrike, ky tregim, nuk asht mallë për dashninë por dashni për mallin.

Tek “Era” e Merita BËRDICËS, shohim dy botë ndryshme të udhetojnë pranë njana tjetrës, në të njëjtën ndarje të vagonit të trenit. Moderniteti na shtyn në indifentizëm, drejt mbylljes në vetvete, larg tjetrit e problemeve të tij; kurse kjo autore na tërheq në të kundërt, tuj na kumtu se nuk ka mënyrë ma të mirë për me vlersu ato që ke, se sa me i ballafaqu me subjekte në mungesë të tyne. Në thelb ky tregim, asht një himn për forcën dhe sakrificën e grues shqiptare. Migena ARLLATI me tregimin e saj “Piano”, ngre një apoteozë të së bukurës, në kontrast me mërzinë dhe kotsinë e përditshmënive monotone. Autorja nuk ngre thjeshtë zanin, ajo këlthet si një Albatros në oqeanin e pafund të injorancës. Stili asht i rrafshët, subjekti po ashtu, derisa shpërthen në kulminacion dhe një gjuhë që përshtatet biologjikisht me natyrat e personazheve.

“Maçoku, Mica dhe mustaqet e Stalinit”, asht një tregim i Mimoza EREBARËS, i cili rreket me na kallxu se marria e një pushteti jolegjitim, nuk ka cak e as arsye. Po ashtu, njeriu mundet me u zvoglu aq shumë nga frika e pushtetit saqë, as liria nuk i ban ma derman. Në një situatë ku nuk pritet me ndodhë asgja, natyra asht në paqe me njeriun, befason “njeriu i ri” i diktaturës; hipokrizia dhe mungesa e integritetit tek ai, të fton me dashtë ma shumë kafshët.

Ndue DEDAJ me “Promovin” e tij, vjen në këtë përmbledhje me një autosatirë interesante ku lëngojnë të gjitha problemet që ka letërsia shqipe, nga krijuesit, botuesit, kritikët e deri te lexuesi. Rrëfimi ka një shtrat linear saqë, po të mos kapësh ironinë therëse, mund të mashtrohesh se po lexon një tregim klasik. Magjia i thyen kufijtë dhe njerëzit vijnë aty ku autori do, në mënyrën që ai i do, në raport me atë lloj “normaliteti” që ai po përjeton.

“Lejleku” i Ndue LAZRIT nuk pyet për sinoret e metafizikës, refuzon me pranë burgosjen mrenda të pamundurës dhe, në këto kushte siparane, nuk mundet mos me neglizhu sulmet e mediokritetit thashethemexhi dhe me përjetu të pabesueshmen. Detaje të vogla, njani ma i mrekuellueshëm se tjetri, kanë vetëm një funksion, me na tregu se sa shumë mund të lidhen me njani tjetrin dhe madje të thyejnë edhe trashendentin, dy shpirtina të dashuruem.

Neviana SHEHI vjen me “Porti i dhimbjes”, një lloj letërsie gati gati poetike, por që ruan një lloj koherence në mendimin e saj, të cilin nuk asht e

lehtë m’e përceptu. Personazhi në vetë të parë, apo në të tretën kur dikush ndërhy, por edhe në vetë të dytë kur forma të ndryshme të qenies i drejtohen një vetjeje tjetër; janë gjithnjë në një anije, ose po kërkojnë një varkë. Gjatë leximit, nuk mundesh mos me i ndi valët fort.

“Shtëpia e librave” e Oriada DAJKOS, asht apologjia e bijës për babën erudit. Baba nuk kishte miq, nuk kishte para, kishte vetëm një kand të vogël në një shpi të vogël. Ata i shitën të gjitha orenditë shpisë për me ble libra, biblioteka ishte e vetmja shpi e vërtetë që ai kish. Rrëfimi vjen i shtruet, tu i prezantu detajet një e nga një, nëpërmjet një gjuhe të zhdërvjellët.

Petrit PALUSHI vjen me tregimin e tij “E verdha”, në të cilin rreket me zbërthy makthet e fundit nëpërmjet ngjyrave dhe andrrave. Situatave sureale, iu bashkëngjitet një mesazh letrar, i cili të shtyn me lexu edhe në mes të rreshtave. Gjuha e thukët dhe stili lakonik, e marrin për dore lexuesin, tuj kapërcy edhe kufijtë e trashendentit, apo edhe ato të unit.

“Një ditë me bela” e Petro ÇERKEZIT, asht një fotografi autentike e kreqtrajtimit të shqiptarve në një kufi jedashamirës. Absurdi gërshetohet vrazhdësinë e indiferencës dhe arrogancës, tuj na përballë me situata që të irritojnë dhe të solidarizojnë me viktimat e urrejtjes. Ky asht një tregim tipik i humorit të zi, plot me ngjyra gjuhësore e karaktere të spikatun.

“Gjenerali” i Primo SHLLAKUT, asht personazhi tipik i atij që nuk e pranon dot ndryshimin e kohëve. Ai jeton mes kujtimeve e dhimbjeve, të përzime idhujtari ideologjike; tuj mos mujtë me e nda realitetin prej andrrës me sy hapun, pse e gjithë egzistenca e tij i ka rranjë të të shkuemen. Përtej kësaj, ky asht një tregim thellësisht realist, i cili e ngërthen plotësisht lexuesin në kurthin e vet letrar, ku subjekti rrjedh krejt ngadalë, tuj fotografu çdo detaj artistik. Raimonda Belli GJENÇAJ, vjen me tregimin “Gjysma”, një tregim modern dhe me nota të fuqishme analititiko-filozofike. Gjysmë dashuri dhe gjysmë urrejtje, gjysmë siguri dhe gjysmë dyshim, gjysmë lumtuni dhe gjysmë trishtim, një pafundësi gjysmash që vijnë nga bota e fminisë, nga e sotmja dhe deri tek ardhmja gjysmagjel ambig. “Zhulietra Guçardi” asht titulli i tregimit që na ofron Roland GJOZA, një rrëfim letrar i një jete të jetueme fuqishëm, plot ambicje, arritje, dashni, pasione, andrra dhe përpjekje që nuk njohin kufij; ku dyshimi, brenga e dhimbja, janë bashkudhtarë të padëshirueshme por edhe të pashmangshme. Kontër, Arkidukë të përkoshmëm, gjallojnë në faqet e këtij tregimi, rrugëve të Vjenës apo shtjgjeve alpine, krahas Bethovenit të përjetshëm në dilemat e tij vetshkatruese.

Rudina Muharremi BEJA, te tregimi i saj “Kur ndërronte fustanet...” na sjell një panoramë mjaft të ndërj, të një përballjeje njerëzore, mizorisht dramatike. Baba, detyra e të cilit asht me përcjellë bijën e tij të dashtun në altar, pikërisht në atë ditë, thërritet me ndërmarrë udhtimin e tij të fundit. Në fund të këtij leximi, ndjen se komentet janë të tepërta.

“Lëndina me lulëkuqe” e Salvator GJEÇIT asht tregim i ndërtuem mbi realitetin gati gati magjik të shoqnisë së nderit. Personazhet e tij, befas ndjehen si të kapun në çark, nga vetë ligjet mbi të cilën ata ndërtojnë jetën e tyne shoqnore. Që kuptosh dramacitetin e situatës, duhet me e njoftë mirë karakterin e malcorit të Veriut të Shqipnisë, skrupujt dhe kodet e tij, të cilat autori i shpalos krahas me shtjellimin e subjektit, me një gjuhë të gjallë e përshtatës shterues.

Shkëlzen HALIMI na prezantohet me tregimin e tij “Mona Liza”, i cili nuk asht tjetër veçse letrarizimi i pamundësisë njerëzore për me pranë

të papranueshmen. Pikëllimi ndihet që rreshtat e parë, por shkaku i saj përvijohet dalngadalë, bash njashtu siç përhapet helmi në gjak. Personazhi në vetë të parë, asht artist në shpirt, e njeh të bukurën dhe pikërisht aty kërkon të kapet që t’i punojë një rreng vetes, t’ia fshehë atë të vërtetë të papërballueshme. “Ra tërmet e u pamë” i Thanas MEDIT, asht tregimi i intolerancës ballkanike dhe i vogëlsisë njerëzore të denatyrimit prej interesit të ngushtë. Duhet një tronditje e madhe, që me na e thy lvozhgën e depersonalizimit që i veshim vetes, për me përfitu sa ma shumë nga jeta; të cilin autori e shpreh artistikisht mjaft bukur, tu na befasu me gjetjen e tij letrare.

“Tregim i jetuar” i Vaso PAPAJT, asht një rrëfim i shtruet i asaj që nuk asht aspak e zakonshme, asht pasqyra e ndërgjegjes sonë kombëtare të baltosun nga historia jo fort e largët dhe krejtësisht jonjerëzore, e diktaturës së proletariatit. Detajet janë përshkru me një ndjeshmëni të naltë, me një revoltë të thellë ndaj të keqes dhe adhurim për ata që u përballën me të.

Visar ZHITI te tregimi i tij “Drama e flokëve të saj”, nëpërmjet një elementi në dukje sipërfaqor, na ban me përjetu nevojën jetike të njeriut për një të drejtë themelore të tij, siç asht liria. Mjeshtria autoriale në përshkrimin analitik të detajeve, përshfaqet në trajtën ma siperanane, kur kupton se nuk po lexon për atë që ka ndodhë, por për gjumët që kanë lanë ato në psikikën dhe zgrofin emocional të lirimohuemit.

“Macja që ma preu rrugën tri herë”, asht një tregim i Xheladin MJEKUT, i ndërtuem në rrafshin psikoanalitik të mendimit artistik, i cili ngrihet mbi zakonet bestypte dhe na i sjell ato të dobsueme por jo të zhdukuna, deri te njeriu i sotëm. Dilemat e individit, raporti i tij me modernitetin, nostalgjia për gjanat e thjeshta e besimet naive, vijnë te lexuesi nëpërmjet një stili interesant dhe gjuhe të pasun.

I fundit, por jo nga randësia, Zija ÇELA me “Brezi i Shkretëtirës”, vjen me një satirë të hollë, plot me nota të humorit të zi. Surealja mbizotëron subjektin e tregimit, por nga ana tjetër, kjo na përshfaqet si një realitet i frikshëm, që e kërcënon seriozisht shoqinë shqiptare. Gjatë leximit, mundesh me veu buzën në gaz, ose mund të futesh në të thella, në raport me gjendjen ideoeemocionale të lexuesit.

Në treqind e ca faqet e kësaj përmbledhje, gjen tregime thellësisht realiste, tregime të realizmit magjik dhe deri te ato surealet apo plot me fantazi të shfrenueme; gjen satira, tregime sarkastike apo pjesë me humor të zi; gjen përshkrime mjeshtrërore, dialogë lakonikë, rrëfime të thukëta dhe deri te psikoanaliza dhe shtjellime filozofike; me fjalë të tjera, gjen të gjithë elementët e letërsisë ma të mirë bashkëkohore.

Për mendimin tim, këtu duhet të ishin përfshi edhe katër-pesë autorë të tjerë, tregimet e të cilëve kishin se çka me i shtu ktij mozaiku interesant; ashtu siç mund të ishin përfshi edhe dhetë-pesëmbëdhjetë të tjerë, po të niseshim nga niveli i tyne artistik; por që nuk u përfshinë, për shkak të kriterëve që patëm vendosë paraprakisht, të cilat synonin me e orientu fokusin tonë drejt tregimit klasik, larg skicave, eseve, fejtoneve apo reportazheve. Kurse për rreth njëzet-tridhetë tregime të tjera që skuallifikuem, mundem me thanë jo pa dëshprim, se vumë re tema letrare mjaft interesante, të shpërdorueme prej autorëve të tyne.

Tuj përfundu, shpresoj që me këtë përzgjedhje letrare, të kemi ndiku sadopak në kultivimin e shijeve artistike për tregimin e shkurtër shqiptar. Kjo ishte qasja jonë, këtë lloj letërsie deshtëm me promovu. Uroj të kena pasë kthjellësinë e mendimtarit, seriozitetin e sipërmarrësit, durimin e alpinistit dhe ndershmëninë e besimtarit.

Rilexime

# HEREZIA E DËRVISH MALLUTËS

**Teki Dërvishi në tekstin e tij ka gërshetuar elemente të shumta letrare, kulturore e fetare, duke u nisur nga miti dhe demitizimi, elemente të kulturës muzikore e teatrale, sekte dhe libra të ndryshëm fetar**

**Fatbardhë HASI**

“Herezia e Dërvish Mallutës”, vazhdimësi e librave që do t’i rishkruante edhe një herë Teki Dërvishi. Ky roman na del kupolë e tre librave të mëparshëm, pasi që tek ky libër nuk e hasim frazën këtë libër do ta shkruaj përsëri. I ndërtuar mbi fiksionin, mistiken, mitin, spiritualen dhe realen “Herezia e Dërvish Mallutës” është roman kompleks për t’u deshifruar. Dërvishi zgjedhë lartësinë dhe e bën topos për zhvillimin e ngjarjes në vepër. Kemi një personazh i cili nisët nga rrafshi për të pushtuar majën.

I motivuar nga ngjarjet jetësore të kohës, Teki Dërvishi e ndërton tekstin e tij përmes alegorisë në një rend trishtesor që janë: mbyllja/burgimi i individit si pasojë e mos përshtatjes me kolektivin, njohja e unit dhe nënshtrimi i vetës dhe naiviteti shoqëror (me naivitet po i referohemi injorancës, themi kushtimisht, të shoqërisë lidhur me besimin dhe botëkuptimin për botën. Ata janë, kryekëput, besëtytë).

“Po nisemi nga burimi: herezia është një doktrinë (teori), që u shfaq në gjirin e kishës katolike, që ka të bëjë me gjykimin e asaj që korrupton (prish) dogmat”, (Ibrahim Rugova). Dërvish Malluta ka thyer rregullat të cilave është dashur t’u përmbahet. Por, heretizmi në vepër nuk është vetëm i Dërvish Mallutës, por ai kapë edhe pjesë të tjera brenda tekstit. Kujtojmë ikjen e gjarprit nga themelet e shtëpisë, lutja e nënës që i bën të birit të dalë e ta kërkojë varrin, imoraliteti në Sukën e Cërmjanit, në vend fetar, hilet në bixhoz etj.

Romani fillon në formën e një përralle: moti, në kohët e shkuara, rrëfëhet në vetën e parë, në kohën e kryer të thjeshtë. Në fillim na shfaqet një enigmë, zhdukja e djali në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçe, emri i të cilit nuk na bëhet i ditur. Përmes shenjave në tekst shohim që ai djalë është pikërisht subjekti të cilit i kushtohet vepra e që është Mulla Hamidi i Verdhë, alias Avni Gaxha, që portretizon gjithë të zhdukurit, të cilëve s’u dihet varri e “shpirtrat e tyre bredhin”.

Që vepra i është kushtuar Hamidit të Verdhë, vërtetohemi në tekstin brenda romanit ku narratori rrëfen për takimin e parë me Hamidin. “Kur isha fëmijë fare, kur me prindërit e mi pata shkuar në teqenë e Sukës për ta dërguar



kurbanin e festës së hashurës e hapjes së koburit të Shehut, zogu të Muharremit, Avni Gaxha më kishte marrë në prehër dhe kish thënë: ky do ta shkruaj jetën time.”

Ekzistimin e një personi me emrin Avni Gaxhë, autori e dokumenton me fakte nga libri i amzës për lindjen e tij në vitin 1912, dhe dokumentet arkivore të Komunës së Gjakovës që vërtetojnë vdekjen e tij, në vitin 1957. Autori e vendosë ngjarjen në vitin 1979, por koha në vepër është faktikisht ireale apo subjektive. Vitet e shekujt që kalojnë e rikthehen prapë e bëjnë të qëndrueshëm konstatimin që personazhi e rrëfen ngjarjen somnambul, i shkëputur nga realiteti. Takimi dhe bisedat me njerëz të vdekur dhe me figura nga mitologjia greke, peripecia e

hapjes së koburit të Shehut, zogu që mjaullinë janë një misticizëm i hapur. Meqenëse interpretimi është subjektiv, por duke u lidhur gjithmonë me tekstin dhe shenjat që na ofron ai, atëherë kur kemi parasysh shtresimet e lartcekura si makrotemë e veprës na del: Individit në luftë me veten dhe të tjerët. Në fillim të romanit na është dhënë një lloj prologu, një pohim që Mulla Hamidi i bën narratorit-personazh: e paske mësuar mirë zanatin- shtoi ti di të godasësh lodra të mrekullueshme

po a do të mund të gjesh myshterinj që të mund t’i blejnë këto? Ata që ua dinë vlerën lodrave tua do të vrasin,

kurse të tjerët as do të mund t’i

shohin.


Dërvishi i ri është shkrimtar dhe është pikërisht ky fakt dhe etja e tij për dije dhe njohuri (etja të cilën shkon ta shuajë me ujin e pusit të Sukës) ajo që e bën të ndryshëm nga kolektivi dhe i ngjallë konflikt edhe me Likun. Dërvishi i ri di vetëm lojën e shkrimit, e shkrimi dhe arti njerëzve primitiv s’u hyn në punë. Në panairin e Tyrbes së Becit, zgjidhen shumë dilema e veçanërisht në bixhoz, ku të gjithë i shfaqin fytyrat e vërteta përballë parasë. Aty edhe ngadhënjën shkrimtari/asketi, i cili luan pa frikë, sepse preokupim për të është fryma jo materia. Psikologjia e individit dhe lufta e tij me vetveten e kolektivin vënë në pah frymën ekzistencialiste të thellë tek dërvishi i ri, por edhe te Hamidi i Verdhë. Pesimizmi, vetmia, mbyllja, burgimi apo veçimi nga rrethi dhe lufta e egër shpirtërore me unin, i karakterizon dhe përafron të dy personazhet.

Romani është i ndarë në kapituj të cilët janë emëruar me sintagma simbolizuese. Janë pjesë të dhëna përmes të cilave përmblihet tërësia. Kemi lojën me mbiemra që tregojnë tiparet e çdo personazhi. Hamidi i Verdhë simbolizon njeriu e vdekur, Kurtije Zana, sipas emrit “kurtizane” që ishin prostituta, por edhe kuptonin gjitha llojet e artit për t’i zbavitur klientët, Lik Gushëholli njeri mendjengushtë që s’e përkrahë individualizmin dhe është në luftë të hapur me intelektualët. Teki Dërvishi në tekstin e tij ka gërshetuar elemente të shumta letrare, kulturore e fetare, duke u nisur nga miti dhe demitizimi, elemente të kulturës muzikore e teatrale, sekte dhe libra të ndryshëm fetar. I gjithë teksti i romanit është ndërtuar mbi figurën e alegorisë, është tekst shumë shtresor dhe i koduar. Përveç rrymave të ndryshme filozofike me të cilat përballlet personazhi i tij si: hedonizmi, nihilizmi, skepticizmi, ai shtjellon edhe, të ashtuquajturat, krizat psikologjike të personazhit. Shohim se autori ka vënë në lojë mbarë kolektivin, duke theksuar naivitetin e tyre dhe besimin në besëtytnitë nga më të ndryshmet. “Herezia e Dërvish Mallutës” është roman që ngre dilema dhe të krijon pikëpyetje të njëpasnjëshme, në procesin e perceptimit të niveleve semantike.

Studim

# INDIVIDUALITETI LETRAR I TEKI DËRVISHIT

**Ndryshe nga të gjithë shkrimtarët e kohës në kulmet letrare shqiptare të viteve të '70-ta, T. Dërvishi i pari e futi eksperimentimin si metodë krijuese, që më vonë do të përçohet në gjithë krijimtarinë e tij letrare si mënyrë e veçantë drejt modernizmit "ekstrem",**



## Nehas SOPAJ

Autori T. Dërvishi, më vete bart elementet e përbashkëta të një brezi shkrimtarësh të cilët u formuan dhe u dalluan kryesisht në vitet '70 të shekullit të kaluar, në mesin e krijuesve letrarë të etapës së tretë të Kosovës e Maqedonisë, siç janë B. Musliu, M. Ramadani, J. Buxhovi, J. Gërvalla, Xh. Ahmeti, Y. Shkreli, N. Halimi, S. Hamiti, L. Lepaja, Z. Rrahmani, M. Kraja, Sh. Beqiri etj. Ky shkrimtar, sa është i veçantë dhe domethënës, është edhe autonom me mënyrën e tij të shkrimit, sepse shumë aspekte, elemente dhe kategori të ndryshme estetike të veprës së tij, siç janë natyra e shkrimit, kodet, nënkodet dhe lidhshmëritë e përgjithshme të gjuhës, autorin e bëjnë jo vetëm bashkëveprues dhe bashkëkrijues, por shpesh edhe mësues për shumicën e këtyre emrave të sipërpërmendur. Teki Dërvishi është një ndër shkrimtarët më produktivë dhe vepra e tij shënon shkollë shkrimi për krijuesit e rinj ku autorin e shohim shumë pjellor duke lëruar tri gjinitë letrare paralelisht: poezi, prozë dhe dramë. Sot është vështirë të kuptohet pesha dhe rëndësia e veprës së tij nëse lexohet parciaisht, pra nëse lexohet vetëm si poet, si prozator apo si dramaturg. Por, edhe të lexuarit në tërësi të veprës së tij është i rëndë dhe i vështirë, sepse problem paraqet njohja e domosdoshme e kodeve të shkrimit, që është një sferë e veçantë gnoseologjike e shumë stileve, shpesh të dendur dhe intertekstuale, e që na shtyn t'i kërkojmë vijat, tërthoret

dhe reflekset e botës krijuese e cila qet krye si ironi përtallëse e gjithçkasë që merr ta trajtojë për t'u bërë më tej një veçori tipike për t'u kuptuar saktë mesazhet. Gjithë kjo flet për një nivel të lartë të stilit të shkrimtarit, dendurisë së shprehjes, e cila ndryshe nga të tjerët, ka një tjetër ndërtim që, sa të duket i kapshëm dhe i qartë, përsëri prapa ka abstragimin, duke i selektuar lexuesit në lexues që mund ta përqafojnë, dhe në lexues që nuk arrijnë ta kapin ironinë e asaj që e përflet autori, e që, jo se është e fshehtë në të folur, por që në të folur ka ironi, shpoti dhe sarkazëm që nuk kursen asgjë.

Vepra e botuar e autorit shënon vëllime me poezi: *Nimfa 1*, poezi, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1970, I varur me vargje për drurin e blertë, poezi, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1971, Shtëpia e Sëmurë (libër me poezi në gjirin e të cilit është Halveti, një mini-roman), bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1978, Thashë, poezi, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1981, *Nimfa 2*, bot. NGBG Rilindja, Prishtinë, 1986, përmbledhje me tregime: *Etje dhe borë, tregime*, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1974, romanet: *Pirgu i lartë*, roman, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1972, *Padrona*, roman, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1973, *Skedarët*, roman, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup 1974, *Herezia e Dervish Mallutës*, roman, bot. NGBG Rilindja, Prishtinë, 1981, *Palimpsest Dush Kusarit*, roman, bot. NB Blend, Prishtinë, 1993. Dramat: *Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi*, dramë, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1979, *Bregu i pikëllimit*, dramë,

bot. NGBG Rilindja, Prishtinë, 1985, *Pranvera e librave*, 1990, *Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit*, 1990, *Kufiri me atdhe*, 1996, *Vojceku*, 1996, *Nesër nisemi për Parajsë*, 1999, *Eshtrat që kthehen vonë*, 2000, *Ku është Populli?*, 2003. Ese dhe kritikë mbi teatrin: *Qan e qesh Talia*, bot. Flaka e Vëllazërimit, Shkup 1978. Në shtypin ditor të kohës, në gazetën *Fakti* dhe *Bota Sot* etj. pastaj në bibliotekën shtëpiake, bibliografia e veprimtarisë letrare të T. Dërvishit zgjerohet me një varg veprash tjera, kryesisht drama të pabotuara, që presin botimin e tyre. Edhe pse veprë letrare ndër më të rëndësishmet të letërsisë së sotme shqiptare, kapitale do të thoja unë, marrë në përgjithësi për këtë veprë është shkruar pak, shumë pak. Hiq ndonjë shkrim të A. Aliut, R. Musliut, S. Hamitit, N. Islamit, J. Papagjonit e të ndonjë tjetri, për veprën letrare të T. Dërvishit është shkruar pak, kaq sa ajo sot vazhdon të jetë në margjinat të interesimit të kritikës letrare dhe të shkencës filologjike shqiptare. Mjerisht, pa merita.

Emri i T. Dërvishit, në këtë mes, pa mëdyshje shënon vlerën e vërtetë të epokës interkaluese prej modernizmit kah postmodernizmi shqiptar, me çka ai dëshmohej si një ndër krijuesit më këmbëngulës në kërkimet e tij në shkrime, si një nga stilistët, sprovuesit dhe eksploruesit më të zellshëm të mënyrave të reja të shkrimit, por edhe si një ndër eksperimentuesit më në zë, që për kohën ka mbetur i paarritshëm edhe sot, por mjerisht i pabotuar dhe pastudiuar akoma deri më sot. Siç do të shihet nga rruga e ngritjes së tij prej

vepre në veprë, T. Dërvishi, në kuadër të "modernizmit kosovar", do të veçohet si luftëtar i pakompromis i thyerjeve të tabuve dhe dogmave letrare, të stileve të ndryshme të shkrimit të kohës duke i lënë ato stile si një tradicionalizëm që nuk i sillnin gjë të re shkrimit shqip. Qysh atëherë, në vitin 1978, autori e shfaq një qëndrim negativ ndaj realizmit socialist, të cilin e përtall dhe stigmatizon si kic politik të ditës, që për kohën ishte një lloj sfide dhe tundimi i veçantë për krijuesit, sepse të shkruarit në stilin soc-realist në atë kohë, për një pjesë të krijuesve "patriotë" të Kosovës, shitej si modernizëm (alias "novatorizëm", siç e quanin në Shqipëri) dhe të deklaroheshë kundër ishte tradhti. Në librin *Shtëpia e sëmurë*, me anë të një shkrimi poezi, plus prozë, plus dramë, ai do ta ironizojë, parodizojë dhe deplasojë totalisht soc-realizmin me anë të një eksperimentimi inverziv, i cili mirëfilli do t'i shënjojë filltet e postmodernizmit tonë. Siç do ta shohim më tutje, autori do të jetë në frymë me kohën, sepse në mënyrën e shkrimit të tij ai i kishte absorbuar dhe absolutizuar të gjitha llojet e realizmeve e të modernizmave nga më të ndryshmit, si shkrime demode, të tejkaluara përgjithmonë, për ta kultivuar një mënyrë të re shkrimi, eksperimental, që tundonte drejt shkrimeve të reja, për nga natyra hibride, siç është poezia plus prozë plus dramë brendapërbrenda strukturës narrative, duke paralajmëruar konceptet të tjera, fare të reja për artin e letërsisë, prej nga që importuar.

Ndryshe nga të gjithë shkrimtarët e kohës në kulmet letrare shqiptare të

viteve të '70-ta, T. Dërvishi i pari e futi eksperimentimin si metodë krijuese, që më vonë do të përçohet në gjithë krijimtarinë e tij letrare si mënyrë e veçantë drejt modernizmit "ekstrem", me një gjuhë fare tjetër shkrimi drejt çarjes së censurës, hapjes së temave të ndaluara, drejt emancipimit estetik të gjuhës poetike. Lufta me gjuhën drejt emancipimit të saj, te T. Dërvishi reprodukon një varg veprash, të cilat lexuesit i sjellin në zanafillë të konceptit se çka në të vërtetë presupozon arti i letërsisë, cili realisht është misioni i tij, çka në të vërtetë mundet letërsia në konditat e epokës globale e çka jo. Që këtu, të gjitha veprat letrare të T. Dërvishit mëtojnë t'i japin përgjigje kësaj pyetjeje, e cila presupozon pikërisht emancipimin e gjuhës, fuqitë e saj të brendshme deri te ato më sakralet, që t'i thonë të gjitha kategoritë estetike të fjalës, duke përfshirë të gjitha aspektet e mundshme të kohës dhe të hapësirës (fundin e tyre), temat të cilat vetëm mund të ironizohen, pezhorohen ose eseizohen si finesa të postmodernizmit. Në vitet e '70-ta, në galerinë e krijuesve letrarë shqiptarë tashmë më të dalluar dhe të patundshëm në altarin e mbarë letërsisë sonë, siç janë M. Camaj, I. Kadare, A. Pashku, R. Qosja, A. Podrimja, F. Reshpa, B. Musliu, M. Zeqo etj., poeti Teki Dërvishi shkruante ndryshe nga të gjithë. Gjersa ata, në shkrimet e tyre, mund cilësohen si poetë modernë, Teki Dërvishi, si edhe B. Musliu e M. Ramadani, në shkrimet e tyre dallohen me një tip shkrimi ndryshe nga të tjerët, "më modern" se modernizmi i asaj vale krijuesish që sot i çmojmë për elitë të kohës e që sjellin një stil shkrimi "ekstremisht" të mbathur, me elemente të kulturave

të ndryshme të botës, që për kohën dallohet sheshit me gjithanshmërinë, vibrimet dhe denduritë stilore të fjalisë prej nga ato edhe vijnë. Letërsia latino-amerikane dhe, sidomos, tregimet e H. L. Borgesit, që në letërsinë e përbotshme tashmë quhet thjesht borgesizëm, te ne do të kulmojë mbase më së miri me shkrimin e T. Dërvishit. Shumë studiues e konsiderojnë atë shkrim abstrakt, njëlloj variacioni i ri i lartpurlartizmit. Borgesizmi ose shkrimi me denduri formacionesh stilore brenda një stili të vetëm, në vitet e '70-ta ka pasur një impakt dhe difuzion zgjerimi në të gjitha letërsitë kombëtare, në Ballkan, në Europë dhe në botë, që këtu edhe në Kosovë. Në letërsinë shqipe, T. Dërvishi është përfaqësuesi ynë më tipik pikërisht sepse ky shkrim është përzjerje diskursesh: poezi, prozë e dramë – një koagulim eseizimi. Mbase kjo është arsyeja se pse kritika e kohës nuk e priti autorin tonë me ovacione sikundër i prisnin krijuesit që sillnin inovacione, pa atë entuziazmin e dalluar të atëhershëm.

Megjithatë, ndryshe nga të tjerët, Teki Dërvishi edhe sot është i papranuar në skenën letrare shqiptare, i palexuar dhe i pastudiuar, pra pikërisht për shkak të stilit të shkrimit të tij, "të rëndë", i cili rri larg shtresave të gjera të lexuesve, studentëve dhe profesorëve, të cilët edhe sot vazhdojnë ta lexojnë klasiken tradicionale dhe klasiken moderne, por jo edhe shkrimtarët postmodernë, të cilët siç e thamë, shquhen me denduri stilistikore, me begati dhe thellësi gjuhësore, në "trend" me ndryshimet në çastin kur edhe ndodhin ato. Është një temë shumë e palavd të diskutohet për fillimet e letërsisë postmoderne shqiptare, që, sipas mendimit tim,

lidhet pikërisht me emrin e T. Dërvishit, kur këtij formacioni stilistik sot mund t'i dalë zot kujt t'i teket. Jemi në një kohë kur të gjithë flasin për epokën postmoderne dhe kur me këtë drejtim të gjitha "participojnë" paralelisht shkencat dhe artet, por të flasësh për letërsinë postmoderne, kjo i bie sikur të flasësh për një kuptim nganjëherë edhe pa definicion.

Deri sot janë shfaqur mendime se për postmoderne mund të jetë poezia e fazës së fundit të M. Camajt (të ashtuquajturat poezi eksperimentale të librit Nën hijen e gjarpurit), dikush e cilëson ashtu prozën e R. Qosjes, më saktë romanin Vdekja më vjen prej syve të tillë, dikush romanet e I. Kadaresë, por ka edhe mendime të tjera, alternative, që lidhen me vepra të tjera dhe me autorë të tjerë. Meqë definicioni postmodernizëm është pafundësisht i gjerë dhe për të mund të flasësh e të thuash gjithçka, por kurrë të vërtetën e saktë, shkencërisht të argumentuar, sepse gjithmonë diçka do të mbetet e pa thënë deri në fund, e thënë gabimisht ose edhe e thënë me tendencë e cila, ec e dije se ku shpie. Këtu, më poshtë, po nxjerr në dritë tezen time se disa aspekte dhe prova të veprës letrare Shtëpia e sëmurë, na shpijnë në vitin 1978, kohën kur qe botuar ky libër, koha që shënoi fillimin e një shkrimi për të cilin themi se e nisi postmodernizmi në letërsinë shqipe. Teki Dërvishi, duke filluar me librin poetik Shtëpia e sëmurë, pastaj një vit më vonë me dramën Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi e këtij deri në fund të krijimtarisë së tij letrare, ka bërë që shkrimi i tij të jetë i veçantë që do të kërkojë nga lexuesi të jetë kategori aktive sa edhe vetë autori, diçka që me automatizëm e verifikon mendimin e W. Isser se aktanti i tretë, krahas autorit

dhe veprës, kërkon që lexuesi të jetë aktanti relevant në aktin e interferimit vepër, autor dhe lexues. Lexuesi i veprës së tij duhet të jetë në nivel me kulturën e domosdoshme teorike sa edhe autori, parakusht dhe domosdo që të mund ta receiptojë atë letërsi që i servohet, një nga kategoritë fundamentale që një vepër të jetë në korrent me kohën, të jetë postmoderne.

Më poshtë do ta kujtoj lexuesin për një deklaratë të Teki Dërvishit me rastin e vdekjes së Beqir Musliut, mikut të tij të ngushtë për nga vokacioni dhe shkrimtaria, në të cilën ai thotë: "Poeti, romansieri, dramaturgu, eseisti dhe publicisti Beqir Musliu është përfaqësuesi i parë i postmodernitetit në letrat shqipe...". Them se po të ishte gjallë B. Musliu, ai do të deklaronte se T. Dërvishi është shkrimtari i parë postmodern shqiptar jo ai vetë. Kur e them këtë, për të mos u dukur kjo një kurtoazi e ndërsjellë mirësjelljeje, ne që kemi bashkëkrijuar mu në atë kohë kur ata i kanë ngritur kullat e tyre prej arti të veçantë, them se T. Dërvishi është borgesisti i parë, B. Musliu surrealisti i parë, të dytë tok me M. Camajn, janë postmodernistët fillestarë në letërsinë tonë. Në të vërtetë, emrat dhe veprat letrare të këtyre dy individualitetëve shumë të veçanta dhe ndër më të rëndësishmit, bashkë me veprën e M. Camajn, shënojnë fillimin e epokës së postmodernizmit të letërsisë bashkëkohore shqiptare.

(Shkëputur nga libri "Trinomi postmodern shqiptar", botuar nga Shtëpia botuese DRINI, Ferizaj, 2024)

## Ana tjetër e medaljes

# LAMTUMIRA MASHTRUESE

**Libraritë me libra të përdorur gjithmonë më ngjallnin trishtim. Më dukeshin si vende me histori të harruara, të lëna pas dore, të braktisura**

### Oliver MOL

Librat që na rrethojnë tregojnë shumë për personin tonë, për atë që jemi, ose ishim. Ndërsa po përgatitesha për shpërnguljen nga Sidnej në Barcelonë, isha ulur në dyshemenë e apartamentit duke vërtitur sytë rreth 100 ca librave që kisha blerë gjatë 6 viteve të jetesës në atë qytet. Disa ishin të këndshëm, disa tituj klasikë, shumica të trishtë.

-Do t'i fal librat, - i thashë sime mëje në telefon.

Pa diskutim që isha i trishtuar.

Por në fund kuptova se nuk i hiqja dot qafe të gjithë. Kështu i ndava në pigrje, ndërsa një nga një shikoja kopertinat, lexoja titujt dhe te ndonjë ndalesha te kapitulli i parë. Disa syresh më sollën kujtime të eksperiencave të kaluara. Me librin "Një grua e pafat" të Richard Brautigan u ktheva edhe një herë në moshën 20-vjeçare, kur nisa të jetoja më vete. Me librin e Haruki Murakamit, "1Q84" isha 21 vjeç, kokë e këmbë i dashuruar. Me Mira Gonzalez isha 25 vjeç, në apartamentin tim në Marrickville, shoqëruar nga kolla e fqinjët të dërrmuar nga kanceri, ndërsa unë përpiqesha të mbaroja librin tim të parë. Ja dhe "Gjërat që mbajmë me vete" e Tim O'Brien, që më sjell ndërmend kohën në Brisbane: unë 28-vjeçar në shtëpinë e prindërve, në dhomën ku u rrita, pas një periudhe të gjatë migrene të pandashme...Këta libra më kishin ndihmuar në periudha të ndryshme të jetës; ishin bërë si nënë e babë e motër e vëlla për mua. Këta libra ishin bota ime, mbushur



me trishtim e gëzim, me dhimbje, vuajtje, lumturi, magji. Ata e kishin bërë jetën time më të lehtë. Këta libra kishin përgjigje - ose pyetje - për ekzistencën time; ishin mësuesit e mi. Alejandro Zambra më mësoi madhështinë e qetësisë dhe nevojës për t'u dëgjuar. Valeria Luiselli me "Fytyra në turmë" më kujtoi se në krijimtari nuk ka rregulla. Kisha edhe një libër të Jamie Mortara. U takuam në 2015-n në Minneapolis në një takim poetik. Pas atij takimi bleva librin "Një planet", që më shkruheu në lot. Në moment kuptova se nuk mund t'i braktisja këta libra, që nuk mund t'i çoja në

varrezë, që të harroheshin, të humbin... Ndaj bëra atë që bëj gjithmonë: mora një laps dhe nisa të shkruaja. Në pjesën e brendshme të kopertinës së atyre 10 librave shkrova mesazhe për 10 miq, duke u thënë se do të më mungonin dhe se këta libra ishin gjithçka për mua. U shpjegova se sa më kishin ndihmuar, që më kishin bërë personin që jam sot. Mbase kjo ishte mënyrë ime e lamtumirës, një lamtumirë mashtruese, por e vetmja që dija për tua kaluar këto histori njerëzve që i kam për zemër. Një ditë para se të nisësja, njëri prej miqve të mi më ndihmoi të mblidhja plaçkat dhe librat

e mbetur i çuam në një bibliotekë. Bibliotekari, lexoi titujt, buzëqeshi dhe më tha:


- Jam i sigurt se do t'u gjejmë strehë.

Strehë, pikërisht kjo fjalë më preku: strehë. Në atë moment kuptova që po largohesha, por nëse do të ndihesha ndonjëherë i vetmuar, i humbur ose i trishtuar, në ndonjë nga këto vendet që dikur i quaja varrezë, do të gjeja patjetër një botë të gatshme për të më pritur - mua dhe këdo tjetër. (Përktheu: Elona Qose)

Simbologji

# E KUQJA

**Në përgjithësi e kuqja shihet si një ngjyrë agresive, vitale, e pasur me energji; ajo është e lidhur me zjarrin dhe me dashurinë, por edhe me luftën për jetën**



## Zija VUKAJ

Nga të gjitha ngjyrat, e kuqja është ajo që sipas statistikave, preferohet prej pjesës më të madhe të njerëzve. Nën formën e oksidit të hekurit ka shoqëruar udhëtimin e njerëzimit që nga prehistoria dhe është e dukshme në dëshmitë shkëmbore të epokës së akullnajave. Neandertalasit e kishin zakon të spërkatnin të vdekurit me materiale me ngjyrë të kuqe, me sa duket për t'u kthyer atyre ngjyrën e "ngrohtë" të gjakut të jetës. Në përgjithësi e kuqja shihet si një ngjyrë agresive, vitale, e pasur me energji; ajo është e lidhur me zjarrin dhe me dashurinë, por edhe me luftën për jetën. Mbi karakteret e mbyllura e melankolike, ka, sipas traditës, një efekt turbullues dhe shtypës. Në simbologjinë e vërtetë e të pastër e kuqja paraqitet në interpretime të shumta, mjaft të ndryshme nga njëra-tjetra. Në Egjiptin e lashtë kishte kuptim pozitiv vetëm kur tregonte "kurorën e kuqe" të Egjiptit të Poshtëm me deltën e tij të Nilit. Por e kuqja vihej në lidhje të drejtpërdrejtë me zotin e keq Sutech (Seth- Σήθ, Sèth) dhe me zotin po aq të keq Apofi (Apophis), gjarpri. Nëpër papiruse emrat e tyre ishin shkruar me të kuqe dhe kafshët e kuqe, si disa tipa qensh të përhapur

asokohe në Egjipt, mbaheshin zakonisht larg komunitetit, pasi ngjyra e tyre lidhej me idenë e dhunës dhe të agresivitetit.

Në artin parakolumbian të Meksikës së lashtë e kuqja përdorej shumë rrallë dhe lidhej kryesisht me gjakun, me diellin, me zjarrin dhe me paraqitjen e mëlçisë. Tek Majat konsiderohej si simbol i Lindjes, ndërsa tek banorët e rrafshnaltës së Meksikës së lashtë, si simbol i Jugut. Kështu edhe në Kinën e lashtë, ku e kuqja (hung) ishte ngjyrë e shenjtë dhe jetësore e dinastisë Chou (1050- 256 p.k)- një rrethanë që shëmbëllen flamujt e kuq të Kinës komuniste. E kuqja ishte edhe ngjyra e perëndisë së lumturisë, që përcakton pasurinë e njerëzve. Nëse në Evropë kombinimi i së kuqes me të gjelbrën ka një domethënje të ashpër dhe agresive, në Kinë kjo shprehte thjesht vitalitetin në lidhje, për shembull, me "çorape të gjelbra e fund të kuq" të grave të reja apo me drita të kuqe e rrush jeshil të tavernave. Burrat "e kuq", për kinezët ishin bashkëshortë të goditur rëndë nga jeta bashkëshortore, sugurisht të destinuar nga vdekja e parakohshme.

Në artin kristian tradicional e kuqja ishte ngjyra e gjakut të sakrifikuar të Krishtit dhe të martirëve, të

dashurisë së zjarrtë (e kuqe ishte veshja e Gjonit, e preferuara e apostujve) dhe e flakës së rrëshajës së Shpirtit të Shenjtë. "E kuqja kardinaleske" tregon se ai që e mban këtë veshje duhet të jetë gjithmonë i gatshëm të derdhë gjakun e tij për mbrojtjen e Kishës. Por edhe prostitutat e përdornin një ngjyrë të tillë në veshjet e tyre dhe shpesh idhujt paganë ishin pikturuar me të kuqe. Veç kësaj, kujtojmë se në "Apokalipsin e Gjonit", "prostituata e madhe Babilonia" nëna e prostitutave dhe e çdo mizorie tokësore, ishte veshur "me purpur dhe me të kuqe flakë"; ajo kalëronte një përbindësh me shtatë krerë, "një kafshë të kuqe me vese të tmerrshme". E kuqja u bë pastaj ngjyra e ferrit, e djallit dhe e kafshëve të "dyshimta", që tradita i ka lidhur me botën e skëterrës (dhelpira dhe ketra). Por e kuqja që interpretuar në kuptim të lartë pozitiv ku tregonte fitoren e dashurisë, si në paraqitjet artistike që kanë për objekt Krijuesin apo Krishtin e ringjallur. Në veshjet e shenjta, e kuqja është ngjyra që vishet në celebrimet e martirëve, të Shpirtit të Shenjtë e të Pasionit.

Sidoqoftë, në simbologjinë popullore e kuqja ka mbetur ngjyra e dashurisë, shpesh e lidhur me lulet, mes të cilave me trëndafilin apo

edhe me zemërimin. Natën dritat e kuqe tregojnë intimitet, prostitucion dhe mes sinjaleve rrugore e kuqja merr përgjithësisht kuptimin "stop" ose tregon praninë e një rreziku. Në korrida e kuqja ka funksionin të eksitojë demin, megjithëse kafsha në realitet irritohet nga lëvizjet vorbulluese të muletës më shumë se nga ngjyra e saj. Në alkimi e kuqja bashkë me të bardhën përbën një sistem dualistik dhe simbolizon parimin e zanafillës së squfurit (sulphur et merkurius), "flakëruesi". Ky polaritet mund të varet nga opinion i lashtë që kur gjaku menstrual takohet me spermën, mund të lindë një jetë e re: për këtë shkak dy ngjyrat e sipërpërmendura bëhen simboli i krijimit.

Tek Masonët e kuqja tregon gradën e epërme të "ritit skocez" dhe i kundërvihet të kaltrës së Masonerisë së re me tri gradët klasike: nxënës, rishtar, mjeshtër. Në psikologjinë e thellësisë e kuqja, kur shfaqet në ëndrra, ka të bëjë me sferën e emocioneve. "Aty ku e kuqja përhap ngjyrën e saj, shpirti është gati për veprim, për pushtim, për vuajtje, për kushtim total; por tregon edhe shtypje dhe jep një lidhje të privilegjuar me sferën e ndjenjave"

Profile: Aleksander MOISIU

# NJË JETË PËR TEATRIN

**Roli i tij më i famshëm ishte Fedia, nga "Kufoma e gjallë" e Tolstoit. Ky rol u luajt nga ai vetë rreth 1400 herë. Zor se gjendet rast tjetër i ngjashëm, kur një aktor të personifikohet aq shumë me një nga rolet e tij**

## Grigor JOVANI

Në etapën ndërmjet dy shekujve të kaluar, ishte artisti fenomenal i teatrit. Në prizmin botëror italo-austriak, por me origjinë shqiptare. Moisiu u lind (më 2 prill 1879) në Tergesti (Trieste) të Italisë. Prindërit e tij ishin Moisi Moisiu nga Kavaja, në kohën kur atdheu i të parëve ishte nën Perandorinë Otomane, një tregtar i pasur shqiptar drithërash dhe Amalia de Rada, arbëreshe nga Tergesti, e bija e një mjekufiorentinas. Kaloj një femini ndërkombëtare, fillimisht në Tergesti, pastaj në Durrës të Shqipërisë dhe më vonë në Grac të Austrisë. Njëzetvjeçar, Aleksandri u vendos bashkë me të ëmën dhe dy motrat në Vjenë.

Qysh shumë i ri u pasionua pas teatrit. E gjithë jeta e mëvonshme i kaloi mbi skenë dhe u përkushtua asaj. Fillimisht mori mësimet fonetike. Pastaj bëri kërkesë pranimit për te "Hofburgtheater". Nuk u pranua, për shkak të theksit të fortë italian në të folurën. Ra në një kompromis ulës me drejtuesit e Teatrit: e pranuan pak më vonë në role anësore, ku nuk fliste. Në një premierë të tillë, gjatë sezonit 1899-1900, në një rol anësor tek "Tartufi" i Molerit, mimika dhe gjithë prezenca e tij skenike i ra në sy dhe e impresionoi aktorin e famshëm austriak Jozef Kainz, që luante rolin kryesor. E kuptoi menjëherë se aktori i ri me theks italo-jugor nuk ishte për role të dyta. Këtej e tutje, me përkrahjen e Kainzit nisi karriera e madhe e Moisiut, si një nga aktorët më të mëdhenj të skenës evropiane, në fillimet e shek. 20-të.

Një vit më vonë Kainzi e dërgoi Moisiun te "Teatri i Ri Gjerman" i Pragës dhe më 1903 u bë pjesë e "Deutsches Theater" të Berlinit, nën drejtimin e regjisorit të famshëm Maks Rainhard, i cili iu bë mentor artistik. Në Berlin shkëlqeu i plotë talenti i tij aktrimi. Bashku me Rudolph Schildkraut luajti në premierën berlineze të "Tregtarit të Venedikut" të Shekspirit, me regji të Rainhardit. Triumfi qe i plotë, shtypi gjerman himnizoi zërin e tij orkestër. Ishin tejkaluar tashmë kritikën e para për theksin gjithmonë italian në të folurën e aktorit, pikërisht zëri i tij, sa kumbues aq dhe melodioz, e bëri protagonistin më të dashur të skenës gjermane. Mandej erdhën turnetë artistike nëpër Evropë, duke ia përhapur famën tek të gjithë kontinenti. Më 1911 trupa teatrore e Rainhardit udhëtoi në Rusi. Në Shën Petërburg, luajti mrekullueshëm rolin protagonist tek "Edipi mbret" i Sofokliut. Atje fitoi kritikën entuziaste të njerit prej njerëzve më të njohur të teatrit evropian, kritikut dhe dramaturgut të famshëm rus, Anatoli Linaçarski.

Gjatë vazhdimet të turneut nëpër Evropë dhe Amerikë, roli i tij më i famshëm ishte Fedia, nga "Kufoma e gjallë" e Tolstoit. Ky rol u luajt nga ai



vetë rreth 1400 herë. Zor se gjendet rast tjetër i ngjashëm, kur një aktor të personifikohet aq shumë me një nga rolet e tij.

Megjithë famën ndërkombëtare, Berlinit është qyteti ku Moisiu u bë i famshëm për aktrimin, me role të spikatur. Fillimisht me interpretimin e Osvaldit, te "Fantazmat" e Ibsenit (1906). Pastaj erdhën rolet e tij të mëdha protagonistike, ato të Hamletit, Edipit, Faustit. Ishin "festa teatrore të asaj epoke, me zërin dhe diapazonin emocional që përmbanin", theksonte shtypi gjerman i asaj kohe.

Përveç "Deutsches Theater" në Berlin, Moisiu luajti edhe në Austri, te "Volkstheater" i Vjenës dhe te Teatri "Josefstadt". Ndonëse protagonist i skenës teatrore, u shfaq në dhjetë filma, gjatë periudhës 1910-1935, ndërmjet të cilave shtatë janë pa zë. Te këta të fundit dallohet roli në filmin "Një student në Pragë" (1913).

## E kishte një atdhe pas vetes

Më 1914 Moisiu mori nënshtetësinë gjermane. Për të kryer detyrën patriotike, u regjistrua vullnetarisht në ushtri, gjatë Luftës së Parë Botërore. Përveç patriot, ndjehej edhe njeri shoqëror. Në kohën e Revolucionit Gjerman të 1918-19-ës u përfshi në Lidhjen Marksiste "Spartaku", fakt që dëshmon bindjet e tij politike dhe shoqërore. Mbi të gjitha mbeti artist, i dashuruar totalisht me skenën. Më 1920 luajti rol protagonistik në interpretimin e parë të preformancës "Jedermann" të Hugo fon Hofmannsthalit, në Festivalin e Salcburgut. Nderkaq, Moisiut nuk iu përshtat

e reja që po pushtonte skenën gjermane, si ekspresionizmi gjerman dhe rryma e teatrit epik, që filloi me premierat që ngjiten në skenë regjisorët avangardistë Erwin Piscator dhe Bertolt Brecht. Filloi të duket se diçka nuk shkonte mirë me të dhe me Teatrin Gjerman. Përfundimisht, braktisi Gjermaninë më 1933, për shkak të ngjites gjithmonë e më tepër të nazizmit, ideologjia dhe praktikën e të cilit e gjenin krejtësisht kundër.

Në këto çaste të vështira për të ardhmen, iu gjend mbështetja e vendit të të parëve të tij, Shqipërisë. Nëpërmjet rrugëve diplomatike, Mbreti Zog i ofroi nënshtetësinë shqiptare. Por, e arriti, më shpejt se lëvizjet dramatike të kohës, vdekja (22 mars 1935). Dha frymën e fundit në Vjenë, ku qe stabilizuar më së fundi (akoma nazizmi nuk kishte ardhur në fuqi atje), i sëmurë kronikisht nga pneumonia, e cila i qe rënduar kohëve të fundit. Trupi iu dogj dhe hiret iu varrosën te Varrezat Morcote, me pamje liqenin e Luganos, në Zvicër.

Nderimi i merituar për këtë njeri dhe artist të jashtëzakonshëm të Teatrit erdhi duke u shtuar në kohët moderne, ngaqë talenti dhe virtytet njerëzore që shpalosi gjatë një jete të tërë, janë të vlera, të gjithëkohshme të njerëzimit. Me emrin e tij u pagëzuan rrugë dhe shesh në Berlin, Salcburg dhe Vjenë. Në kryeqytetin austriak, i cili e konsideron Moisiun "qytetar nderi" të tij, në vitin 2005 iu përrua një monument në një nga sheshet kryesore.

Është e natyrshme që Shqipëria, atdheu i të parëve të tij, e nderon

si një nga bijtë më të shquar, me kontribut të jashtëzakonshëm dhe nderues në kulturën evropiane. Përveç se konsiderohet "artist kombëtar", emrin e tij ka Akademia e Muzikës dhe Arteve në Tiranë, si edhe Universiteti dhe Teatri i qytetit të Durrësit. Në vendlindjen e të atit të Moisiut, në Kavajë, shkolla e mesme dhe teatri mbajnë gjithashtu emrin e tij. Përvjetori i 60-të nga vdekja u përkujtua në Shqipëri si "Viti Artistik i Moisiut", me veprimtari të shumta artistike për nder të tij.

## Moisiu njeri

Edhe pse ishte i krishterë, e çuditshmeja është se Moisiu konsiderohet shpesh si hebre. Mbase për hir të mbiemrit që trashëgoi nga i ati. "Moisiu" është një mbiemër i shpeshtë në Shqipëri, që shumë rrallë mund t'i korrespondojë origjinës çifute. Ose këtu ndikoi edhe miqësia që lidhte shpesh me kolegët e tij hebrenj, në një kohë që ata konsideroheshin "dele të zeza", të destinuar për thertore, në shoqërinë gjermane. Moisiu kritikoi ashpër në shtypin gjerman këto praktika raciste në marrëdhëniet midis njerëzve dhe në ato shtet-qytetarë, duke ftuar botën e krishterë t'i përmbahet idealeve të saj dhe të ndalojë diskriminimin e turpshëm të hebrenjve: "Përsa u përket hebrenjve, morali i krishterë, njerzillëku dhe vlerat njerëzore nëpërkëmben brutalisht..." ose: "Rruga e antisimitizmit është një kthim pas drejt ditëve të errëta të Mesjetës..."

\*\*\*

Moisiu u martua dy herë. Fillimisht me gjermanen Maria Moisi (Urfus), nga Teplice e Bohemisë. Më 1913 ajo themeloi në Berlin një shkollë teatrore, ku jepte leksione edhe i shoqi. Nga kjo martesë Moisiu pati një vajzë, Beatricën.

Me aktoren Herta Habah, pas një lidhjeje të paligjshme, kishte vajzën e dytë, Betinën. Martesën e dytë e bëri me një aktore tjetër, Johanna Tervin. Aktori i njohur gjerman Gedeon Burkhard është stërnip i Moisiut nga kjo martesë.

## Kanë thënë për Moisiun

"Zëri dhe gjestet e Moisiut na paraqitën diçka të pashfaqur gjer tani në skenën evropiane". (Franc Kafka).

"Hamleti është i shkruar për Moisiun dhe Moisiu ka lindur ekskluzivisht për të interpretuar Princin e Danimarkës". (Maks Brod).

"Përshtetja Aleksandër Moisiun, të cilit i jam gjithmonë mirënjohës, si njëri nga interpretuesit më të ndritur të karaktereve të mi". (Luixhi Pirandelo).

"Sa herë je me të do të mësosh diçka të re për jetën në atë botë nga e ka origjinën..." (Stefan Zvaig).

Trajtesë

# KU DUHET TË SHKOJNË INTELEKTUALET?

**Nëse mentaliteti i shoqërisë zanafillore moderne ishte se lumturia e individit varet fortësisht nga ekzistenca e një "shoqërie të mirë", mentaliteti i shoqërisë së sotme, që ai e përkufizon si "likuide", bazohet në parimin se domethënia unike e një "shoqërie të mirë" qëndron në të drejtën e individëve për të ndjekur në mënyrë intelektuale lumturinë e tyre**



**Gersa RRUDHA**

Jehona e rolit dhe ndikimit të intelektualëve ose e veprave të të diturve të të gjitha kohërave ka ekzistuar gjithmonë e forte në zemrat e njerëzve të çdo vendi. Por, po kaq i përhershëm ka qenë edhe transformimi i realitetit në të cilën ata punonin dhe përfaqësonin, duke bërë që të fitonin herë pas here një ndërgjegje të re karshi këtyre realitetëve të transformuara. Në këtë rrjedhë të gjatë kohore mund të ndërfaqsim edhe periudhën në kapërcyell të viteve 900, ku ndihet një ndryshim i kulluar i mënyrës së perceptimit të realitetit dhe konceptimit të shkencës, për shkak të zbulimit të kohës si "periudhë" nga ana e Bergsonit, të "pandërgjegjes" nga ana e Frojdit dhe të relativitetit nga ana e Ajnshtajnit. Të gjitha këto përmblidhen në atë që u quajt "shoku i modernitetit", pasi që atëherë e shkuara dhe e tashmja, koha dhe hapësira, shkak dhe pasoja, ndërgjegjia dhe pandërgjegjia, nuk janë më të dhëna absolute, por relative. Një shkrimtar i madh si Luixhi Pirandelo e përshkruan kështu çorientimin e ndërgjegjes moderne, si pasojë e këtij transformimi: "Në mendjet dhe zemrat e të gjithëve mbizotëron një konfuzion i jashtëzakonshëm. Me normat e vjetra tashmë të rrënuara dhe me normat e reja ende të pastabilizuara, është e natyrisht që koncepti i relativitetit të gjithëkujt të jetë zgjeruar fortësisht brenda nesh, duke arritur deri aty sa të humbasë përmasën e tij.

Askush s' arrin dot të stabilizojë diçka të qëndrueshme dhe të pashkatërrueshme. Termat abstraktë e kanë humbur vlerën e tyre, duke çliruar ato fijet e marrëdhënies së përbashkët që i bënin të kuptueshëm nga të gjithë. Jeta jonë, s'ka qenë kurrë ndonjëherë, etnikisht dhe estetikisht, kaq e shpërbërë. Rrjedh prej këtij këndvështrimi, pjesa më e madhe e sëmundjes intelektuale të kohës sonë". Kjo masë e theksuar relativizmi ka ardhur duke u rritur dhe forcuar akoma më shumë me zhvillimet e vrullshme të teknologjisë së dekadave të fundit. Ndaj simptomat e kësaj ndërgjegje duket të jenë rënduar gjithnjë e më tepër. "Unë di sepse jam një intelektual, një shkrimtar që kërkon të ndjek pas gjithçka që ndodh, të njohë gjithçka që shkruhet, për të imagjinuar gjithçka që nuk dihet ose që heshtet; për të koordinuar edhe fakte të largët me njëri-tjetrin, që arrijnë të bëjnë bashkë copat e ç'organizuar dhe fragmentare të një tabloje të tërë, koherente, politike, për të vendosur logjikën aty ku duket të mbretërojë arbitrariteti, marrëzia dhe misteri". Kështu, shkruante në vitet 70-të shkrimtari Pier Paolo Pazolini mbi rolin e intelektualit. Po si shfaqet vallë ky rol në shoqërinë e sotme dhe në politikën moderne. Tre janë librat më të spikatur të këtyre viteve në analizimin e mundësisë së intelektualëve për të ndikuar në realitetin shoqëror të kohës. Që përpara 25 viteve, sociologu i famshëm Zygmunt Bauman, boton një libër të kthyer tashmë në një klasik, me titullin "Legjislatorë dhe interpretë" (të përk-

thyer në versionin italisht me emrin "Dekadanca e intelektualëve"). Sipas tij transformimi që epoka post-moderne e fillimit të viteve 80-të të shekullit të kaluar kish provokuar mbi intelektualët, kish sjellë kalimin e rolit të tyre nga "legjislatorë" dhe këshillues të "princërve", të aftë të sugjerojnë një rend shoqëror në bazë të ndërgjegjes së vet, siç pat qenë për shumë kohë, në rolin e një "interpretuesi" të thjeshtë, në rolin e një "rripi transmisioni" midis pjesëve të ndryshme të shoqërisë, që tashmë, në kohët moderne, arrijnë t'i marrin vetë vendimet, pa dëgjuar shumë mendimet e të "mençurve". Nëse mentaliteti i shoqërisë zanafillore moderne ishte se lumturia e individit varet fortësisht nga ekzistenca e një "shoqërie të mirë", mentaliteti i shoqërisë së sotme, që ai e përkufizon si "likuide", bazohet në parimin se domethënia unike e një "shoqërie të mirë" qëndron në të drejtën e individëve për të ndjekur në mënyrë intelektuale lumturinë e tyre. Me fjalë të tjera, mentaliteti i "mbledhësve" në kohë të të mirave materiale, sot gjen gjithnjë e më pak mbështetës. Në përgjithësi, ky mentalitet priret të zëvendësohet nga mentaliteti igjhtarit; lumturia e gjahtarit rritet në mënyrë proporcionale me numrin e trofeve që ai ka në aktivitetin e tij; gëzimi i tij nuk shkatërrohet aspak nga mendimi se sukcesi i sotëm mund të zvogëlojë numrin e preve të së ardhmes, duke vënë kështu në rrezik mundësinë e suksesit të gjeneratave të ardhme. Kjo nënkupton që individët post-modernë janë më ego-

istë se sa individët e shoqërive të vjetra. Për këtë arsye, Bauman interesohet të vërtetojë bashkë me këtë "përkeqësim" të egoizmit individual, edhe parabolën elitare kulturore. Nga mbajtësit e pushtetit "të ndikimit" të dikurshëm, intelektualët sot janë detyruar të bëjnë vazhdimisht "llogari" me vetveten. E pas këtyre "llogarive" u mbeten vetëm dy mundësi: të vijojnë të riprojektojnë botën dhe strukturat e saj apo të bëhet ndërmjetës ose më mirë përkthyes mes "palës" së klasës udhëheqëse dhe asaj të sunduar. Për Baumanin, roli i intelektualëve duhet të pozicionohet në mundësinë e dytë, për t'u shndërruar në një "urë" që të favorizojë dialogun midis atij që e ka pushtetin dhe atij që e pëson. Nuk ekziston më projektimi i së ardhmes si detyrë e tij, as edhe kuptimi i së tashmes si "ndërgjegje kritike e shoqërisë", por vetëm roli i një "ndërmjetësuesi" të thjeshtë. Ky rezultat fotografon një situatë objektive, ku shumica e intelektualëve, në rastin më të mirë, "lëmojnë ashpërsinë e pushtetit", kurse në rastin më të keq, bëhen kasnecët e tij "organikë". Një tjetër autor i spikatur në përshkrimin e këtij roli është edhe Wolf Lepenis, në librin e tij "Ngritja dhe rënja e intelektualëve", duke analizuar veçanërisht situatën e krijuar pas rrëzimit të murit të Berlinit në 1989. Degradimi i pushtetit sovjetik shënoi njëherësh edhe zhdukjen e çdo alternative ideologjike ndaj liberalizmit mbizotërues të Perëndimit. Ekzistenca e një modeli unik me anë të të cilit arrin të mendohet shoqëria, fshin çdo mundësi

të ekzistencës së intelektualëve, sipas Lepenis. Në këtë kategori që zhduket, përfshihen vetëm intelektualët ankimtarë, ose më mirë, ata intelektualë që “ankohen për botën, por nga vuajtja e tyre lind një mendim utopik, që dizenjon një botë të re e kësisoj largon edhe melankoninë e së tashmes”; kjo zhdukeje ndodh pasi, në një botë me vetëm një model unik, një intelektual i tillë arrin të zëvendësohet mjaft mirë nga shkencëtari. Këta të fundit, “shpjegon Lepenis”, nuk dëshpërohen për botën, por sforcohen ta shpjegojnë atë, nuk mendojnë në mënyrë utopike, por formulojnë parashikime. Veprimi i tyre nuk përcaktohet as nga dëshpërimi e as nga shpresa, por nga objektiviteti dhe nga zotërimi i një “ndërgjegje të qetë”. Këtu ekziston dualizmi midis “klasës së ankimtarëve” dhe “njerëzve të ndërgjegjes së qetë”, që praktikisht, përfaqësohet nga ndarja koherente midis “dy kulturave”, asaj të letrarëve dhe humanistëve nga njëra anë, dhe atyre të shkencave nga ana tjetër. Shkencëtarët janë intelektualët “organikë” të pushteteve neoliberaliste; e s’mund të jenë ndryshe pasi dogma qendrore e liberalizmit është progresi teknik dhe shkencor. Ndërkohë që në këtë realitet, intelektualit që bëhet “ndërmjetës” midis pushtetit dhe masës së popullit, identifikohet në mënyrë tërësore me “njerëzit e ndërgjegjes së qetë”, me ata që shpjegojnë botën dhe parashikojnë mbarëvajtjen e saj. Akoma dhe më thellë në këtë analizë shtyhet një libër i botuar së voni, më 2013, me titullin “Ku po shkojnë intelektualët?”, nga njëri prej historianëve më brilantë të dhunës bashkëkohore, Vinçenzo Traverso. Pas shembjes së bllokut sovjetik, sipas autorit, kanë ndodhur dy transformime kryesore: nga njëra anë kultura dhe veprat e saj u shndërruan masivisht në objekte konsumi dhe nga ana tjetër, intelektualët u munduan të përshtaten duke u transformuar në “ekspert”. Në këtë mënyrë “mendimi kritik” filloi të vritej gjithmonë e më shumë, sepse figura e “ekspertit” u shoqërizua me atë të “teknikut” që duhet të japë një mendim “neutral”. Ky rol i fundit i shndërroi intelektualët në “ekspertë emisionesh televizive” apo komentatorë gazetash e revistash, me qëllimin kryesor atë të “shpjegimit të botës”, jo të ushtrimit të një kritike mbi botën. Shembujt që ai jep nga bota intelektuale franceze janë të nivelit të lartë, po megjithatë Traverso nuk shfaqet pesimist. Përgjigjet, gati si të plastifikuara, të ekspertëve, bëhen gjithnjë e më të papërshtatshme, pasi denoncimet apo akuzat gati të përditshme shfaqin hapur një rritje të pabarazisë dhe pabarazisë sociale. Problemi qëndron në faktin se intelektualit që mund të shërbejë si “ndërgjegjja kritike e shoqërisë” nuk është gazetari, as profesori i mediatizuar i universitetit, por studiuesi kritik, qoftë i një institucioni publik apo privat, që prodhon kundër-informacion. Ky lloj intelektual mund të jetë i “gjindshëm” në shumë fusha, por nuk është kurrë aty ku e kërkon media; pasi ai nuk e kërkon median, as është i sponsorizuar prej saj apo o.j.f. të ndryshme. Është pikërisht kjo tipologji intelektualësh, që sipas autorit, do të jetë protagonist i një “revolucionit” që ai e përcakton si të një “intensiteti të ulët”, ose e thënë ndryshe i një revolucioni të vazhdueshëm dhe gërryes për sistemin. Nëse do t’i shëmbëllënim këto tipologji të rolit intelektual në pasqyrën e realitetit shoqëror dhe mediatik shqiptar, do të shikonim se mbizotëron më tepër tipologjia e “ankimtarit” mbi atë të intelektualit “me ndërgjegje të qetë”, e gazetarit - specialist apo e ekspertit-mediatik mbi intelektualin e “ndërgjegjes kritike” të shoqërisë. Në përgjithësi, qerthulli i intelektualëve tanë, e kanë ndjerë si të natyrrshme, detyrën e udhëheqjes së popullit. Por për të kuptuar sa më mirë se si mund të ndikojnë mbi popullin

dhe si duhet ta ndihmojnë atë, së pari nevojitet të kuptohet domethënia e termit “udhëheqje e popullit”. Ajo nuk nënkupton vetëm drejtimin politik, por parësisht një punë edukuese dhe emancipuese pranë popullit. Dhe me udhëheqës “intelektualë”, siç do të shprehej Edith Stein në letrën e saj të famshme drejtuar intelektualëve, nuk nënkuptohen vetëm teoricienët, por të gjithë ata që në bazë të një formimi teorik ushtrojnë një profesion praktik. E këtu mund të përfshihen kategori të tilla si mjekët, mësuesit, udhëheqësit fetarë, e kështu me radhë. Madje, këta të fundit, sado e çuditshme mund të duket, renditen në mënyrë të patjetërsueshme mes tyre, pasi nga këndvështrimi fetar dhe ai i etikës sociale nuk mund të kënaqemi ta lëmë popullin herë pas here pa ndihmë. Kush ka arritur në një shkallë më të lartë humaniteti, në krahasim me masë e gjerë të njerëzve, nuk mund ta konsiderojë këtë shkallë si shenjë ndarëse; përkundrazi, bëhet fjalë për një shenjë fisnikërie që na angazhon për të punuar për të tjerët dhe pranë tyre. Aq më tepër që populli është më i prirë të pranojë si udhëheqës ata që kanë dalë nga gjiri i tij dhe kanë arritur një vend të lartë në shoqëri, pa humbur kontaktin me ata që janë poshtë tyre; pasi besohet, se ata e kanë ende për zemër njeriun e popullit dhe dinë shumë më mirë se cilat janë shqetësimet e tij. Kush i flet popullit me një gjuhë të rrjedhshme, të “lëmuar” prej njerëzve të “kultivuar”, kush “fluturon” shkujdeshtëm mbi realitetin e rëndë të luftës së përditshme për të jetuar, në të cilën është ngërthyer sot pjesa dërrmuese e shqiptarëve, ai është i dyshuar që në fillim të rolit të vet udhëheqës. Po kështu edhe një vullnet i lartë sakrifice apo një entuziazëm i madh i shprehur aq fort për të mirën e popullit, streha ku “fshihen” shpesh mjaft programe zgjedhore apo cikle reformash politike dhe shoqërore, përsëri nuk arrijnë t’i shkatërrojnë dot barrierat që ato ngrenë me popullin. Në këtë kuptim, intelektualit do ta gjejë rrugën kundrejt popullit, pa të cilën ai s’mund të arrijë ta udhëheqë atë, vetëm nëse çlirohet prej intelektualitetit të vet. Kjo nuk nënkupton aspak mohimin dhe braktisjen e tij. Përkundrazi. Intelekti është një dhunti për të cilën ata kanë nevojë, jo vetëm për veten, por pikërisht për ata që dallohen prej tij. Veçse Intelekti duhet të dijë të kuptojë limitet e veta, për t’u shndërruar kështu në një cilësor thjeshtësie për njeriun. Pjesa më e madhe e aktivitetit të intelektit, të udhëheq zakonisht kah një arrogancë apo mendjemadhësie intelektuale. Ajo të bën të ndihesh i lartë dhe i madh në lartësitat e kulluara te abstragimit, sipër “popullit profan” të përzierë dhe ngatërruar në “ultësitat” e nevojave të jetës. Është kjo kryelartësi, edhe pse intelektit atë nuk e shfaq hapur apo nuk e ndjen në ndërgjegje në mënyrë të bindshme, ajo që nga të tjerët perceptohet si përbuzëse dhe si një “zakon” nga i cili intelektualët duhen “pastruar”. Për të gjitha këto arsye, nuk janë të paktë mendimtarët që kanë hedhur herë pas here kushtimin ndaj intelektualëve “për të marrë udhën që i shpie drejt popullit”. Njëri prej tyre, mjaft i spikatur në këtë analizë, është Antonio Gramshi. Sipas tij, intelektual mund të pretendojë të përfaqësojë popullin vetëm kur raporti në mes tyre themelohet mbi bazën e një “sinteze organike në të cilën ndjenja dhe pasioni shndërrohen në kuptim dhe dije. Që një intelektual ka një raport funksional me klasat sunduese është diçka e analizuar gjatë. Ndaj tyre Gramshi vendos intelektualin “organik” të popullit. Elementi popullor “ndjen”, shpjegon ai, por jo gjithmonë kupton ose di”. Kurse, elementi intelektual “di”, por jo gjithmonë, kupton e veçanërisht “ndjen”. Dy ekstremet janë pedantizmi nga njëra anë dhe pasioni i verbër ose sektarizmi nga ana tjetër. Jo

se pedanti nuk mund të jetë i apasionuar, përkundrazi; pedantizmi i apasionuar është po kaq i rrezikshëm dhe qesharak sa sektarizmi dhe demagogjia më e shfrenuar. Gabimi i shpeshtë i intelektualëve qëndron në besimin e tyre se mund të dihet edhe pa kuptuar, e sidomos pa “ndjerë”. Madje, se ata mund të jenë të apasionuar edhe kur janë të shkëputur nga populli, pra, pa ndjerë pasionet elementare të tij, për t’i kuptuar edhe shpjeguar ato. Nuk bëhet as histori, as ndikim e as politikë pa këtë lloj të caktuar pasioni, domethënë pa këtë lidhje sentimentale midis popullit dhe intelektualit. Kjo ka qenë mangësia më serioze dhe e dhimbshme e intelektualitetit shqiptar të gjithë këtyre viteve, ndoshta e ndikuar kjo dhe nga një trashëgimi e caktuar, ku më e ndërgjegjshme dhe ku më e pandërgjegjshme, e mendësisë komuniste. Në pafuqi dhe dobësi të këtij raporti, kjo lidhje është reduktuar në një raport të llojit burokratik dhe formal, duke i shndërruar intelektualët në një kastë (analistësh mediatikë) ose siç e përcaktonte Gramshi, në një “fuqi të centralizuar organike” ndaj popullit. Për të gjitha këto, është mjaft urgjente të analizohet kjo pambushmëri thelbësore e distancës mes intelektualit dhe popullit. Pasi, vetëm kështu mund të arrihet të kuptohet më mirë zgjedhja e komplikuar midis intelektualëve teknokratë që “dinë” dhe popullit të paditur që “ndjen”. Janë që të dyja të këqija kundërthënëse me njëra - tjetrën, por e dyta pafundësisht më e keqe; për shkak se një popull që vetëm ndjen ose beson se ndjen është pre e lehtë e “pehlivanëve” partiakë të aftë ta rrugë - shtrembërojnë thjeshtësisht. Njëri prej dëmeve më të mëdha të populizmit, është pikërisht “zerimi i kompetencave” në favor të gjykimit të përgjithshëm popullor. Në një kohë që këtu qëndron edhe “mos - marrëveshja tragjike” në diferencën midis “të pasurit një opinion” dhe “të pasurit një kompetencë”. Këtë gjë është e nevojshme ta fokusojnë dhe zgjidhin intelektualët tanë, sepse kronika jonë politike, ashtu siç ka bërë gjithmonë, do të mundohet të propozojë me këmbëngulje parësinë e një grupi opinionistësh të përzgjedhur prej saj, të privuar nga kompetencat, por që do të përpiqen vazhdimisht ta qeverisin vendin pikërisht nëpërmjet opinionëve. Nuk duhet harruar që humnera që ndan mbështetësit e kompetencës, meritokracisë, nevojës së logjikës kundra demagogjisë nga njëra anë dhe mbështetësve të cilësisë së popullit, të thjeshtëzimit të bazuar tek gjykimi i tij i përgjithshëm dhe dyshimit korrespondues ndaj intelektualëve, është një histori antike. Megjithatë, sidomos në këto vitet e fundit, zëri i ndërgjegjes kritike të intelektualëve shqiptarë duket të jetë mekur deri në masën e zhdukjes. Njerëzit tanë të kulturës duket të kenë “ngujuar” gjithnjë e më shumë në “fortesat” e profesionëve të tyre, jo vetëm prej shqetësive të qëllimta, por edhe pse jeta shqiptare i ka shtrënguar ata t’i binden e për më tepër t’i përgjigjen ligjeve të shitjes dhe fitimit. Tregu është fuqia që nuk lë të shpëtojë askënd prej këtyre “profesionistëve të kulturës” për të dalë jashtë prej “marifeteve” të tij, falë trysnisë së klapave që i vendos, të tilla si çelja dhe mbyllja me komandën e pushtetit dhe oligarkisë financiare të kanaleve të spikatjes dhe komunikimit, në favor të shumë të tjerëve të etiketuar si intelektualë, por që vuajnë “dyshimin” popullor të moralit dhe cilësisë. Ndodhi, pikërisht, ajo që perifranoi Bauman. Intelektualët të “reduktuar” në cilësinë e interpretuesve, shqetësohen më tepër të lehtësojnë dhe “lubrifikojnë” ingranazhet e tyre të komunikimit për ti “shitur” kështu sa më mirë aftësitë dhe resurset e tyre në këtë treg. Ndaj, Shqipëria është kthyer tashmë në një vend aspak “joshës” për të rinjtë, për shkak të pamundësisë së punësimit dhe

shpresës që ofron për ta; por, po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për intelektualët. Ata nuk janë zhdukur, por janë asgjësuar nga parëndësia që pushteti dhe shoqëria tregon për ta; E vetmja mënyrë për të rezistuar është të bësh pjesë në “trupin e mediave të mëdha” proqeveritare, që gjithsesi kanë shumë pak poste për të ofruar, duke lënë jashtë saj shumë mundësi e kapacitete që duan të rroken e të shfaqen. Aq më tepër që teknologjia dhe rrjetet sociale, kanë krijuar një realitet të ri ose më mirë një realitet të dyfishtë, ku nevojiten kësisoj “mjete” të reja për të ndikuar. Pasi, nga njëra anë, demokracia e rrjeteve nisi të shfuqizojë dalëngadalë intelektualët në cilësinë e tyre vendimtare si pedagogë, edukatorë dhe ndërgjegjja kritike e shoqërisë. Por, nga ana tjetër, “popullsia” e tyre është gjithmonë në një kërkim të ethshëm për zëra autoritarë, për t’u orientuar sa më drejt në një botë “hiper-sociale” ku nuk ekziston më një qendër, por një mori qendrash dhe nënqendrash, që përbëjnë labirintin rrjetëzor të bashkëkohësisë. E veçanta e realitetit të sotëm gjendet pikërisht në këtë “bashkësi qoshesh” të panumërta, por jo komunikuese me shumicën prej tyre. Asnjë intelektual nuk arrin ta zotërojë sot atë lloj “teorie” që përqafon gjithë morinë e këtyre “qoshëve” të formimit e informimit që të mund të orientojë sjelljet e qëndrimet apo të fiksojë qëllimet e ardhme. Fjala kyç e rrjeteve sociale nuk është më “autoriteti”, por “reputacioni”; këtë gjë, duhet të dinë ta përdorin njerëzit tanë të kulturës, për të arritur të jenë ndikues. Dhe më pas të kuptojnë drejt se gjithçka është e shndërruar në opinion, madje është opinion edhe ndaj atij që ka një opinion. Intelektualët nuk janë zhdukur. Ata nuk duket të jenë më “filozofët”, por “ekspertët” e një bote ku teknologjia po triumfon mbi çdo dije humaniste dhe ku teknika po përshtellohet me shkencën. Jemi në epokë e “inteligjencës së turmave”, sipas një teorie të zhvilluar nga Rhaingold; në epokën ku “njohja” është kthyer në një pronësi të rrjetit, të cilën nuk mund ta zotërojë dot njëri i vetëm, qoftë ky një Didëro (autor i enciklopedisë së parë të dijes mbarëbotërore) apo Hegel (autor i enciklopedisë së shkencave filozofike), siç e përcaktonte ky studiues i rrjetit në librin e tij të njohur “Dhoma inteligjente”. Ky është “itinera-ri” i vështirësive dhe rrezitëve me të cilat duhet të përballen intelektualët e sotëm. Dija është gjithnjë e më e pasigurt, por akoma dhe më humane, gjithnjë e më e paqëndrueshme, por më transparente. Atëherë, mund të shtrohet pyetja, cili duhet të jetë roli i intelektualit në hapësirën e kësaj bote të globalizuar, fluktuuese dhe të “pluhuritur” në aq shumë qëndrime? Ajo çka mbetet është të shndërrohen në interpretë, për të “lexuar” domethëniet e botës, qofshin ato objekte, fjalë, ide, imazhe dhe për t’i “lexuar” ato drejt, pasi dallimi qëndron pikërisht këtu. Ekzistojnë interpretime të drejta dhe të gabuara, të cilat intelektualit i takon t’i dallojë dhe t’i spikasë. Në botën e konsumatorëve, siç e perifrason të sotmen Bauman, hapësira e “njerëzve të kulturës” duhet të kristalizohet në rolin e ndërmjetësit për komunikim midis “provincave të pakufizuara” të rrjetit dhe “komuniteteve të shpjegimeve domethënëse” të tij; midis realiteteve që në rrjet mendojnë në termat e risisë dhe të ardhmes dhe atyre që priten të ushtrojnë vazhdimisht qëndrime kritike. Ja, në “ullukun” e lëvizjes së lavjerrësit të ndërgjegjes midis këtyre dy skajeve, intelektualiteti shqiptar do të dijë ta mbartë me kurajo “kryqin” e misionit të tij në ndikimin e jetës sonë shoqërore, për të mos e lënë sistemin tonë në vend të endet pa mbarim në kalvarin e vet, të filluar prej dekadash.



Profile

# REMARKU, HUMANISTI DHE USTAI I FJALËS

**Opusi krijues i tij është mjaft i pasur me disa romane kult të revoltës, të ngritjes kundër padrejtësive sociale e politikave regressive**



**Bujar MEHOLLI**

Erih Maria Remark është njëri ndër shkrimtarët kryesorë të shekullit të kaluar. Veprimtaria e tij prozaike, e gjerë, përfshin tematika nga lufta kundër nazizmit gjerman me Adolf Hitlerin në krye. Kemi të bëjmë pra, me një intelektual të angazhuar politikisht, i cili shfrytëzon mjetet artistike për t'ju kundërvënë një regjimi totalitar që po bënte kërdi në kontinentin e vjetër, në Evropë, me kampet e përqendrimit, kufizimet, urrejtjen, spiunët, policinë sekrete Gestapo... Remarku është vetëm njëri nga autorët e aradhës së shkrimtarëve që u ngritën kundër regjimit hitlerian duke dashur të promovojnë humanizmin, lidhjen e kombeve, lirinë e demokracinë, e mbi të gjitha dashurinë, ndjenjën më fine të qenies njerëzore që, në vitet e regjimit, ndrydhej diku në skutat e thella të shpirtit duke u përzierë me vuajtjen, frikën, torturën psikike. Për fatin e mirë të lexuesve shqiptarë, Remarkun e sollën në gjuhën shqipe emra të mirënjohur të fushës së përkthimeve letrare, nga të cilët po përmend Robert Shvarcin, Aristidh Ristanin e Fatmir Dibrën, të cilët u përpoqën t'ia transmetojnë lexuesve shqiptarë stilin karakteristik të prozës remarkiane, depërtimin

në psikologjinë e personazheve, përshkrimet pikante të ambienteve dhe dialogët e gjallë që e veçojnë Remarkun si shkrimtar realist kritik.

\*\*\*

Opusi krijues i tij është mjaft i pasur me disa romane kult të revoltës, të ngritjes kundër padrejtësive sociale e politikave regressive. Disa nga romanet e famshme të Remarkut janë: "Asgjë e re nga Fronti i Perëndimit", "Tre shokë", "Shkëndija e jetës", "Një natë në Lisbonë", "Harku i Triumfit" e të tjerë. Ky i fundit, "Harku i Triumfit", konsiderohet ndër krijimet më të arrira të shkrimtarit gjerman; në shqip e përktheu Robert Shvarci me parathënie nga Ismail Kadare. "Harku i Triumfit" i shkruar dhe botuar në vitet '40, u bë shpejt popullor dhe njëri ndër romanet më të lexuara të shekullit XX. Parisi! Vendi i lirisë, "toka e premtuar" e artistëve, shpirttrave të lirë që e urrejnë dhunën, e duan jetën dhe e adhurojnë të bukurën. Përshkrimi i Parisit të asaj kohe nga penda e Remarkut është tipik, duke ngritur një paralele paradoksale, ku nga njëra anë gëlon arti dhe jeta e gjallë bulevardëve e kafeneve, kurse nga ana tjetër lufta është afuar çdoherë e më shumë dhe qiejt e zymtë paralajmërojnë shkatërrimin, tmerrin, rrënimin e çdo vlere njerëzore. Këtë situatë të

nderë, Remarku, na e shfaq përmes personazhit kryesor Ravik, emri i tij i rremë, një kirurg, refugjat, i ikur nga kthetrat e Gestapos që në roman përfaqëson fatin e qindra-mijërave njerëzve të persekutuar nga regjimi hitlerian. Raviku është heroi tipik i letërsisë së realizmit; ai fiton lehtë simpatinë e lexuesve ngase shfaqet thellësisht human, delikat, njeri që dëshiron liri për vete dhe për bashkëkohësit e tij – megjithëse Raviku vret Hakenë, njeriun që pati torturuar qindra njerëz në bodrumet e errëta, me teknikën e "marrjes në pyetje" që i bënin nazistët. Po ata qenë përgjegjës për vetëvrasjen e Sibilas, dashnores së Ravikut, e cila ra viktimë e Gestapos. Raviku thur një plan për ta vrarë nazistin e Gestapos. Përmes këtyre rreshtave mund të ndihet forca me të cilën Remarku ngret grushtin e urrejtjes ndaj regjimit çnjerëzor.

\*\*\*


Parisi jepet në roman me tërë shkëlqimin e tij prej metropoli dhe "atdheu" artistësh. Kafenetë, baret, pijet e panumërta, rrugët e rrugicat e zhurmshme, kioskat e gazetave, hotelet, bordellot, përbëjnë itinerarin e "Harkut të Triumfit" dhe refugjati gjerman Raviku i dalldisur nga kjo atmosferë has që në fillim të romanit një grua të brishtë, Xhoanën, e cila s'do t'i ndahet gjer në përfundimin

e saj. Romanca e tyre është mjaft komplekse; kemi të bëjmë me ngjizjen e ndjenjave të dashurisë dhe urrejtjes; këta dy dashnorë që gjallojnë në një epokë të vështirë – rrethohen nga ëndrra të bukura, vizione e vegime, por është realiteti i rëndë, i zymtë, që i pllakos dhe i përcakton fatet e tyre. Ky çift është padyshim ndër çiftet më interesante të literaturës së shekullit XX; ata bredhin rrugëve, kafeneve, qëndrojnë në hotel me "kalvadosin" e tyre, dashurohen me afsh, por edhe përbuzen. Dashuria e Xhoanës, fjala vjen, për Ravikun nganjëherë duket ireale, me një lidhje të çuditshme që ajo ka me Ravikun. Meqë Raviku zihet nga policia dhe për një kohë largohet nga Parisi, Xhoana nis aventura të reja romantike si këngëtare dhe më vonë aktore; me t'u kthyer Raviku relacioni i tyre s'është stabil, qëndron mes zymtësisë, pasionit, dashurisë dhe urrejtjes. Raviku megjithatë do t'i qëndrojë te koka në grahamat e fundit, pasi që është qëlluar me armë nga njëri prej dashnorëve të saj. Kështu ngjizet një roman drithëruar, me refugjatë, artistë, pacifist, në një atmosferë të zymtë nga lufta e terrori, por me mesazhet se njerëzimi është më i fortë se çdo gjë tjetër, dhe se regjimi do të rrënohet e njeriu do të jetë i lirë të mendojë, të dashurojë e ta përcaktojë veten.

Bukowski ndryshe

# BUKË ME SALLAM

**Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet**



## Fitim NUHIU

Libri i Bukowskit me një përkthim brilant dhe të shqipëruar siç duhet nga përkthyesja Iris Sojli, i servohet publikut shqiptar me një finesë të paparë. Filozofia e jetës dhe mendimeve që autori kishte gjatë jetës së vet, një libër dedikuar fëmijërisë dhe adoleshencës së tij plot shëmti, dhimbje, arrati, kërkim të vetvetes, abuzimit të prindërve të vet, vetmisë, alkoolit.

Po fillojmë nga vet titulli "Bukë me sallam" që përkthyesja ka bërë përshtatjen e duhur që ndërlidhet me krejt veprën në fjalë. Vetë Bukowski ka përmendur imazhin e ekzistencës se tij që ka qenë mes prindërve sikur një copë sallami (ham) mes dy fetash buke për tost (rye).

Ky libër vjen si himn për fëmijët që janë keqtrajtuar nga prindërit e tyre, me një gjuhë të thjeshtë, të thatë, tamam gjuhë e rrugës, e pamaskuar me terma përkëdhelës, duke ia thënë troç lexuesve të vërtetat për prindërit abuziv ndaj fëmijëve të tyre dhe shpirtave të pambrojtur e të virgjër.

Libri "Bukë me sallam" është një gjysmë-biografi e autorit, ku fillon nga fëmijëria e tij e hershme, duke ndenjur nën tavolinë që shihte me ngazëllim rrezet e diellit dhe këmbët e prindërve të vet që ecnin vërdallë. Ai paraqet atë skenë me një gjuhë shumë të thjeshtë, babain (njerkun) e tij abuziv që e rrihte në tualetin e shtëpisë, duke kaluar në rutinë bezdisëse dhe pikëlluese, siç shprehet në vargjet:

"Goditja e parë më shkaktoi më shumë tronditje sesa dhimbje" (fq.44)

"Ndieja sikur edhe dielli i përkiste tim eti" (fq.45)

"Ndieja më shumë frikë se dhimbje", (fq.52)

"Më urdhëroi: Uli pantallonat. E gjitha bota ishte atje jashtë, tërësisht shpërfillëse ndaj gjithçkaje, por kjo nuk ndihmonte" (fq.81)

"M'u kujtua që te Vëllezërit Karamazov, Ivani kishte thënë: Kush është ai që nuk dëshiron ta vrasë të atin e tij?" (fq. 266)

Paraqitet një nënë që s'ka fuqinë ta mbrojë djalin e saj, duke kaluar edhe ajo në indiferencë ndaj tij, pavarësisht ca përpjekjeve të kota të saj.

Më pas, në mungesë të kësaj dashurie prindërore, Henri i vogël sikur e kërkonte vërdallë, në kopsht, në shkollë, porse përfundonte në duart dhe shoqëri të gabuara. Ai vinte nga prindër të varfër e thuajse të papunë, kishte kompleksin inferioritetit karshi fëmijëve që vinin nga prindër të pasur, dhe kjo vërehej kudo, në veshmbathje, ushqimin që merrte me vete, nga ora e edukatës fizike, etj.

Përshkruhen detajet në shkollë, raporti me mësimdhënësit/et, hartimet që nuk iu vlerësoheshin sa duhet për tema interesante, Henri mëtonte gjithnjë të shkruante diçka të kundërt, që ia kthente përmbyl realitetin e tyre, përmendet shkuarja në kishë që me terma shumë të thjeshtë ia shpifte, shëmtia që e posedonte, puçrrat e mëdha që i kishte gjithandej në trup e në fytyrë, njohja me epshin, gjinia e kundërt, masturbimi, rebelimi ("ti rebelohesh kundër gjithçkaje. Si dot të mbijetosh?",

fq.328), pijet alkoolike, shoqëria homoseksuale, endacakët, hajdutët, epshin që ndjente për mësuesen e vet epshndjellëse, lojërat sportive më pas, mundja e kundërshtarëve, rrahjet mes fëmijëve, e më pas mes adoleshentëve, përpjekja për të kërkuar vetveten etj.

Kur flet për shkollimin, thekson rezervat dhe dilemat e tij kur thotë: "Edhe arsimimi dukej një grackë" (fq.336)

"E tërë skena e universitetit ishte qullëse. Nuk të thoshin kurrë ç'të priste kur të dilje në botën e vërtetë. Të mbysnin me teori dhe nuk të thoshin kurrë sa të fortë ishin trotuaret. Arsimimi universitar mund ta shkatërronte individin për jetë të jetëve" (fq. 327)

Ajo që vlen të theksohet, është kur Henri takon librat, shkon në bibliotekë dhe fillon të lexojë: "...zbulova bibliotekën publike La Cienega..". (fq.181)

"Nëse i lexoje dhe i lëshohesh magjisë mund të jetoje pa dhimbje, plot shpresë, çfarëdo që të ndodhte. Për mua këta njerëz (personazhet e romaneve) që kishin ardhur në jetën time nga asgjëkundi, ishin shansi im i vetëm. Ishin të vetmit zëra që dinin të më flisnin". (fq.183)

Qysh prej fëmijërisë, Henri ndiente veten të madh, të ndryshëm nga të gjithë, ndoshta jeta e vështirë e kishte rritur më herët, por e ndiente veten të veçantë nga të tjerët, duke refuzuar të përshtatej me sistemin që njerëzit kanë krijuar: të lindin, të rriten, të shkollohen, të punojnë e të jetojnë (po sikur kafshët), megjithatë, në atë rreth social që gravitonte e

frekuentonte ndiente veten inferior: ("Shpesh ndihesha inferior. Doja t'ia këpusja gjumit nja pesë vjet të mira, por nuk më linte njeri." fq.213 ), s'donte të futej në grackën e strukturës familjare (fq. 235), donte ta përmbyste procesin (tërë sistemin social) (fq.256).

Përmenden shpesh tema nga më të ndryshmet, p.sh. procesi i të shkruarit ("procesi i të shkruarit është sikur të marrësh të gjitha pjesët e këmbimit dhe t'i kthesh sërish në një makinë" fq.279), ndjenja e vetëkritikës ("Bekeri (shoku i tij) dinte të shkruante më mirë se unë" fq.281), për qiçin e letërsisë ("kur i lexon, ose të kap dhimbja e kokës ose të zë gjumi" fq. 316), dështimin e ëndrrës amerikane, e mohon këtë ëndërr shumë të përfolur botërisht, përmenden luftërat disi sikur me një indiferencë ("Të gjitha luftërat janë bërë për një të ashtuquajtur kauzë të drejtë, nga të dyja palët. Por vetëm kauza e fitimitarit bëhej Kauza Sublime e historisë", fq. 291), Lufta e Parë Botërore, japonezët te Pearl Harbour, etj.

Henkut (Henrit të rritur) sikur i interesonin bisedit fe-ateizëm, sikur donte këtë spektakël, sidomos kur protagonistët ishin të mirë-përgatitur dhe priste me padurim shfaqjen dhe spektaklin e tyre, shtjellon paksa edhe kauzën raciste ("të gjitha hallet e mia më vinin nga fisnikët e bardhë", fq.290)

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

Në fund mund të konstatojmë se Bukowski është ai lloj shkrimtari unik, që rrëfen fakte, i thotë të vërtetat troç, qartë, thjeshtë dhe në fund, sikur përfundimet ua lë në dorë lexuesit të vet.

## KAFENË QË NUK E PIMË

Ca fije argjendi ranë kresë në vjeshtën e kuqe si buzët tua  
E nuk i humbet shkëlqimi i bardhë stinës që po vjen  
Strukem nën një bataniye ne ballkonin që shikon kah lindja  
Zogjtë vijnë, qëndrojnë pak. Ikin, kanë frikë macen.  
Silueta tymi, mjegulle e hukame ngrihen me avujt e Prishtinës,  
rrugica pa drita, të qullura në pluhurin e termoelektranës.  
Nuk bëhesh se je diku, nuk bëhesh se ke kuptuar stinët  
Është matematikë e thjeshtë në orën pa akrepa 11:11.  
A i lutemi njëjtë gjethes së fundit që hamendet  
Të bjerë të shënojë një epokë  
E duam njëjtë atë lis, ahtet hedhur të humbur e të vegjël  
Në shumëkateshe ku mbahen leksione për psikologjinë  
E njerëzit paguajnë me para që të jenë të lumtur- thua ti se  
Lumturia është mall i dalë në tezgë nga llumpa e kafesë.  
Pse bëhesh se këndeje nuk pati Covid-19  
A nuk e pamë se si vdes frika, më pas vjen vdekja?  
Po pra, vdekjes pa frikë i humbet kuptimi  
Është si të ndërrosh dhomën e gjumit  
Si të ndërrosh çarçafët ose të bësh të recertifikatën e kurorëzimit.  
Mos harro: ne do të kuptosh mirëfilli vdekjen, mbyte frikën nga ajo!  
(Heronjtë në bronz e thonë këtë)  
Tash mos mi mbaj më duart në gji  
As mos i shtrij si Eva, të mbash bregun e Venerës  
Gënjejme se vuajmepër dashuri tëpëshjtjellur me cipë të hollë plastike  
Sall njëpërçafim jeshil është, asgjë më shumë  
Behar në tullat me myshk panelesh neoni  
Ku reklamohen veshje që nuk lëshojnë të ftohtit  
Që nuk lejojnë trupit t'i shkojnë mornica  
Kafenë që nuk e pimë, pikë strehe ra në kurriz  
Unazë pas unaze lëshohetnjëvijëz si ashensor deri ne bodrumin e braktisur  
mbushur me zarfe të hedhura nga një postier që nuk diti se çkaështë pritja...  
(telefonifluron dritë që shtrihet murit; lowbattery; fiket e s'mund tëkthejë përgjigjen)

## UDHËZIME PËR TË KALUAR MBRËMJEN I VETMUAR

Merr me vete birra mbështjelli me gazeta të zverdhura  
Se kush e di ndoshta i lexon më vonë  
Mos i numëro shishet e zbrazëta numëroji të mbushurat  
Dhe ki kujdes me frymëmarrjen dhe gjoksin që të gulçon  
Jepi duq duhanit dhe mos shiko tavanin  
Mund të shohësh diçka atje lart....  
Telefonin përkëdhel por kësaj here telin e shkyçurhidhe në kënd  
Numri i vjetër kurrë nuk cingëron në vetmi  
Nuk ke nevojë ta dyfishosh vetminë tënde  
Me një JO të madhe ik vagabond gënjeshtar...  
Mos ke dert nëse nuk ka rrymë dhe ujë  
Ke dhomën tënde me muret që këtë herë do ti gëlltitje  
Numëro të rrahurat e orës nëse nuk ke harruar si bëhet kjo gjë  
Kthehu sërish te masturbimi i parë  
Kur qaje dhe nuk guxojë ta pyesje kënd  
Çka nuk është në rregull ....  
E tash duart prapa dhe ktheju gazetave  
Shiko kush ka vdekur e kush i vdekur ecë  
Mos lexo politikë dhe mos beso se tash do të vijë vdekja  
Ajo për fat sonte të ka harruar  
Ik edhe nga kjo temë mund ta bësh këtë  
Hape dritaren dhe hidhi shishet e zbrazura  
Mos ke frikë nga numrat numëro yjet që i ke parë tek bien  
Dhe dëshirat që ke menduar se do të plotësohen  
Kujto puthjen e parë në buzë dhe të parën herë ....  
Zhvishu lakuriq po të duash dhe shetit nëpër dhomë  
Nuk ka gjë nëse ke qime ujkonje në lëkurë  
Hap dritaren dhe ulëri si egërsirë lagjja të uturijë  
Mos kërko ndjesë nuk ke nevojë të të kuptojnë  
U mbetët vetëm ta njohin mbretërinë tënde  
Kjo është dhoma jote dhe ke shumë për të thënë  
Por tashmë veç të zuri gjumi  
Për një ditë te re të ecjes vertikale

## ROBËRI ARTISTIKE

Dashurisë i vjen era e psh  
qenosesh edhe vetë në kohë qensh  
poetët bëjnë punë mbi letra t'zverdhura  
këndojnë këngë të qivitosura i falen parave të pista  
automobilat luksoz vrasin lejdi Dajanën  
shtohen lutjet për krakëllime qindarkash  
Me mjete të sofistikuara të shekullit atomik  
Vërtetohet se Liria nuk ekziston  
u postua dhe u bart në Marsin e mistershëm  
civilizimi e shpuri duke u zgërdhirë  
Për të mbetur bursa e numrave ku njeriu është malli më i lirë  
në ekspozitë kolektive

## ARRESTI

anemia e qirit shihet qartë  
nga sytë e ajturdalur duq  
shpirti i gjoë kapet në rrjetë  
pa shpresë përpëlitet  
buzë e kuqërremtë vyshket në lutje  
klyshi i qenit kolorizon shikimin  
njeriu vizaton bardh e zi llahtarinë  
bulëzon koka e qepës në kokë  
mbushet si stacion lakuriqësh  
në mesnatë barku të të pëlcase  
të vjen të vjellur nga gjurmët  
që i lanë  
o Zot  
njerëzit...

## LYPSARË TË DASHURISË

S'përtojmë me shtri dorën si me prek diçka të butë,  
që dhe mb!  
Djersijmë ca kokrra të kuqe që biejnë si shegë,  
në pikla faqesh.  
Eh, marrim frymë thellë...  
na ther diçka e kërkume n'vazhdim.  
Gjumi harliset si hergëlë i a jep malit,  
rrufe e pafund vranë n'kthjellët!  
Tuj pritë në stacion të braktisur me ardhë treni i andrrave!  
Shtrihemi në shtrat që nuk bëzan;  
Çarçafët e pëshjtjellur keq,  
ndiej frymëmarrjen tënde, që ikën në shllunga pluhuri n'tavan.  
Bahesh me fole vetë me vete!  
Lypsar i një rruge të shkelur, ndjehesh i vetmuar,  
lypsar i një meteliku të argjendtë,  
që don me shtrëngue në dorë...  
Me e hudhë përpjetë, me e kthye përsëri,  
përsëri e përsëri,  
e pret me t'u kthye kangë e vjetër,  
si me pas dëgjue për herë të parë,  
simfoni përpëlajtsh,  
bëhesh tuj këndue një herë vetë me vete,  
më pas me zë,  
si petk që rrahet në vig nga era e thahet me luhatje bari,  
me e vesh si flutura lavrën për njëzetë e katër orë...  
Del, pret, një takim ku shikon akrepat tuj hangër me njëri-tjetrin  
...deri më dymbëdhjetë!  
Euu lypës i përjetshëm i azilit n'shpirtin tënd!  
Deri në frymë të fundit do dikë, më të dashtë e me dashtë, me pa në sy  
e tokëzohesh!  
Në zemër mbetesh lypsar i përjetshëm!



Aziz MUSTAFA

# NË KORRIK, KUR UNË S'DO TË JEM MË...



(fragment romani)

Të dielën kur u shfaq te dera pastruesja, u gëzova aq shumë sa gati e mora ngrykë. Ajo u çudit fort dhe buzëqeshi me mirësjellje. Vetëm atëherë m'u kujtua se nuk ia dija as emrin, e megjithatë më erdhi keq që ta pyesja tani. E lashë atë punë. Mund ta pyesja Fadilin, traktoristin. Ai i dinte punët e hallkut si askush tjetër në katund.

Pastruesja i përvolet mëngët. Ishte një grua e moshës së mesme që i bënte punët pa fjalë dhe nuk përzihej në punë të huaja. Burrin ia kishin vrarë në luftë. Kaq dija për të, asgjë më shumë. Kur u morëm vesh për punët që do t'i bënte në shtëpinë time, i tregova se vuaja nga një sëmundje e pashërueshme. Ajo më këqyri me keqardhje dhe shtrëngoi buzët. U nguta t'i tregoja se sëmundja ime nuk ishte ngjitëse, por ajo vetëm buzëqeshi. Ishte grua e fortë dhe nuk trembej aq kollaj. I dhashë një kuti me dorëza polivinili, maska për fytyrë dhe një përparësë.

Atë të diele gruaja pati më shumë punë se zakonisht. Kur iku ajo mbas nja dy ore, dhoma ime shkëlqente. Dritaret i gjeta hapa krah, xhamat të fshirë, çarçafët e shtratit të bardhë dëborë, dërrasat e dyshemesë vezullonin. Gruaja kishte hedhur edhe freskues ajri me aromë levendeje. Mirë që i dhashë bakshish. E meritonte.

U shtriva në shtrat me laptopin në prehër. Aty i shënoj gjithë këto që po ju rrëfej. Por jo sot, jo, thashë me vete, dhe disi me nxitim shkova në kuzhinë, hapa dollapin ku i mbaja disa shishe me verë dhe një uiski njëzet vjet të vjetër që para disa vitesh ma kishte bërë dhuratë një fqinji im zviceran, Lübke. M'u kujtua Lübke i ngratë që vdiq në një aksident trafiku dimrin

e shkuar. Ja, pra, thashë me vete, tani do ta pi këtë uiski për shpirtin e Lübkes. Po këshillat e mjekut? Në djall me këshillat e mjekut. Jeta e shëndetshme s'qe më prioritet për mua. Në mos jetofsha gjashtë deri në tetë muaj, do të jetoj pesë deri në shtatë muaj, katër deri në gjashtë, tre deri në pesë... Çele uiskin e mallkuar dhe mbylle gojën! E çela shishen me një ndjenjë solemniteti dhe thashë me vete: Uiski nuk shkon pa duhan. Hë tash, ku i kam lënë ato purot e shtrenjta që i bleva në Zürich? Duhet t'i gjej. S'pihet uiski pa një puro të mirë. Po, po, do të ulem në verandë si një aristokrat anglez dhe do të tymos puro e do ta pi uiskin e Lübkes. Kërko e hallakat nëpër dollapë, mezi e gjeta kutinë e drunjte me puro.

Duke rrëkëlyer uiskin e duke tymosur puron me shumë kënaqësi, sytë i mbaja te porta e oborrit, thua se prisja që nga çasti në çast dikush do të shfaqej te dera. Kush? Askush. Veç pastrueses askush s'bënte më këndeje. Vallë, si u zbraz këstu kjo shtëpi që dikur ziente nga njerëzit? Gjithë ato ndeja, dreka e darka, zëra fëmijësh... E tash? Oh çfarë vetmie gërryese!

Tutje tëhu, përtej gardhit të thurur me duart e tim eti, dukeshin degët e harlisura të dardhës së vjetër. Kjo dardhë kishte parë më shumë se çdokush tjetër, dasma e vdekje, gëzime e hidhërime, takime të fshehta dashnorësh në netët e verës nën qiellin mbushur me yje dhe ja, ende po qëndronte si një dëshmitare e shurdhër, vetmitare, stoike. Mos do të qash? thashë me vete dhe qesha, e pastaj, qava përnjëmend.

Qielli po errej me ngadalë ndërsa unë vazhdoja të tymosja puron duke pirë nga një gllënjë uiski për shpirtin e Lübkes dhe për shëndetin e të gjithë

njerëzve të mirë që i kisha takuar e njohur në jetën time.

\*

Të nesërmen, ende pa dalë mirë dielli, uturima e traktorit ma prishi gjumin. Nuk më erdhi mërzi aspak. Pas shumë ditësh e netësh të kaluara në një agoni të lodhshme, si i zënë pisk mes realitetit dhe vegimeve, as andej, as këndeje, ky qe mëngjesi i parë që po e gdhija pa përtësë, pa asnjë dhimbje në trup e në shpirt, i kthjellët si uji i burimit. U ndjeva më i lehtë, sikur gjumi i rehatshëm ndihmuar nga ilaçet qetësuese, një gjumë i zbrazët, i verbër, pa ëndrra të bezdisshme e makthe, ma kishte hequr nga supet një barrë të rëndë, barrën e kohës së pamjaftueshme.

Lakuriq deri në brez, u çova dhe e hapa dritaren. Një erë e lehtë me aromë bari të kositur përzier me erën e dheut më goditi lehtas, me hove, si një tyl i butë, në gjoks enë fytyrë. Si është kjo punë, mendova, pse njeriu e nis dhe e sos jetën i dallisur pas gjërave të përkohshme, kalimtare, pa i vënë re këto mrekulli të vogla? Ja edhe unë, një shpërfillës, një i verbër që gjithë jetën vetëm ka këqyrur pa parë asgjë, më në fund, në perëndim të kohës sime, po bëhem më i vëmendshëm, më mendjehapur, dhe tani as vdekja s'po më duket si diçka përfundimtare. Sodita për një kohë qiellin e skuqur mbi Kodrën Lindore. Ishte dita e parafundit e shtatorit. Vjeshtë e ngrohtë, mbase e fundit për mua.

Kushëriri im, Fadili, mocanik me mua, i kishte hyrë sërnishtës e po e bënte ugar. E lëshonte plugun dhe hullia e lavrës mbushur me skrraja i ndillte korbat. Me një kapele të zbehur nga dielli, rrasur deri te veshët, me cigaren në buzë, Fadili shkelte pedalin

e gazit dhe i jepte këngës duke bërtitur me sa i hanin mushkëritë. Zhurma e tmerrshme e traktorit ia mbyste këngën Fadilit, por ai vazhdonte të këndonte me një pasion aq të madh sa të shkonte mendja se ky po i këndonte publikut e jo arës, kodrës, përroskës, shkurreve e ferrishtave dhe zogut në majë të lisit. Nesër apo pasnesër, Fadili do të hedhë farën e grurit e pastaj do ta presë borën që ta mbulojë arën. Këtu dimrat dinë të jenë të gjatë, të ashpër dhe të errët, por me t'u shkrirë bora, gruri do të mugullojë si një qilim i blertë. Në korrik me kësnet, kur të piqet gruri, Fadili do ta ndezë kombajnën, do ta korrë grurin, e pastaj me ato duart e mëdha të zdralosura e me lëkurë të regjur do t'i shkokujojë kallinjte për të vlerësuar rendimentin vjetor. Në korrik. Kur unë s'do të jem më. Verës.

Tani më mirë të kthehem në dhomën time, sepse s'dua të mendoj për gjëra që nuk varen prej meje. Njeriu duhet ta mbajë krahun në punë, e mendimet e errëta sa më larg. Lavdi zotit që unë s'jam krejt i ngathët dhe disa gjëra më vijnë për dore. Sot do të zbres në bodrum për të fshirë pluhurat nga raftet dhe nga veglat e babait tim e pastaj do t'i shtrëngoj mirë e mirë vidhat e tryezës sime të punës që po luhatet e po krikëllin duke më prishur nervat. Me sa duket, njeriu nuk pushon kurrë së menduari për këtë e për atë deri në mbarim të kohës së tij. Bregat dhe telashet e vogla nuk i sosën deri në grahmen e fundit. Edhe unë kështu: do ta ndreq skrivarinë e pastaj do të ulem e do të shkruaj e të shkruaj derisa të mos mund të shkruaj më.

*Pengimi i letërsisë*


# IMAGJINATA NUK BËHET PJELLORE NË ROBËRI

**Shkrimtari i letërsisë nuk është i lirë kur duhet t'i falsifikojë ndjenjat subjektive, që nga këndvështrimi i tij janë fakte**

**George ORWELL**

Një shoqëri totalitare që ia del ta përjetësojë veten, ka shumë gjasa të krijojë një sistem skizofrenik mendimi, në të cilin ligjet e gjykimit të shëndoshë ishin të mira në jetën e përditshme dhe në disa shkencë ekzakto, por mund të shpërfillëshin nga politikani, historiani dhe sociologu. Tashmë janë të panumërt njerëzit që do ta shihnin si skandaloz falsifikimin e një teksti shkencor, por s'do të shihnin asgjë të keqe në falsifikimin e një fakti historik. Pikërisht në pikën ku letërsia dhe politika takohen, totalitarizmi ushtron trysinë më të madhe mbi intelektualin. Deri tani shkencat ekzakto nuk janë të kërcënuara aspak në të njëjtën shkallë. Kjo pjesërisht ndodh për faktin se në të gjitha vendet është më e lehtë për shkencëtarët sesa për shkrimtarët të rreshtohen në mbështetje të qeverive të tyre. Në Angli armiqet e drejtpërdrejtë të së vërtetës, dhe rrjedhimisht të lirisë së mendimit, janë lordët e shtypit, manjatët e filmit dhe burokratët, por që po ta shohësh në një këndvështrim më afatgjatë, dobësi i dëshirës për liri te vetë intelektualët është simptoma më serioze ndër të gjitha. Mund të duket se gjatë gjithë kësaj kohe kam folur për efektet e censurës, jo te letërsia në tërësi, por thjesht në një degë të gazetarisë politike. Duke pranuar që Rusia Sovjetike përbën një lloj zone të ndaluar në shtypin britanik, se çështje si Polonia, Lufta Civile e Spanjës, Pakti Ruso-Gjerman, e kështu me radhë, nuk mund të jenë kurrësi pjesë e një diskutimi serioz dhe se nëse ti ke informacione që bien në kundërshtim me ortodoksinë mbizotëruese, nga ti pritët që ose të shtrembërosh ose të heshtësh, pasi i kemi pranuar të gjithë këtë, pse duhet që në një kuptim më të gjerë letërsia të ndikohet? A është çdo shkrimtar politikan dhe a është domosdoshmërisht çdo libër një vepër "raportim" i drejtpërdrejtë?

Edhe nën diktaturën më të ashpër një shkrimtar nuk mund të mbetet i lirë brenda mendjes dhe t'i distilohet ose maskojë idetë jodogmatike në mënyrë që t'u hedhë hi syve autoriteteve dhe ata të mos arrijnë t'i kuptojnë. Dhe në çdo rast, nëse vetë shkrimtari është në një mendje me dogmën mbizotëruese, pse duhet të ketë një efekt shtrëngues mbi të? A nuk ka gjasa që letërsia ose çdo lloj arti në shoqëri të lulëzojë ku nuk ka konflikte të mëdha mendimesh dhe dallim të mprehtë midis artistit dhe audiencës së tij? A duhet ta marrim si të vërtetë se çdo shkrimtar është rebel, apo edhe se shkrimtari si i tillë është një person i jashtëzakonshëm? Sa herë që dikush përpigjet ta mbrojë lirinë intelektuale kundër shprehjeve të totalitarizmit, ai përballet me këto argumente në një formë ose



në një tjetër. Ato mbështeten në një keqkuptim të plotë të asaj se çfarë është letërsia dhe se si, ndoshta duhet thënë më mirë, pse ajo lind. Ata hamendësojnë se një shkrimtar është ose thjesht argëtues, ose përndryshe një kalemxhi i shitur i cili mund të kalojë nga një linjë e propagandës në tjetrën aq lehtë sa një organist ndërron meloditë. Por, në fund të fundit, si ndodh që shkruhen librat? Në një nivel të ulët letërsia është një përpjekje për të ndikuar në këndvështrimin e bashkëkohësve me anë të regjistrimit të përvojës. Dhe për sa i përket lirisë së shprehjes, nuk ka shumë dallim mes një gazetari të thjeshtë dhe shkrimtarit më "jopolitik" të letërsisë së trilluar. Gazetari nuk është i lirë dhe është i ndërgjegjshëm për mungesën e lirisë kur detyrohet të shkruajë gënjeshtër ose të ndrydhë atë që i duket lajm i rëndësishëm: shkrimtari i letërsisë nuk është i lirë kur duhet t'i falsifikojë ndjenjat subjektive, që nga këndvështrimi i tij janë fakte. Ai mund ta shtrembërojë dhe të bëjë karikaturën e realitetit për ta bërë më të qartë kuptimin e tij, por ai nuk mund ta keqparaqesë peizazhin e mendjes së vet: nuk mund të thotë me bindje se i pëlqen ajo që nuk i pëlqen, ose se beson atë që nuk e beson. Nëse detyrohet ta bëjë, përfundimi i vetëm është që aftësitë e tij krijuese thahen. Ai s'e zgjidh dot problemin duke qëndruar larg temave të diskutueshme. Nuk ekziston diçka e tillë si letërsia e vërtetë jopolitike, më së paku në një epokë si e jona, kur frika, urrejta dhe besnikëria e një lloji drejtpërdrejt politik janë afër sipërfaqes së ndërgjegjes së secilit. Edhe një tabu e vetme mund të ketë efekt të gjithanshëm gjymtues mbi mendjen, sepse ekziston gjithmonë rreziku që çdo mendim që ndiqet lirisht mund të çojë te mendimi i ndaluar. Nga kjo rrjedh se atmosfera e

totalitarizmit është vdekjeprurëse për çdo lloj prozatori, megjithëse një poet, një poet lirik, mund të arrijë të marrë frymë. Dhe në çdo shoqëri totalitare që mbijeton për më shumë se disa breza, ka të ngjarë që proza e llojit që ka ekzistuar gjatë katërqind vjetëve të fundit, si pasojë, të marrë fund. Letërsia mund të ketë lulëzuar edhe nën regjime despotike por, siç është theksuar shpesh, despotizmat e së shkuarës nuk ishin totalitare. Aparati i tyre shtypës ishte gjithmonë i paaftë, klasat e tyre sunduese zakonisht ishin ose të korruptuara ose apatike ose gjysmë liberale në pikëpamje, dhe doktrinën fetare mbizotëruese zakonisht ishte kundër përsosmërisë dhe nocionit të pagabueshmërisë njerëzore. Megjithatë, është më se e vërtetë që proza letrare ka arritur nivele më të larta në periudhat e demokracisë dhe hamendësimeve të lira. I ri në totalitarizëm është fakti se doktrinën e tij nuk janë vetëm të pakundërshtueshme, por edhe të paqëndrueshme. Ato duhet të pranohen nga frika e ndëshkimit, por nga ana tjetër gjithmonë priren të ndryshohen pa një pa dy. Kini parasysh, për shembull, qëndrimet e ndryshme, krejtësisht të papajtueshme me njëra-tjetrën, që një komunist anglez ose "shok i idealit" i është dashur të përvetësojë ndaj luftës midis Britanisë dhe Gjermanisë. Për vite me radhë përpara shtatorit 1939 pritej të ishte thellësisht i shqetësuar për "tmerret e nazizmit" dhe të shtrembëronte gjithçka që kishte shkruar për ta denoncuar Hitlerin. Pas shtatorit 1939, për njëzet muaj, duhej të besonte se Gjermania ishte më shumë viktimë e së keqes sesa burim i së keqes, dhe se fjala "nazist", të paktën për sa i përket shtypit të shkruar, duhej të hiqej menjëherë nga fjalori i tij. Menjëherë pasi dëgjoji edicionin e lajmeve të orës 8.00 të mëngjesit të 22 qershorit 1941,

duhej të fillonte të besonte edhe një herë tjetër se nazizmi ishte e keqja më e tmerrshme që bota kishte parë ndonjëherë. Tani është e lehtë për një politikan të bëjë ndryshime të tilla: për një shkrimtar rasti është disi ndryshe. Ai do t'i ndryshojë bindjet në çastin e duhur, ose duhet të thotë gënjeshtër për ndjenjat e tij subjektive, ose t'i ndrydhë plotësisht ato. Në të dyja rastet e ka shkatërruar burimin e tij të energjisë. Jo vetëm që s'do t'i lindin më ide të reja, por edhe fjalët që përdor do të duken se bëhen të ngurta kur dalin prej tij. Shkrimi politik në kohën tonë përbëhet pothuajse tërësisht nga fraza të parafabikuara të bashkuara si faqet katrorë të kubeve për fëmijë. Ky është përfundimi i pashmangshëm i auto-censurës. Për të shkruar me një gjuhë të thjeshtë, energjike, duhet të mendosh pa frikë, dhe nëse mendon pa frikë, nuk mund të jesh dogmatik politikisht. Mund të jetë ndryshe në një "epokë të besimit", kur dogma mbizotëruese ka lëshuar rrënjë prej kohësh dhe nuk merret shumë seriozisht. Në atë rast, do të ishte e mundur, ose mund të ishte e mundur, që zona të mëdha të mendjes të mbeten të paprekura nga ajo që dikush beson zyrtarisht. Megjithatë, vlen të theksohet se prozeshkrimi gati u zhduk gjatë epokës së vetme të besimit që Evropa ka gëzuar ndonjëherë. Përgjatë gjithë Mesjetës pothuajse nuk kishte fare prozë të mirëfilltë letrare dhe shumë pak të shkrimit historik: udhëheqësit intelektualë të shoqërisë i shprehën mendimet e tyre më serioze me një gjuhë të vdekur, e cila pak ndryshoi përgjatë një mijë vjetëve.

Gjithsesi, totalitarizmi nuk premtonte edhe aq një epokë besimi sa një epokë skizofrenie. Një shoqëri bëhet totalitare kur struktura e saj bëhet në mënyrë flagrante artificiale: atëherë kur klasa sunduese e ka humbur funksionin, por arrin të ngjitet në pushtet me forcë ose mashtrim. Një shoqëri e tillë, pavarësisht se sa këmbëngul të jetë e tillë, nuk arrin kurrë të bëhet as tolerante dhe as intelektualisht e qëndrueshme. Nuk mund të lejohet kurrë as regjistrimin e vërtetë të fakteve, as sinjoretin emocional që kërkon krijimi letrar. Por për t'u korruptuar nga totalitarizmi nuk duhet të jetosh në një vend totalitar. Thjesht mbizotërimi i disa ideve mund të përhapë një lloj helmi që e bën një temë të mëpasshme të pamundur për qëllime letrare. Kudo që ka një dogmë të detyruar, apo edhe dy dogma, siç ndodh shpesh, nuk ka më shkrim të mirë. Kjo u ilustrua më së miri nga Lufta Civile e Spanjës. Për shumë intelektualë anglezë lufta ishte përvojë shumë tronditëse, por jo përvojë për të cilën mund të shkruanin sinjoretisht. Ishin vetëm dy gjëra që të lejoheshin t'i thoshe dhe të dyja ishin gënjeshtër të dukshme:

si rezultat, lufta prodhoi hektarë me botime, por gati asgjë që ia vlente të lexohej. Nuk është e sigurt nëse efektet e totalitarizmit te poezitë janë po kaq vdekjeprurëse sa te proza. Ka shumë arsye pse është disi më e lehtë për një poet sesa për një prozator të ndihet rehat në një shoqëri autoritare. Së pari, burokratët dhe njerëz të tjerë “praktikë” zakonisht e përcmojnë aq shumë poetin sa nuk interesohen shumë për atë që thotë. Së dyti, ajo që po thotë poeti, pra çfarë “do të thotë” poezia e tij nëse përkthehet në prozë, është relativisht e parëndësishme edhe për vetë atë. Mendimi që përmban një poezi është gjithmonë i thjeshtë dhe nuk është qëllimi kryesor i poezisë ashtu sikurse anekdota nuk është qëllimi kryesor i një tabloje. Poezia është kombinim tingujsh dhe shoqërizimesh, kurse piktura është kombinim i gjurmëve të penelit. Për fragmente të shkurtra, si në refrenin e një kënge, teksti poetik mund të heqë dorë plotësisht nga kuptimi. Prandaj, është mjaft e lehtë për një poet që të qëndrojë larg temave të rrezikshme dhe të shmangë herezitë: madje edhe kur nuk i shmang, ato mund të mos vihen re. Por poezia e mirë, para së gjithash, ndryshe nga proza e mirë, nuk është domosdoshmërisht produkt individual. Disa lloje poezish, si baladat, ose strofa shumë artificiale, mund të kompozohen në bashkëpunim nga disa njerëz në grup. Nëse baladat e lashta angleze dhe skoceze janë krijuar fillimisht nga individë, apo nga shumë njerëz, është e diskutueshme, por gjithsesi nuk janë krijime individuale në kuptimin që ndryshojnë vazhdimisht duke kaluar gojë më gojë. Edhe te botimet, dy versione të një balade nuk janë të njëjta. Shumë bashkësi primitive kompozojnë vargje së bashku. Dikush fillon të improvizojë, ndoshta duke e shoqëruar këtë me një instrument muzikor, dikush tjetër ndërhyr me një varg ose një rimë kur këngëtari i parë ngecën dhe kështu procesi vazhdon derisa të ekzistojë një këngë ose baladë e plotë autori i së cilës nuk dihet. Në prozë ky lloj bashkëpunimi intim është krejt i pamundur. Proza serioze, sidoqoftë, duhet të krijohet në vetmi, ndërsa ngazëllimi i qenies pjesë e një grupi ndihmon vetëm në lloje të caktuara vjershërimi. Vargu, dhe ndoshta vargu i mirë i llojit të vet, megjithëse nuk do të ishte i nivelit më të lartë, mund të mbijetojë edhe nën regjimin më inkuizitor. Edhe në një shoqëri ku liria dhe individualiteti ishin zhdukur, do të kishte ende nevojë ose për këngë patriotike dhe balada heroike për festimin e fitoreve, ose për shembuj të hollësishëm ditirambesh: dhe këto janë llojet e poezive që mund të shkruhen me porosi ose të kompozohen në grup, pa nënkuptuar domosdoshmërisht mungesën e vlerës artistike. Proza është një çështje tjetër, pasi prozatori nuk mund ta ngushtojë gamën e mendimeve pa e vvarë aftësinë e tij krijuese. Por historia e shoqërive totalitare, ose e grupeve të njerëzve që kanë përqafuar pikëpamjen totalitare, sugjeron se humbja e lirisë është armiqtësore ndaj të gjitha formave të letërsisë. Letërsia gjermane gati u zhduk gjatë regjimit të Hitlerit dhe nuk ishte më mirë në Itali. Letërsia ruse, për aq sa mund të gjykohej nga përkthimet, është përkeqësuar dukshëm që nga ditët e para të Revolucionit, megjithëse disa nga poezitë duket se janë më të mira se proza. Pak ose aspak romane ruse

që mund të merren seriozisht janë përkthyer për rreth pesëmbëdhjetë vjet. Në Evropën Perëndimore dhe në Amerikë, shumica e shtresës së intelektualëve që lëvrojnë letërsinë ose ka kaluar nëpër radhët e Partisë Komuniste ose ka qenë tejet dashamirëse ndaj saj, por e gjithë kjo lëvizje majtas ka krijuar jashtëzakonisht pak libra që ia vlen të lexohen. Katolicizmi ortodoks, sërish duket se ka një efekt te disa forma letrare, veçanërisht te romani. Gjatë një periudhe treqindvjeçare, sa kanë qenë në të njëjtën kohë edhe romancierë të mirë edhe katolikë të mirë? Është fajtor që disa tema nuk mund të festohen me fjalë, dhe tirania është njëra prej tyre. Askush nuk ka shkruar një libër të mirë që lavdëron Inkuizicionin. Poezia mund të mbijetojë, në një epokë totalitare, dhe për disa arte ose gjysmë-arte, si arkitektura, triania mund të duket t’u sjellë përfitime, por prozatori s’do të kishte zgjidhje tjetër përveç heshtjes dhe vdekjes. Proza letrare siç e dimë është produkt i racionalizmit, i shekujve protestantë, i individit autonom. Dhe rrënimi i lirisë intelektuale e gjymton gazetarin, shkrimtarin shoqëror, historianin, romancierin, kritikun dhe poetin, të gjithë me radhë. Në të ardhmen është e mundur që një lloj i ri letërsie, që nuk përfshin ndjenja individuale apo vëzhgime të vërteta, mund të lindë, por një gjë e tillë aktualisht nuk mund të imagjinohet. Duket shumë më e mundshme që nëse kultura liberale në të cilën kemi jetuar që nga Rilindja në të vërtetë merr fund, arti letrar do të zhduket bashkë me të.

Natyrisht, shtypja do të vazhdojë të përdoret dhe është interesante të hamendësosh se çfarë përmbajtjeje do të mbijetonte për t’u lexuar në një shoqëri të ngurtë totalitare. Gazetat, me sa duket, do të vazhdojnë derisa teknika televizive të arrijë një nivel më të lartë, por përveç gazetave nuk është e sigurt nëse edhe tani masa e madhe e njerëzve në vendet e industrializuara e ndien nevojën për të lexuar ndonjë lloj letërsie. Ata nuk janë të gatshëm, sidoqoftë, të shpenzojnë sadopak për të lexuar madje as sa shpenzojnë për disa veprimtari të tjera çlodhëse. Ndoshta romanet dhe tregimet do të zëvendësohen plotësisht nga filmat dhe emisionet radiofonike. Ose ndoshta do të mbijetojë një lloj letërsie sensacionale e shkallës së ulët, e krijuar nga një lloj procesi zinxhir që e zvogëlon tej mase pjesëmarrjen aktive të lexuesit gjatë leximit.

Ndoshta nuk do të jetë përtej aftësive të mendjes njerëzore që në të ardhmen të shkruhen libra nga makineritë. Por një lloj procesi mekanizues tashmë mund të vërehet te filmi dhe radioja, te reklamat dhe propaganda si dhe në nivelet e ulëta të gazetarisë. Filmat e Diznejt, për shembull, krijohen sipas një procesi që është i njëjtë me atë të prodhimit të mallrave në fabrikë, një pjesë të punës e bëjnë makineritë, pjesën tjetër ekipet e artistëve që zhdukin stilin e tyre individual. Skenarët e emisioneve të radios zakonisht shkruhen nga kalemxhinj të lodhur, të cilëve u diktohet paraprakisht tema dhe mënyra e shtjellimit: megjithatë, ajo që ata shkruajnë është thjesht një lloj lënde e parë të cilën producentët dhe censorët e ndajnë në pjesë. Kështu ndodh edhe me librat dhe broshurat e panumërta të porositura nga dikasteret e ministrive. Krijimi

i tregimeve, romaneve që botohen pjesë-pjesë dhe i poezive për revistat e rëndomta, ngjan edhe më shumë me procesin mekanik të prodhimit. Gazeta të tilla si Shkrimtari janë plot me reklama të shkollave letrare, të cilat ofrojnë subjekte të gatshme për pak shilinga. Disa, së bashku me subjektin, të shërbejnë me fjalitë hapëse dhe mbyllëse të çdo kreu. Të tjerë të pajisin me një lloj formule algjebrike me të cilën ti mund të krijosh vetë subjektet e tua. Të tjerë ofrojnë pako me letra si në lojën me letra, ku në secilën prej tyre janë shënuara personazhe dhe situata, të cilat duhet vetëm të përzihen dhe shpërndahen në mënyrë që të krijohen automatikisht histori të papara. Ka gjasë që letërsia e një shoqërie totalitare të krijohej kështu, nëse letërsia do të shihej ende si e nevojshme. Imagjinata, madje edhe vetëdija, aq sa është e mundur, do të asgjësohej nga procesi i të shkruarit. Librat do të planifikoheshin në linja të përgjithshme nga burokratët dhe do të kalonin nëpër kaq shumë duar e kur të përfundonin s’do të ishin më një produkt individual krejt njësoj si një makinë Ford në fund të linjës së montimit. S’do mend që çdo gjë e prodhuar në këtë mënyrë do të ishte broçkull, por çdo gjë që nuk ishte broçkull do ta rrezikonte strukturën e shtetit. Për sa i përket letërsisë që ka mbijetuar në të kaluarën, në një shoqëri të tillë do të duhej të lihej në harresë ose të paktën të rishkruhej me hollësi. Ndërkohë totalitarizmi nuk ka ngadhënjyer plotësisht kudo. Vetë shoqëria jonë është ende, në përgjithësi, liberale. Për ta ushtruar të drejtën e fjalës së lirë, duhet të luftosh kundër trysnisë ekonomike dhe kundër një pjesë të fuqishme të opinionit publik, por ende jo kundër policisë sekrete. Mund të thuash ose të shtypësh gati çdo gjë për sa kohë që je i gatshëm ta bësh pa rënë në sy. Porse ogurzi në këtë rast, siç e shpreha në fillim të kësaj eseje, është fakti se armiqtë e ndërjegjshëm të lirisë janë ata për të cilët liria duhet të ketë më shumë rëndësi se për këdo tjetër. Publikut masiv mund të mos i interesoj kjo çështje në një mënyrë apo tjetër. Ata nuk e mbështetin persekutimin e heretikut dhe as nuk bëjnë asgjë përta mbrojtur. Ata janë në të njëjtën kohë shumë të arsyeshëm dhe shumë të cektë nga mendja për ta rrokur botëkuptimin totalitar. Sulmi i drejtpërdrejtë dhe i vetëdijshëm ndaj ndershmërisë intelektuale vjen nga vetë intelektualët. Ka mundësi që intelijenca rusofile, edhe nëse nuk do t’i nënshtrohej atij miti të veçantë, do t’i ishte nënshtuar një tjetri të të njëjtit lloj. Por sido që të jetë, miti rus është aty, dhe zvetënim i prejpushtetit që shkakton ai kutërbon. Kur vëren që një i mirarsimuar është indiferent ndaj shtypjes dhe persekutimit, ti pyet veten çfarë të përcmosh më shumë, cinizmin apo dritëshkurtësinë e tyre. Shumë shkencëtarë, për shembull, janë admirues të pakushtëzuar të BS-së. Ata duket se mendojnë se rrënimi i lirisë s’ka rëndësi për sa kohë që kjo nuk lidhet me punën që ata bëjnë. BS është një vend i madh, me zhvillim të shpejtë, i cili ka nevojë të madhe për punëtorë shkencorë dhe, për rrjedhojë, i trajton ata me bujari. Nëse pranojnë haptazi që u rrinë larg temave të rrezikshme si psikologjia, shkencëtarët janë persona të privilegjuar. Nga ana tjetër, shkrimtarët persekutohen egërsisht. Është e vërtetë që prostitutat letrare

si Ilia Ehrenburgu apo Aleksej Tolstoj paguhen me shuma të mëdha parash, por e vetmja gjë që ka vlerë për shkrimtarin si e tillë, liria e të shprehurit, i hiqet. Të paktën disa nga shkencëtarët anglezë që flasin me kaq entuziazëm për mundësitë që gëzojnë shkencëtarët në Rusi janë në gjendje ta kuptojnë këtë. Por reflektimi i tyre del të jetë i tillë: “Shkrimtarët persekutohen në Rusi. E pastaj? Unë nuk jam shkrimtar”. Ata nuk shohin se çdo sulm ndaj lirisë intelektuale dhe ndaj konceptit të së vërtetës objektive, kërcënon në planin afatgjatë çdo lërmë të mendimit.

Tani për tani shteti totalitar e toleron shkencëtarin sepse ka nevojë për të. Edhe në Gjermaninë naziste, shkencëtarët, përveç atyre hebrenj, trajtoheshin deri diku mirë dhe komuniteti shkencor gjerman, në tërësi, nuk i bëri asnjë rezistencë Hitlerit. Në këtë fazë të historisë edhe sundimtari më autokratik është i detyruar ta marrë parasysh realitetin fizik, pjesërisht për shkak të ngurrimit sipas zakoneve liberale të mendimit, pjesërisht për shkak të nevojës për t’u përgatitur për luftë. Për sa kohë që realiteti fizik nuk mund të shpërfilltet plotësisht, përderisa dy dhe dy duhet të bëjnë katër kur ti vetë, për shembull, po vizaton skicën e një aeroplani, shkencëtari ka funksionin e vet dhe, madje, mund t’i lejohet një përmasë lirie. Zgjimi i tij do të vijë më vonë, kur shteti totalitar të jetë i konsoliduar. Ndërkohë, nëse do ta ruajë integritetin e shkencës, është detyra e tij të ruajë një lloj solidariteti me kolegët e letrave dhe të mos e shohë si çështje ndaj së cilës mund të rrish indiferent në një kohë kur shkrimtarët detyrohen të heshtin ose shtyhen drejt vetëvrasjes, dhe gazetaret falsifikohen në mënyrë sistematike. Por, sido që të ndodhë me shkencat fizike, ose me muzikën, pikturën dhe arkitekturën, është e sigurt, siç jam përpjekur të tregoj, që letërsia dënohet nëse asgjësohet liria e mendimit. Jo vetëm që dënohet në çdo vend që ruan një strukturë totalitare, por çdo shkrimtar që përqafon pikëpamjen totalitare, që përlligj për persekutimin dhe falsifikimin e realitetit, e shkatërron veten si shkrimtar. Nuk ka rrugëdalje nga kjo. Asnjë tiradë kundër “individualizmit” dhe “kullës së fildishtë”, asnjë predikim i devotshëm që thotë se “individualiteti i vërtetë arrihet vetëm nëpërmjet njëjtësismit (identifikimit) me komunitetin”, s’mund ta mohojë faktin se një mendje e blerë është një mendje e prishur. Nëse në një pikë a në një tjetër krijuesi nuk tregohet i natyrshëm, krijimi letrar është i pamundur dhe vetë gjuha bëhet e drunjtë. Do të vijë një kohë në të ardhmen, kur nëse mendja njerëzore bëhet diçka krejtësisht e ndryshme nga ajo që është tani, mund të mësojmë të ndajmë krijimin letrar nga ndershmëria intelektuale. Sot për sot dimë vetëm se imagjinata, ashtu si disa lloj kafshësh të egra, nuk bëhet pjellore në robëri. Çdo shkrimtar apo gazetar që e mohon këtë fakt, dhe pothuajse i gjithë lumi i lëvdatave të sotme për Bashkimin Sovjetik, mbartin ose nënkuptojnë një mohim të tillë, gjë që do të thotë se kërkohet shkatërrimi i vetë asaj. (Polemics, nr. 2, janar 1946)

(Përktheu nga anglishtja: Granit Zela)

Profil: Daniel Defo

# KRUZO, PERSONAZHI QË JETON PAS VDEKJES SË SHKRIMTARIT

**Kur e shkruante "Robinson Kruzo-në", Defos as që i shkante në mendje se do të ishte njëri ndër pararendësit e parë të romanit realist të letërsisë evropiane dhe njëri nga romanet e parë të letërsisë angleze**

**Xhahid BUSHATI**

Përveç romanit shumë të suksesshëm për të rritur me titull: "Mol Flanders", Defo ka shkruar edhe romanin tjetër shumë të njohur "Robinson Kruzo". E shkroi, diku, rreth moshës 60-vjeçare. Për herë të parë romanin e botoi me vazhdime, në revistën "London post" në vitet 1719-1720. Defo nuk është shkrimtar tipik i prozës me aventura. Kur e shkruante "Robinson Kruzo-në", atij as që i shkante në mendje se do të ishte njëri ndër pararendësit e parë të romanit realist të letërsisë evropiane dhe njëri nga romanet e parë të letërsisë angleze. Studiuesit thonë: "Romani ka elemente të romanit edukativ dhe të utopisë sociale, sepse dëshmon se natyra mund të mposhtet edhe me mjete primitive, falë armës të cilën Zoti apo natyra ia dha njeriut - mendjen... Mirëpo, përveç mendjes, Robinsoni arrin

të mbijetojë edhe falë punës. Është puna e pandërprerë që e ndihmon t'i rezistojë vetmisë dhe dëshpërimit. Kur punon, nuk është më vetëm një krijesë e mjerë, e humbur në një ishull, por një fuqi aktive që e fisnikëron dhe, në një mënyrë, e civilizon tokën e pashkelur, të egër. Nga një figurë marginale e botës së madhe, transformohet në një kryepersonazh: KRIJUES DHE TRANSFORMUES I NATYRËS. Një shembull i gjallë se nuk e krijon vetëm fati njeriun, por edhe njeriu mund ta krijojë fatin e vet". Subjekti i romanit nuk është krejtësisht i trilluar. Disa studiues mendojnë se "Robinson Kruzo" është biografia alegorike e vetë Defo-së. Pa dyshim ekzistojnë disa elemente autobiografike. Të tjerë studiues thonë: "Robinsoni me jetën e vet në ishullin e vetmuar, riprodhon në miniaturë epokat e ndryshme historike që ka kaluar njerëzimi,

që nga komuniteti primitiv deri te civilizimi i kohës së autorit". Dobia e librit qëndron se çdo faqe është e mbushur me ngjarje të papritura, të tensionuara. Është shkruar me një gjuhë rrëfimore të qartë. Ofron pamje bindëse të jetës. Rrit besimin për mbijetesë edhe në kushte të vështira. Optimizmi si një mundësi për të mbijetuar në kushte krejtësisht të tjera jetësore, - është një rreze dielli që shndrit në libër. Robinsoni është mishërimi i njeriut ngadhënjimtar, i cili lufton me sukses me natyrën, me pengesa të shumëllojshme me origjinë nga natyra apo edhe shoqëria njerëzore, si me: depresionet, dëshpërimin e pashpresinë. Megjithëse fati e sjell në një situatë gati pa shtegdalje, por nuk i nënshtrohet dëshpërimit, përpiqet që çdo problem që i del përpara t'i gjejë zgjidhjen, ku pothuaj gjithmonë ia del. Ajo që Robinsonin e mban gjallë mbi 28 vjet në ishullin

e vetmuar, është optimizmi për të ecur përpara. Ai nuk e humb besimin. Që ditën e parë nisi të regjistronte ditët. Krijoi kalendarin e vet, me objektivin që të mos humbte orientimin në kohë. Po ashtu, në një fletore rregullisht shënonte ngjarjet më interesante që përjetonte në ishull duke hartuar kronikën e jetës në ishull. Robinsoni shpëton jetën e një zezaku. Zezaku iu bëhet shok e mik i ngushtë i Robinsonit. Ai i mëson zezakut edhe gjuhën e vet (anglishten). Romani ka mjeshtëri në të shkruar. Mbetet i mbështetur mbi rrëfimin dhe përshkrimin. Edhe pse i tillë e bën për vete lexuesin. Një studiues e ka quajtur veprën e Defo-së "roman i mbijetesës". Gjithashtu do të kujtojmë filozofin Zhan Zhak Ruso, i cili në veprën e tij "Emili ose mbi edukatën", thoshte se libri i vetëm të cilin do e lejonte në bibliotekën e të birit të tij do të ishte "Robinson Kruzo".



Rrugëtimi artistik i Odeta Xhekas

# NJË GALERI DEDIKUAR GRAVE ARTISTE ...

**Si pjesë e vazhdueshme e hulumtimit të saj konceptual dhe vizual për mundësi të reja për bashkim rreth artit, Odeta ka themeluar dhe drejton OXH Gallery of Art, një "institucioni" kulturor që do bashkojë artistë shqiptarë e ndërkombëtarë në Tampa, Florida**

**Sokol PAJA**

Odeta Xheka është një artiste e kuratore e artit pamor, e cila herë pas here hedh hapa të vegjël në eseistike e poezi, duke i kujtuar vetes përherë se ndonëse art-bërja është një akt ekspozimi, kjo nuk të jep të drejtën për një audiencë. Ajo duhet fituar. Si pjesë e vazhdueshme e hulumtimit të saj konceptual dhe vizual për mundësi të reja për bashkim rreth artit, ajo ka themeluar dhe drejton OXH Gallery of Art, një sipërmarrje arti që i jep vëmendje asaj që është me të vërtetë e rëndësishme: aftësia, përmes artit ne rastin konkret, për të vlerësuar bukurinë e brishtë të ekzistencës, pavarësisht vështirësive të pashmangshme. Lindur e rritur në Berat, Odeta Xheka jeton në Tampa, Florida pas 4 vitesh studimesh universitare në Athinë dhe 16 vite të tjera në Brooklyn, New York, ku ngjizi e rriti njëkohësisht praktikën e artit, studimet pas-universitare dhe familjen e saj. "Galeria OXH" është një hapësirë hibride ekspozimi virtual në ndërtesën historike Kress Building në Ybor, Tampa. Pavarësisht njohjes së hollësishme të tendencave dominuese të gjykimit kuratorial e studimor, "Galeria OXH" është e përkushtuar për të punuar me artistet, gjuha vizuale e platformat ideologjike të cilave ofrojnë mundësi për bashkim rreth artit jo si një formë arratisjeje apo një gjest sentimental, por si një mundësi që angazhimi me të bukurën dhe qartësia ndjesore e përfutur prej këtij angazhimi të mos qëndrojnë vetëm brenda mureve të galerisë, por të shërbejnë si një eksplorim intim i përvojës njerëzore. Përveç përkujdesjes për një ndërthurje brezash të artisteve, punët e të cilave ekspozohen e promovohen në bazë të larmisë së disiplinave të lëvruara, Galeria OXH është konceptuar si strumbullari i një komuniteti artistësh, muzikantësh, poetësh, shkrimtarësh, kërcimtarësh, punonjësish të kulturës e gjithkujt tjetër që kërkon të zgjerojnë imagjinatën e botëkuptimit (vetjak e më gjerë) përmes artit që angazhon jo vetëm mendjen, por edhe syrin e shpirtin. Inicialet e emrit tim, thotë Odeta, janë gjithashtu emri i galerisë. Përdorimi i inicialeve, ndonëse jo një risi në emërtimin e një galerie arti, është domethënës në dy kuptime. Së pari, gratë në krye të një sipërmarrje (arti, në këtë rast) janë përgjithësisht të paragjykuara dhe duke i vënë emrin tim galerisë, i jap zë shumësisë identitare të një gruaje, artisteje, nëne e sipërmarrëse. Së dyti, shkronja "xh" e mbiemrit tim ofron një mundësi të shtuar të prezantojë gjuhën e kulturën amtare në mënyrë të drejt-përdrejtë.

Si një hapësirë arti e krijuar nga një



artiste, Galeria OXH i jep përparësi ngritjes së një komuniteti artistik ku rritja profesionale e artistëve bashkëpunëtorë përmes publikimit të katalogëve, diskutimeve ndër panele e ekspozimit të denjë në panairt arti e para ekepeve të blerjes muzeale, kritikës e koleksionistëve, është më e rëndësishme se rendja pas konkurrencës në emër të vanitetit profesional. Program i mirëmennduar kuratorial, ngjarjet speciale, e marketingu inovativ janë gjithashtu pjesë e asaj që galeria bën për të nxitur shkëmbimin e hapur të ideve dhe mbështetur zhvillimin e nuancave artistike.

Galeria është tërësisht e fokusuar në artistet gra; krijimtaria e tyre jo domosdoshmërisht zhbiron "rolin e gruas" si qëllim në vetvete apo si gurin themelues të çdo akti krijues, por vetë misioni i galerisë i mëshon rezistencës e fuqizimit të identitetit gjinorë. Çdo krijim i përzgjedhur për ekspozim, nga piktura në kanavacë të punët në tekstil dhe video (e gjithçka tjetër ndërmjet), është një ftesë për reflektim e bashkëbisedim rreth ripërcaktimit të rolit të gruas artiste në botën e artit dhe jo vetëm si pritsmëri për t'i dhënë përparësi prindërimit. Hap pas hapi, OXH Gallery po kthehet në një pikë referimi jo vetëm për

audiencën lokale, por edhe për mediat e interesuara të skicojnë portretin e një sipërmarrje kulturore, e cila e vesh Tampa Bay me qyrk kozmopolit. Artistet nga Kosova, Shqipëria, e kudo ku flitet shqip janë të mirëpritura të krijojnë ura komunikimi me OXH Gallery. Odeta thotë se nëse vizioni i tyre përkon me atë të galerisë, janë gjithashtu të mirëpritura të bëhen pjesë e kalendarit artistik të Galerisë OXH, por edhe nëse rrugët tona artistike nuk puqen, unë jam e gatshme të ndihmoj e udhëzoj me durim e dëshirë për të përkrahur artistet si-motra në gjuhë e vokacion.



Film

# NA ISHTE NJË HERË AMERIKA

**Thjesht ka shumë pak filma që mund t'ia kalojnë në garë kryeveprës së Serxho Leones. Sepse vetëm në një film ai ka mundur të përmbledhë gjithçka që e bën kinemanë një medium kaq tërheqës...**

## Leonard VEIZI

...“Once upon a time in America” apo i ardhur në shqip si: “Na ishte një herë Amerika” është një film epik i vitit 1984 i regjisorit të madh italian, Serxho Leone. Ky film është i famshëm për thellësinë dhe kompleksitetin e tij, duke përfshirë tema të fuqishme. Filmi eksploron temat e miqësive të fëmijërisë, dashurisë, epshit, lakmisë, tradhtisë, humbjes dhe marrëdhënieve të prishura, së bashku me rritjen e mafiozëve në shoqërinë amerikane.

Filmi është renditur si një nga filmat më të mirë të zhanrit gangster. Kur “Sight & Sound” pyeti disa kritikë në Mbretërinë e Bashkuar më 2002 se cilët ishin filmat e tyre të preferuar të 25 viteve të fundit, “Once Upon a Time in America” u rendit në numrin 10. Në vitin 2015, filmi u rendit në vendin e nëntë në listën e Time Out të 50 filmave më të mirë gangsterë të të gjitha kohërave, ndërsa në vitin 2021, “The Guardian” e përmendi atë si filmin e katërt më të madh mafioz të realizuar ndonjëherë.

## Filmi

Ishte filmi i fundit i drejtuar nga Leone para vdekjes së tij pesë vjet më vonë, dhe filmi i parë artistik që ai kishte drejtuar në 13 vjet. Është gjithashtu pjesa e tretë e trilogjisë së Leone-s “Once Upon a Time”, e cila përfshin “Once Upon a Time in the West” realizuar në vitin 1968 dhe “Duck, You Sucker!” realizuar në vitin 1971.

Realizimi i filmit u drejtua nga Serxho Leone, skenari u shkrua nga Leonardo

Benvenuti, Piero De Bernardi, Enriko Medioli, Franko Arkalli, Franko Ferrini, Serxho Leone. Gjithçka u bazua në romanin “The Hoods”, të shkruar nga Herri Grei. Kamera ishte e Tonino Delli Colli, ndërsa partitura muzikore e filmit i përkiste Enio Morrikones. Protagonist ishin aktorët: Robert De Niro. Xhejms Vud, Elizabeth MekGovern, Xhoi Pesi, Bërt Jang.

Leone fillimisht parashikoi dy filma tre-orësh, pastaj një version të vetëm 269-minutësh, përndryshe 4 orë e 29 minuta, por u bind nga shpërndarësit që ta shkurtonte atë në 229 minuta ose në 3 orë e 49 minuta. Shpërndarësit amerikanë, The Ladd Company, e shkurtuan më tej atë në 139 minuta ose 2 orë e 19 minuta, dhe i riorganizuan skenat në rend kronologjik, pa përfshirjen e Leone.

## Ngjarja

Filmi tregon historinë e pesë dekadave të jetës së katër gangsterëve nga qyteti i Nju Jorkut - miq fëmijërie që janë kriminelë të pamëshirshëm pothuajse që në fillim, por që kanë një lidhje të veçantë besnikërie me njëri-tjetrin. Kur njëri prej tyre e prish atë lidhje, ose mendon se e bën, ai është i përndjekur nga faji deri vonë në jetën e tij, kur zbulon se ai nuk ishte tradhtari, por i tradhtuari.

Filmi hapet me dy skena dhune të tmerrshme, zhvendoset në një strofkë opiumi ku personazhi kryesor kërkon të shpëtojë nga pasojat e veprimt të tij: Një zile telefonike që bie vazhdimisht, kumbues përgjithmonë. në ndërgjegjen e një njeriu që thirri policët dhe tradhtoi miqtë e tij.

Filmi lëviz përpara dhe mbrapa. Një rrëfim i kthimit prapa në kohë përmes syve të Nudëlls - që interpretohet nga Robert De Niro, - një gangster hebre nga New York-u, filmi na tregon për jetën e tij të shënuar nga ëndrrat, gabimet dhe përpjekjet për të shlyer fajet e së kaluarës.

Filmi luan me strukturën narrative, duke lëvizur ndërmjet periudhave të ndryshme kohore - që nga vitet 1920 deri në vitet 1960. Kjo lëvizje kohore thekson atë që është në zemër të filmit: përpjekjet e një njeriu për të kapur kuptimin e jetës së tij dhe dështimin për ta bërë këtë.

Filmi merret kryesisht me konceptin e kujtesës dhe mënyrën se si e shohim të kaluarën. Për Nudëlls, e kaluara është një plagë që nuk mund të shërohet. Ai përpjeket të gjejë ngushëllim, por çdo kthim në kujtimet e tij vetëm sa e ngatërron më shumë.

Filmi ngre pyetjen nëse kujtesa është një formë e të jetuarit ose thjesht një burim vuajtjeje.

Krimi është gjithmonë i pranishëm në jetën e Nudëlls dhe shokëve të tij, dhe filmi e trajton atë si diçka që mbetet e pandryshuar, pavarësisht kalimit të dekadave. Megjithëse bota përreth ndryshon - nga epoka e ndalimit të alkoolit në Amerikën e viteve 1920, deri tek epoka e industrializimit të viteve '60 - vetë personazhet mbeten të mbyllur në ciklet e tyre të dhunës dhe tradhtisë.

Ora që Nudëlls mban në xhep dhe kujtimet e tij të përsëritura të aksioneve të veçanta - si kthimi i tij i vazhdueshëm në opium - janë simbole të përpjekjeve të një njeriu për të ndalur kohën. Ai vazhdimisht

kërkon të rigjejë një çast të lumtur në të kaluarën, por koha nuk ndalet dhe pendesa mbetet. Noodles duket sikur është kapur në një kohë të ngrirë, përballë zgjedhjeve të gabuara që ai dhe të tjerët kanë bërë.

Gratë në këtë film, si Debora dhe Eve, përfaqësojnë dashurinë e pamundur dhe një jetë që nuk u jetua kurrë ashtu siç duhet. Debora, ëndrra e Nudëlls për një jetë jashtë krimit, përfundimisht e refuzon atë, ndërsa lidhja me Eve, një marrëdhënie të fragmentuar dhe të distancuar, tregon paaftësinë e tij për të dashur plotësisht dhe për të qenë i dashur.

Në fund të filmit, Nudëlls përballet me Maks, i cili interpretohet nga Xhejms Vud, - mikun e tij më të mirë që e ka tradhtuar. Maks ka jetuar një jetë me sukses, por në thellësi të tij është po aq i trazuar sa Nudëlls. Ai kërkon nga Nudëlls që ta vrasë për t'i dhënë fund vuajtjeve, por Noodles refuzon. Ky çast është qendra morale e filmit - për Nudëlls, hakmarrja nuk do të sjellë ngushëllim, vetëm një zbrazëti më të madhe.

## Epilogu

Në përfundim, “Na ishte një herë Amerika” është një meditim mbi kohën, kujtesën dhe dëshirat e humbura. Filmi i Leones, megjithëse përmban skena të dhunshme dhe momente tragjike, është një poemë vizuale që reflekton mbi zhgënjimet e jetës dhe mbi pyetjen nëse koha mund të shërojë ndonjëherë plagët e së kaluarës.



NUMRI I ARDHSHËM MË 31 JANAR

# HEJZA

31 Dhjetor 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala - Shala & Rexhepi**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000